

ETIKA

Dymujore

Të jesh në rrugën e drejtë

Njeriu i mençur

Rreth veseve

Muri i ekzistencës

Imam Ebu Hanife

Profeti i dashurisë

Devotshmëri dhe moral shembullor



Ftesë

njerëzimit



Editorial

Kush do t'i shpëtojë fokat që ngordhin mes klithmash pas goditjesh së njëpasnjëshme në kokë që t'u merren lëkurët pa iu shpuar apo dëmtuar?

Kush do të pengojë që shtëpizave të milingonave t'u vihet flaka?

Kush do të ndalojë që fluturave t'u këputen flatrat, apo që macet dhe zogjtë të kthehen në shënjestër për të mësuar shtënien me armë?

Kush do t'u thotë: "Ndal!", bajonetave që bënë vrima-vrima barqet e nënave shtatzëna në Bosnjë; praktikimit të të shtënit me pushkë mbi fëmijët apo shkatërrimit me tanke të shtëpive në Palestinë brenda të cilave banonin njerëz?

Kush do t'u japë fund burgjeve si Ebu Gurejbi dhe Guatanamoja?

Ndërsa në Afrikë mijëra fëmijë vdesin nga uria, në Amerikë mijëra të tjerë rrezikojnë jetën nga mbipesha, kush do t'i shpëtojë ata?

Kush do t'i shpëtojë nëpër gjithë botën të rinjtë me zemrat e shkatërruara nga anafora ku i ka shpënë droga, alkooli, dhuna dhe marrëdhëniet e jashtëligjshme seksuale?

Kush do t'i ndalë krimet e bëra në mitrat e nënave vetëm se nuk ekziston dëshira e të pasurit fëmijë apo sepse foshnja nuk i përket seksit që dëshirojnë të kenë prindërit?

Shekulli i XX të cilin Albert Kamy e pat cilësuar si "shekulli i krimit", është mbi të gjitha edhe shekulli i krimeve të paramenduara dhe të planifikuara.

Edhe shekulli i XXI shkon me hapa gjigandë udhës së shekullit të mëparshëm, pa i lënë asgjë mangut.

Kush do të startojë një shekull te ri në emër të njerëzimit, paqes, dashurisë, mëshirës dhe dhembshurisë?

Muhamedi (a.s.)!

Pasuesit e Tij...

Njerëzit që i ndriçuan zemrat e tyre me dritën e Tij...

Ndjekësit e gjurmëve të Tij...

Ata të cilët thurën karakterin nga "stofit" i Tij...

Muhamedi (a.s.)!

Mëshirë për njerëzimin...

I dërguar nga Mëshiruesi Allah...

I dërguar nga i Buti Allah (Rauf)...

I dërguar nga i Dashuri Allah (vedud)...

Paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të

(Sallallahu alejhi ve sellem)

Në këtë numër do të lexoni:

Të jesh në rrugën e drejtë

Hasan Kamil Jëllmaz

Është e vështirë të jesh në rrugën e drejtë, sepse të jesh në këtë rrugë do të thotë të jesh nga të mirorientuarit.

4



Të jesh në rrugën e drejtë

Hasan Kamil Jëllmaz

| 4 |

| |

| |

| 6 |

| |

| |

| |

| |

| 10 |

| |

| |

| 12 |

| |

| |

| 14 |

| |

| |

| 15 |

| |

| |

| 16 |

| |

| |

| 20 |

| |

| |

| 23 |

| |

| |

| 24 |

| |

| |

| 25 |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

Vetmia

Hatixhe Jëlldëz

Njerëzit për të plotësuar nevojat materiale dhe shpirtërore përgjatë gjithë rrjedhës së jetës së tyre...

10



Një selam jepja vetes tënde

Adem Ergyl

Njeriu i mençur

Lutfi Çakan

| 12 |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

Karakteri gjithpërfshirës i thirrjes

Ahmet Marashllë

Një besimtar i përkushtuar ndaj thirrjes Islame para së gjithash duhet të kërkojë mëshirën...

16



Karakteri gjithpërfshirës i thirrjes

Ahmet Marashllë

| 15 |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

Çrregullimi i përpjesëtimit gjinor sipas hadithit dhe shkencës

Prim.dr.med.sci. Ali F. Iljazi

Allahu i madhërisëm ka bërë që përpjesëtimi në mes fëmijëve meshkuj dhe femra gjatë lindjes të jetë 1:1...

21



Çrregullimi i përpjesëtimit gjinor sipas hadithit dhe shkencës

Prim.dr.med.sci. Ali F. Iljazi

| 21 |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |

Përkthyes:

Adelina Muça

Albert Halili

Ali Bardhi

Artur Tagani

Edin Lohja

Elona Sytari

Elvira Puka

Ermal Nurja

Evans Drishti

Klementina Rrepa

Redaktor: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Viti: III Numri: 11

Mars - Prill 2008

Sefer - Rebiul evvel 1429

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

Mars - Prill 2008

26| Profeti i dashurisë
Rashit Kyqyk



Profeti i dashurisë
Rashit Kyqyk

Sa mirë është të jesh i thjeshtë e i
sinqertë dhe sa keq të kesh formali-
tete dhe “ të bësh sikur je” ...

26

Imam Ebu Hanife
Nu'mani- imami i imamëve
fukahâ
Shejkh Vehbi Sulejman Gavocj

30| Duatë e profetëve

Muri i ekzistencës
Osman Nuri Topbash



Muri i ekzistencës
Osman Nuri Topbash

“O njeri i ndërgjegjësuar! Nuk ka dy-
shim se pak nga pak po të gërryesh mu-
rin, ai do zvogëlohet një ditë sado i lartë
që të jetë.”

32

38| Raporti i njeriut ndaj
Krijuesit: revoltë apo
frikë-respekt
Anji Sinani

Devotshmëri dhe moral
shembullor
Artur Tagani

40|

44| Kontributet e
shqiptarëve në zbulimet
e mëdha gjeografike
Ardian Muhaj



Përse vetëvriten?
Nesrin Zerej

Kohet e fundit ka nisur një situatë
e cila ka marrë përmasa alarmante.
Një lloj mashtrimi i çmendur...

48

Përse vetëvriten?
Nesrin Zerej

50| Hafiz Ibrahim
Rrepishti
Islam Dizdari

Mënyra e thirrjes, shpjegimit
të islamit dhe cilësitë
e thirrësit
Zymer Ramadani

54| Relikte historike
Ali Bardhi



Disa prej xhamive të Malit të Zi që
dokumentohen në dosjet e arkivit shte-
tëror të Stambollit

Ali Bardhi

Dokumentacioni ofron të dhëna
të tërthorta në lidhje me myftilerët,
medresetë...

54

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@hotmail.com
etikaeditor@yahoo.com

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76 768

+355 69 20 58 855

TË JESH NË RRUGËN E DREJTË

Është e vështirë të jesh në rrugën e drejtë, sepse të jesh në këtë rrugë do të thotë të jesh nga të mirorientuarit. "Mustakim" do të thotë të jesh në rrugën e drejtë. "Istikamet" në aspektin gjuhësor do të thotë të vendosësh diçka në vendin e vet, kurse në terminologjinë islame do të thotë të kërkosh nga fuqiploti prezencën tënde në tevhid dhe pozicionimin në mënyrën më të saktë të mundshme në këtë lloj filozofie, gjithashtu ajo do të thotë edhe të respektosh kufijtë e Allahut.

Istikameti është i vështirë. Sepse ai kërkon kapërcimin e veseve, shmangien nga forma pa thelb dhe qëndrimin para Zotit me sinqeritet të plotë. Për këtë Pejgambëri (a.s.) thotë: **"Edhe pse nuk do të mundeni tërësisht, përpiquni të jeni në rrugën e drejtë."** më pas ai thekson duke thënë: **"Vepra më e mirë e juaja është falja e namazit. Kurse abdesin në mënyrë të vazhdueshme e aplikojnë mumminët."** (Muvatta, Taharet, 4; Ibn Maxhe Taharet, 4; Ibn Hanbel 5, 280). Nga ky hadith kuptohet se një person i cili falë namazin dhe përpigjet të jetë vazhdimisht me abdes nuk mund apo nuk duhet të jetë kundërshtar me veprimet e veta.

Istikameti është të jetuarit në përputhje me sunetin e profetit në kufijtë maksimal të sinqeritetit duke mos kaluar në asnjë lloj teprie por

duke mos lënë gjithashtu edhe gjë mangët. Në këtë lloj istikameti ka veprim dhe aksion. Ruajtësit e istikametit në aktivitetin e tyre përfshihen me të gjitha energjitë duke ndjekur rrugën e mesme...

Qëllimi dhe orientimi i tyre është vetëm për kah Zoti. Veprat i konsultojnë me sunetin e profetit. Teprimi dhe mangësimi shkatërrojnë sunetin kurse veprimi, si formë pa thelb, së bashku me neglizhencën shkatërrojnë aksionin. Kështu njeriu shpëputet nga istikameti apo rruga e drejtë. Shpëtimi është vetëm në rrugën e mesme.

Istikameti është shkalla e përsosmërisë së çdo gjëje. Çdo e mirë mundet të shfaqet në fushën e realitetit nëpërmjet istikametit. Fjala, vepra, gjendja dhe puna e atij që nuk është në istikamet janë përpjekje të kota. Allahu (xh.sh.) në lidhje me këtë në një ajet thotë: **"Mos u bëni si ajo gruaja që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerrë fort...!"** (en-Nahl, 16/92)

Ato që istikametin e përvetësojnë deri në atë shkallë sa ai të bëhet pjesë e jetës së tyre, janë të përmendur në Kur'an në mënyrë të drejtë për drejtë:

"Me të vërtetë, atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: "Mos u frikësoni e mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhennetit që ju

është premtuar." (Fussilet, 41/13)

"Pa dyshim, ata që thonë: "Zoti ynë është Allahu!" dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar e as për t'u dëshpëruar (kur t'u vijë vdekja)." (el-Ahkaf, 46/13)

"Ata do të jenë banorë të Xhennetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar." (el-Ahkaf, 46/14)

Në të dy ajetet flitet për mbrojtjen dhe ruajtjen nga frika për njerëzit që do të qëndrojnë në rrugën e drejtë (istikamet). Simbas Kur'anit të mbrojtur dhe të ruajtur nga frika janë miqtë e Allahut (xh.sh.).

Ebu Bekri istikametin e përkufizon si largësia ndaj ortakërisë së Zotit, Umeri si të vepruarit në përputhje me urdhrat dhe ndalesat e Allahut (xh.sh.), Uthmani si të vepruarit larg hipokrizisë, Aliu si të qenit i drejt dhe i rregullt, i pagabueshëm në vepër, në fjalë dhe në thelb. Të arrish në këto shkallë besimi nuk është e kollajtë.

Njeriu në rrugën e jetës kur praktikon rregullat që i mësohen has disa presione të brendshme dhe të jashtme. Një ndër presionet kryesore të brendshme është egoja e tij. Egoja e shtyn atë të mendojë vazhdimisht të nxjerrë unin në sipërfaqe, ta bëjë atë pikë referimi. Disa nga trysnitë e egos janë epshi, pozita dhe fama. Këto dobësi dalin

furishëm atëherë kur njeriu sprovohet me pasuri, me pozitë, etj.

Në ajetin në të cilin Allahu thotë: **"Kur njeriu begatohet ai humb çdo lloj kontrolli"** vërehet se kur njeriut i dhurohet për pak kohë pasuri apo pozitë ai fillon të bëhet abuzues dhe shkelës i rregullave të etikës dhe moralit. Edhe pse hallalli dhe harami janë të qartë, në këto ditë sprove, ato ngatërrohen me njeri-tjetrin. Të përfitosh me idenë se sa është duke rrjedhur ujë nga çezma, ta mbushi kovën time...Në këtë mënyrë gjërat që ishin të turpshme e të neveritshme fillojnë e marrin hijeshi e bukuri.

E keqja më e frikshme e nefisit (unit) është arritja e tij deri në mbrojtjen e së keqes. Me të vërtetë kur njeriu përlyhet me haram, atij fillon t'i largohet neveria ndaj tij, koha që kalon në haram, fillon t'i duket e këndshme.

Një dobësi tjetër e njeriut përveç pasurisë dhe pozitës është edhe ndikimi reciprok në marrëdhëniet e gjinive të kundërta. Nëse një marrëdhënie shkel kufijtë e vendosur, atëherë lumturia humb si në këtë ashtu edhe në botën tjetër.

Le të mendojmë pak rreth sures Nasër e cila sugjeron pendesën dhe madhërimin e Zotit me zemër në kohë të mira e të begata. **"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t'i sho-hësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve."**

Njeriu pandeh fuqinë e tij si dhe atë të njerëzve që e rrethojnë dhe pastaj bie në gabime dhe rrëshqet në mënyrë të papritur. Ky është edhe një ndër problemet themelore të njeriut të sotëm. Mashtrohet nga begatitë dhe pozita që ka duke harruar se ato janë të përkohshme. Harron shumë shpejt se ne jemi udhëtar...drejt një bote të pafundme.

Pse harruam Ahiretin? Le të he-

dhim një shikim mbi gjendjet që nuk duhet të ndodhen tek një njeri që beson në botën tjetër. Përhapja në masë e një gjëje a e bën atë të lejuar? A duhet të na duket i drejtë arsyetimi "Çfarë të bëjmë, të gjithë kështu veprojnë"?

"Ne nuk mund të jemi vazhdimisht dhe plotësisht në rrugën e drejtë " dhe të tjera si këto janë vetëm pretekste qesharake. Ne duhet ta ruajmë qëllimin tonë për të qenë në istikamet pasi një gjë e cila nuk kuptohet dhe praktikohet krejtësisht nuk duhet lënë tërësisht.

Për të arritur perceptimin dhe praktikimin e plotë të islamit duhet ndihma dhe mirësia e Allahut. Mirëpo ndihma dhe frymëzimi është

Njeriu në rrugën e jetës kur praktikon rregullat që i mësohen has disa presione të brendshme dhe të jashtme. Një ndër presionet kryesore të brendshme është egoja e tij

në raport të drejtë me qëllimin dhe përpjekjet e njeriut. Ashtu sikurse njeriu që është duke u përpjekur t'i bie shënjit pavarësisht se nuk i bie atij, ai i afrohet në mënyrë të vazhdueshme. Ashtu edhe rrugës së drejtë duhet t'i afrohem në mënyrë të vazhdueshme me përpjekjet tona pa u dorëzuar asnjëherë. Nëse nuk veprohet kështu atëherë mund të shfaqet rreziku i deformimit të nijetit dhe veprës.

Istikamet është qëndrimi me sinqeritet para Allahut dhe në të vërtetën e mbajtjes së besës ndaj Tij. Ai është shpirti ku gjallërohen të gjitha gjendjet. Me fjalë të tjera çka shpirti është për trupin, ajo është edhe istikameti për veprat. Ashtu

sikurse trupi pa shpirt nuk jeton ashtu edhe vepra pa istikamet është e vdekur. Pa istikamet nuk shumëfishohen veprat, pa të edhe gjendjet nuk janë të shëndosha.

Të braktisësh përgojimin është istikameti i fjalës, largimi nga biddati është istikameti i veprimit, lërja e mefshtësisë është istikameti i veprimit.

Sa bukur e shpjegon Ebu Bekir Shibliji istikametin, koncept ky i cili së bashku me konceptin e Ahiretit ishin shkrirë tërësisht në jetën e tij. Ai thotë: "Istikamet do të thotë të dëshmosh ndodhinë e Kiametit dhe përballjen tënde me Allahun kur ti akoma je në jetë, i gjallë."

Të gjitha mirësitë gjejnë perfeksionin në istikamet. Kur ai nuk është mirësitë nuk janë më të tilla.

Në Kur'an thuhet se mbi poseduesit e istikametit do të derdhen ujërat e mëshirës. **"Sikur të qëndronin në rrugën e vërtetë (istikamet), ne do t'u jepnim ujë të bollshëm"**.

Një ditë Profeti (a.s.) tek po rrinte me shokët e tij, vizatoi një vijë të drejtë dhe pastaj në krah të saj vizatoi disa vija të tjera. Duke treguar vijën kryesore ai lexoi ajetin **"Kjo është rruga ime e drejtë"** (el En'am, 153). (Ibn Maxhe, Mukad-dime, 2).

Nga ajeti dhe hadithi i mësipërm Muhiddin Arabiu gjykon se istikameti është vija e jetës së Muhamedit (a.s.), ai flet për istikametin Muhamedian. Gjithashtu duke u nisur nga ajeti **"Zoti im është në rrugën e drejtë"** ai zbulon edhe istikametin hyjnor. Sepse ajeti që flet për istikametin hyjnor është vazhdim i ajetit **"S'ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e tij"** (Hud, 11/56). Prandaj në këtë univers ka një istikamet profetik dhe njerëzor që është një vijë juridike sipas modelit profetik dhe një istikamet qenësor të ndërtuar me ligjet hyjnore. Njeri i plotësuar është ai që i arrin të dy këto istikamete.

Predikimi Islamit në planin universal: Të bëhemi zëdhënësit e të drejtës dhe të bukurës

Flitet se njerëzimi kaloi nga shoqëria industriale në atë të informacionit. Flitet gjithashtu se mjetet e komunikimit e kanë kthyer botën në një fshat universal. Theksohet se globalizmi i ka bërë të prekshme dhe të depërtueshme lëvizjet për pasuri dhe grumbullimin e informacionit dhe të përvojës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për strukturat politike. Punët e brendshme dhe të jashtme të kombeve janë në një përzjerje të plotë. Si rezultat i të gjitha këtyre, miliona njerëz të feve dhe kulturave të ndryshme emigrojnë nga një vend në tjetrin dhe futen në një situatë apo rrethanë të paparë të periudhave të vjetra

Por një situatë e tillë ka një pamje kontradiktore. Vihet re gjithashtu se globalizmi i ka hapur rrugën për të dalë në plan të parë kulturave vendase, në të njëjtat përmasa dhe besimit dhe botëkuptimit në të cilin mbështeten këto kultura, të paktën i ka hapur rrugë edhe arritjes së një suksesi në raport me lidhjen e tyre me globalizmin.

Pikësëpari del si domosdoshmëri që të bëhet një dallim mes konceptit globalizëm dhe universal. Ndërkohë që koncepti global shpreh një përfshirje që i përket hapësirës, koncepti mbi universalen shpreh përmbajtjen e cila quhet edhe e vërteta. Ne, myslimanët, besojmë se feja jonë e ndritur Islame, me të cilën jemi të lidhur dhe për të cilën kemi nderin të jemi pjesëtarë të saj,

është një e vërtetë hyjnore dhe kjo e vërtetë është dërguar për gjithë njerëzit. Allahu i bën thirrje gjithë njerëzimit (O ju njerëz!) dhe Islami është dërguar si mëshirë për të gjitha shoqëritë kështu që de-tyra jonë e parë si myslimanë që jemi është që mos ta humbasim këtë perspektivë dhe me një vetëbesim të theksojmë përherë idenë se feja jona është universale. Përkatesia jonë në këtë fe më shumë se ç'është e përcaktuar në aspektin global, është e lidhur më në detaj me një anë psikologjike e cila nuk do ta ndryshojë ndjenjën e përkatësisë sonë edhe sikur në sipërfaqen e tokës të mbesë qoftë edhe një mysliman i vetëm. Mund të themi se Pejgamberi ynë është pejgamberi i fundit dhe tashmë, meqenëse nuk do të ketë fe nga ana e Zotit, ai është formuar me atë aftësi për

Feja jonë e ndritur
Islame, me të cilën
jemi të lidhur dhe për
të cilën kemi nderin
të jemi pjesëtarë
të saj, është një e
vërtetë hyjnore dhe
kjo e vërtetë është
dërguar për gjithë
njerëzit

të bërë më të mundshmen për Islam-in përkundrejt ndryshimeve që do të jetojë njerëzimi deri në ditën e gjykimit. Atëherë bëhet fjalë për kushte dhe mundësi të reja që do t'u lindin pjesëtarëve të tij edhe në rastin e njerzishmërisë që jetojmë. E rëndësishme është të tregojmë atë kulturë dhe dije për të qenë të çiltër dhe të gatshëm shpirtërisht për këto mundësi shpirtërore.

Sipas mendimit tim, në procesin e globalizmit, ajo që do të na ndriçojë më shumë për mundësitë e dhëna është "njohja" e terminologjisë kuranore. Allahu na tregon neve se struktura të ndryshme etnike, sociale dhe kulturore i ka krijuar mbi bazën e një mirësie dhe që kjo mirësi është pikërisht "njohja" Në këtë situatë, ne do të jemi të guximshëm që të sillemi sipas nevojës së kësaj mirësie ndaj vlerave kulturore të ndryshme dhe sistemeve të besimit dhe do të shtojmë intensitetin për dije, njohje, lidhje, dialog dhe aktivitete. Por që është e nevojshme që të tregohet i njëjti guxim edhe për të ashtuquajturën "qëndrim në vetveten tonë".

Është një e vërtetë që ka debate të shumta dhe intensive në lidhje me Islam-in si në vendin tonë ashtu edhe në botë. Është e qartë nga ana tjetër se këto debate nuk burojnë nga thelbi i Islamit. Pra në fakt ajo që debatohet nuk është vetë Islami por mënyra e konceptimit dhe e zbatimit. Për sa i përket këtij dallimi apo kësaj ndarjeje, ne si myslimanë duhet

që të jemi përherë të vetëdijshëm. Përveç kësaj, fëmijët që qëndrojnë të ftohtë ndaj Islamit apo që kanë qëndruar të distancuar nga kjo fenë të shumtën e rasteve, nuk është se nuk kanë arritur ta mësojnë të vërtetën e Islamit, por ato janë në këtë gjendje për shkak të gabimeve në mënyrën e konceptimit dhe të praktikimit apo zbatimit të fesë. Përveç kësaj, në mënyrën e vënies në diskutim të çështjeve, qëllimet e manipulimit për mungesën e kohës, të vendit, për artificialitet e për më tepër qëllimet e këqija që vihen në dukje herë pas here, zgjojnë tek njeriu idenë se këto diskutime nuk kryejnë një funksion drejtues në informimin e plotë dhe të saktë në lidhje me Islamin. Përkundrazi ajo që vihet re është një ngatërrim i mendjes së njeriut. Diskutimet në lidhje me Islamin në botë (veçanërisht në Evropë dhe në Amerikë) në të shumtën e rasteve faktikisht janë një prodhim mediatic dhe e vërteta është se ato vihen në zbatim rreth konceptit të fundamentalizmit që është në lidhje me Krishterimin. Kohët e fundit për tipat fetar që kanë botëkuptime të ngushta, u shtua edhe një emërtim tjetër "terrorist". Është e qartë se këto janë manipulacione artificiale dhe me qëllim të keq dhe në shumë raste dalin në diskutim si çështje të ditës të lidhura me manovra politike. Koncepti i Islamit që vuri në dukje tradita orientaliste në Perëndim, zakonisht doli në dukje me krahasimet teologjike; në fakt interesat politike studimet Islame i kanë drejtuar më tepër në ditët tona se në të kaluarën dhe vendin e përmbajtjes teologjike e zuri përmbajtja shkencore dhe sociale. Por përsëri mund të thuhet se traditat orientale në debatet intelektuale lidhur me Islamin në një raport të caktuar, janë influencuese. Zemra ta do që edhe në debatet e hapura të vihet re mbështetja në një bazë ideore dhe shkencore, dëshiron të shohë rolin drejtues të autoritetit shkencor. Fatkeqësisht në vendin tonë, në të shumtën e rasteve, debatet në lidhje me Islamin i drejton media dhe ngatërrimi që i bën



Nëse pjesëtarët e Islamit mbesin mbrapa në edukimin e zgjedhësve shpirtëror të tyre apo nuk u japin rëndësi intelektualëve të vërtetë të arsimuar, format e perceptimit të Islamit bien pre e gabimeve të perspektivave të ndryshme dhe e vërteta e Tij nuk del në pah

media dy koncepteve të lajmit dhe të informimit ose nuk dëshiron që të ndriçojë përherë në të dhëna të drejta në lidhje me temën, mund të lindin imazhe të shtrembëta dhe konceptime të gabuara rreth Islamit. Ajo që mund të bëhet është që çdo institucion mediatic të fusë në gjirin e vet individë të posaçëm që dinë në lidhje me Islamin dhe të marrë informacion prej tij.

Të gjithë njerëzit fetarë që mbarin shqetësimin e të ardhmes së Islamit, duhen medoemos që të marrin masa për rritjen akoma edhe më shumë të kapacitetit të shoqërisë intelektuale myslimane. Pasi nëse pjesëtarët e Islamit mbesin mbrapa në edukimin e zgjedhësve shpirtëror të tyre apo nuk u japin rëndësi intelektualëve të vërtetë të arsimuar, format e perceptimit të Islamit bien pre e gabimeve të perspektivave të ndryshme dhe e vërteta e Tij nuk del në pah.

Unë mendoj se në vend që të flasim për problemin e imazhit të Islamit pikësepari duhet që të flasim për imazhet e padrejta dhe jashtë të vërtetave të prodhuara për myslimanët. Por si të dëshironi mos të ndalemi tani në mënyrë të veçantë tek çështja se çfarë imazhi për myslimanin është krijuar për vite me radhë nëpër gazeta, revista dhe nëpër filma të kinemave. Pasi tashmë këto fjalë pa baza nuk kanë më vlerë dhe populli fetar është akoma i sigurt plotësisht në vlerat e larta të Islamit në të cilat numërohen edhe bazat e ekzistencës së tij. Pra mund të flitet për përplasje të imazhit dhe qëllim të keq për Islamin dhe jo për një përplasje që bie ndesh me natyrën e njeriut në lidhje me thelbin e estetikës dhe të etikës së Islamit.

Nga ana tjetër, mund të bëhet fjalë edhe për një zgjim të imazhit negativ për vëllezërit tanë myslimanë të cilët nuk janë formuar ashtu siç duhet dhe ashtu siç e kërkon edhe predikimi fetar, por që aty ku ndodhen kanë fituar vetvetiu pozicionin për të përfaqësuar Islamin, dhe kjo në mënyrë të pavetëdijshme për ata që nuk kanë interes dhe informim të mjaftueshëm për Islamin. Pra imazhi negativ mund të burojë edhe nga vetë pasiguria jonë. Ajo që duam të themi me "formimin ashtu siç e kërkon feja" në lidhje me temën në fjalë është që një mysliman të ketë mundësi të paraqesë anën shpirtërore të Islamit në një ambient ku takohet dija dhe estetika. Kjo pasi komentimi apo zbatimi i parimeve fetare në kundërshtim me shpirtin dhe mirësinë e fesë padyshim që mund të lind rezultate në kundërshtim me fenë dhe duke u nisur pikërisht nga këto rezultate, mund të lindin imazhe negative në mendjen e atyre që dëshirojnë të kenë ide dhe mendime mbi Islamin. Atëherë nëse bëhet fjalë për imazhet negative që burojnë nga komentet dhe zbatimet e njerëzve fetarë, shpjegohet shkalla e dijës së tyre në lidhje me fenë ose është e nevojshme t'u tregoj



“E vërteta” e koncepteve
 si mendje, shkencë, e
 vërtetë, individ, liri, të drejtat
 njerëzore... janë në Islam.
 I gjithë problemi është që të
 gjitha këto të vërteta të dalin
 në pah me përpikmëri për
 njeriun bashkëkohor

het se nuk mjafton vetëm të çojnë në vend kushtet e formës, por që duhet të zbatohet edhe thelbin e parimeve. Dhe kjo realizohet duke i vënë në jetë parimet etike që ne i quajmë “edukatë”, pra ai do ta tregojë veten e vet edhe kur haset apo ballafaqohet me parimet bazë të estetikës përveç se me ato etike. Nuk duhet harruar asnjëherë se në konceptin e të vërtetës e drejta dhe e bukura janë në përputhje me njëra-tjetrën. Nëse realizohet një gjë e tillë, shoqëria myslimane do të jetë një xhema që do të dëshirojë edhe shoqërinë jomyslimane bile ata do të arrijnë deri aty sa të thonë “pse nuk jam edhe unë njëri prej tyre”

Filozofia e kohës së shndritshme i komentoj përsëri nën dritën e kësaj tematike këto koncepte dhe ky komentim i bërë sot i ngjyrosi me bojën e vet shumë fusha të jetës sonë. Moderniteti kur u mor si një mendim i kohës, si një mentalitet dhe konceptim filozofik, u duk sikur e ndjeu veten plotësisht të pavarur përkundrejt çështjes së pejgamberllëkut dhe të shpalljes dhe vende-vende mori edhe një qëndrim negativ. Por që në një qëndrim të tillë pati pjesën e vet edhe reagimi që u ndie ndaj zbatimeve fetare në gjeografinë në të cilën lindi moderniteti.

Por sapo u vu re se nuk u realizua ideja e krijimit të një xheneti të modernizmit, filluan që të ndje-

heshin edhe më tepër boshllëqet dhe përplasjet e kësaj ideje të botës dhe filluan të intensifikoheshin edhe më tepër kritikën negative të drejtuara modernizmit. Këto kritika nuk erdhën vetëm nga ato që kishin mbetur të pezmatuar nga fakti se ç’ përfundim kishte pësuar qytetërimi perëndimor modern dhe shoqëritë që vinin pas tij. Shumë intelektualë të vetëdijshëm për të vërtetën e traditave fetare dhe shpirtërore theksuan me insistim se vendi i boshatisur nga feja në botën moderne mund të mbushet vetëm me fe dhe vazhduan t’i bënin thirrje njeriut modern për t’u kthyer drejt fesë. Edhe ideja e postmodernizmit që kritikon me sa të ketë mundësi konceptet në fjalë të periudhës së shndritshme dhe që përpiqet të nxjerrë në dukje faktin se ajo nuk ka bazë të saj, pati një vend jo të dukshëm në kritikën moderne. Tani për tani format jonihiliste të postmodernizmit duke i vazhduar këto kritika nga njëra anë, nga ana tjetër po provon të kapërcejë komentet që tregojnë sikur feja me shkencën dhe mendja me njeriun janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe këtë në përkrahje të fesë dhe besimit. Shkurtimisht tashmë vetë moderniteti gjendet përballë një ballafaqimi dhe është në ato preokupimet e mbrojtjes së ligjësisë së vet me tezën se është një projekt akoma i papërfunduar.

Për sa i përket fesë Islame ato kritika që i ka merituar modernite-

ti i përfshin në sistemin e konceptit të vet. Dhe ajo që është më e çuditshmeja “e vërteta” e koncepteve si mendje, shkencë, e vërtetë, individ, liri, të drejtat njerëzore... janë në Islam. I gjithë problemi është që të gjitha këto të vërteta të dalin në pah me përpikmëri për njeriun bashkëkohor. Por ndërkohë që bëhet kjo, duhet të konceptohet mirë Islami dhe moderniteti dhe të mos u jepet shkak përzierjeve të reja mendore. Gjëja e parë që duhet të dihet në këtë rrugë është që tipi i njeriut që ka krijuar modernitetin është një qenie “që jeton sikur nuk do të vdesë hiç” dhe që çdo gjë në teknologji është organizuar sipas përcaktimit të këtij njeriu.

Nëse ajo që kuptohet me modernizmin në kohën tonë, është bashkëkohorja, atëherë Islami është përherë bashkëkohor. Shkurtimisht Islami nuk përbëhet nga mbledhja e besimeve të pranueshme në një shekull, nga ndjenja dhe mendime si dhe nga gjykime me vlerë, por është një udhëzues për të gjitha kohërat dhe veprat njerëzore.

E gjithë sipërfaqja e rruzullit tokësor na është bërë mesxhit. Ata që kanë pranuar Islamin deri tani kanë pasur nderin të jenë edhe ymet i Pejgamberit (a.s). Ndërsa ata që nuk janë, janë ymeti i ftuar... Në këtë mënyrë i gjithë njerëzimi është ymeti Islam. Duke pasur parasysh që Islami nuk i përket vetëm një vendi të caktuar,

atëherë myslimanët e kanë për detyrë t'ia transmetojnë gjithë botës mesazhin e fesë. Faktikisht kjo detyrë e merr parimin e saj nga e vërteta e natyrshme. Edhe pse karakteret, zakonet dhe kulturat janë të ndryshme, natyrat e njerëzve janë një dhe Islami i flet kësaj natyre të përbashkët që përfshin edhe konceptin e mendjes së shëndoshë. Për më tepër, fjala hyjnore universalitetin e saj e pasqyron në universalitetin e natyrës. Natyra e kushtëzuar, e devijuar dhe e helmuar në një mënyrë, kur arrin kthimin tek vetvetja nën influencën shëruese të mesazhit, do të thotë se tashmë e ka arritur Islamin. Kështu detyra e predikimit të myslimanit në mbarë botën është përpjekja për të hequr pengesat që kanë hyrë mes njeriut dhe natyrës së shëndetshme. Këto pengesa kanë lidhje shumë të hapur me botën shpirtërore dhe mendore dhe në këtë përpjekje del qartë se sa e domosdoshme është që myslimani të ketë formim të plotë dhe në një shkallë të lartë shkencore, ideore, etike dhe teknike. Ne, të gjithë myslimanët që jemi të ngarkuar me këtë detyrë në fjalë, nuk jam i mendimit se nuk kemi aftësi të plota aq sa i kërkon edhe Predikimi Islam. Ne duhet të marrim masa që nuk kapërcejnë kushtet tona për të arritur pikërisht këtë plotësim në fjalë. Për të fituar këtë forcë të nevojshme kemi nevojë për shumë dije, për shumë përpjekje dhe për shumë dua. Ne duhet të vazhdojmë në këtë rrugë pa humbur dashurinë dhe shpresën tonë.

“Ne duhet t’u afrohemi njerëzve me dashurinë për njeriun”

Unë jam i mendimit se të gjitha mangësitë që mund të numërohen burojnë nga vetja jonë. Robi nuk është përgjegjës për suksesin, por për qëllimin e mirë, mundimin dhe sakrificën, por a bëheni vallë shumë mosmirënjohës nëse themi se mossuksesi buron nga mangësia në qëllimin e mirë, mundim dhe sakrificë? Padyshim që kur themi për mundimin dhe sakrificën bëjmë fjalë për mundimin dhe



Interesat politike
studimet Islame i
kanë drejtuar më
tepër në ditët tona se
në të kaluarën dhe
vendin e përmbajtjes
teologjike e zuri
përmbajtja shkencore
dhe sociale

sakrificën “ashtu siç duhet”. Pra në përshtatje me shpirtin e punës dhe mirësinë... Ai me të cilin ne komunikojmë është njeriu. Ne duhet të analizojmë kushtëzimet mendore të njeriut me të cilin komunikojmë, nëse ka dobësitë etike, preferencat politike, idetë psikologjike të hedhura këto në një llogari të shkaqeve dhe arsyeve dhe t’u flasim njerëzve “sipas mendjeve të tyre”. Nuk duhet të harrojmë se njerëzve u është dhënë forca dhe liria e mohimit të Allahut nga ana e Allahut. Por ata të cilët zemrën e kanë të vdekur dhe si rezultat të vulosur, ata janë të veçuar, gjithashtu edhe që çdo mohues është një besimtar me potencial.. Ndjenja e neverisë është e papranueshme. Udhëzimi i takon Allahut. Ne mund të mërzitemi se pse njerëzit i kthejnë shpinën Allahut, por që nuk është e nevojshme të shkatërrojmë veten tonë. E rëndësishme është të rro-

kim detyrën. Në mënyrë të veçantë ne duhet që të jemi “besnikë” dhe të kemi të gjitha mirësitë e kësaj cilësie. Njerëzit me të cilët duam të komunikojmë, duhet të na besojnë duke u influencuar nga mirësitë që kemi. Atyre duhet t’u afrohemi me dashurinë e një njeriu të vërtetë. Pejgamberi ynë i dashur në Taif u bënte dua atyre që e gjuanin me gurë “Zoti im, fali ata se nuk dinë” Njeriu vjen nga shoqëria. Nëse qëllimi është që të komunikojmë me ata që kanë probleme me vlerat e Islamit, atëherë ajo që duhet të bëjmë është që të heqim të gjitha pengesat e çdo lloj mosmarrëveshjeje mes tyre. Nëse ata nuk na vijnë, ne duhet t’u shkojmë. Kur them që duhet të shkojmë kuptoj çdo vend që mund të shkojmë duke filluar që nga njeriu që banon pranë hyrjes së pallatit e deri tek ai që jeton në fund të botës. Njerëzit me të cilët përpigemi të komunikojmë që në hapin e parë duhet të kuptojnë se jemi të besueshëm, të afërt me të tjerët, të buzëqeshur, njerëzor, që jemi përkrah ndihmës, të ditur, njerëz që dimë atë që flasim, pra shkurt njerëz të gatshëm për komunikim. Nëse nuk e kemi në dorë “t’i bindim” të paktën e kemi në dorë që “t’u japim mundësi të dëgjojnë” dhe faktikisht detyra jonë kjo është. Nëse shoqëria ka lidhje me të qenit njeri, atëherë fillimisht është e nevojshme që të plotësojmë nevojat e vëllezërve tanë, të lehtësojmë dhimbjet e tyre, t’u qëndrojmë afër në ditë të vështira, të ndajmë me ta dhimbjet dhe gëzimet, pra shkurtimisht të jemi në mesin e tyre. Tashmë duhet të heqim dorë nga botëkuptimi i xhematit të mbyllur që predikon vetëm vetes së vet dhe duhet t’i drejtohemi temës së vërtetë të predikimit. Armiku më i madh i predikimit universal është psikologjia geto. Kjo do të thotë të mbyllesh në një kamp para se të kalosh në shoqërinë e hixhretit. Një përpjekje predikimi që ka një perspektivë të tillë do të jetë i zoti të formojë institucionet e veta.



VETMIA

Njerëzit për të plotësuar nevojat materiale dhe shpirtërore përgjatë gjithë rrjedhës së jetës së tyre, e kanë të domosdoshme ndihmën ndaj njëri-tjetrit. Kjo ndihmesë bën të mundur dhe formimin e marrëdhënieve të duhura për një shoqëri të qytetëruar. Fatkeqësisht kur ballafaqohet me një gjendje të tillë përpara tij do të shfaqet një problem i madh dhe tronditës. Ky problem është aq negativ saqë na bën të mendojmë se e gjithë jeta është kthyer në një nyje qorre dhe në çdo lidhje të saj ndodhet nga një person. Emri i kësaj nyje qorre nuk është tjetër përveçse vetmia.

Njerëzit tanë qoftë në ambiente familjare, si dhe në ato edukative-shoqërore, duket sikur bashkëjetojnë me shumë njerëz përreth, por fatkeqësisht kjo dukje është vetëm në pamje të jashtme, në të vërtetë ata jetojnë krejt të vetëm.

Vetmia....

Nuk ka gjë më shkatërruese dhe thyese për njeriun se të ndjejë vetmi duke qenë në mesin e njerëzve.

Veprimet jo etike, si: mosbesimi, mos mbajtja e fjalës, paragjykimi, gënjeshtria, thashethemet, pakujdesia ndaj sensit të mëshirës, padrejtësia dhe haku ndaj tjetrit, po e shkatërrojnë njerëzinë dhe për këtë shkak nuk ka besueshmëri brenda saj.

Pothuajse të gjithë, duke qenë mes njerëzish po jetojnë në skutat

e një vetmie trishtuese.

Edhe ata njerëz të ndjeshëm të cilët e vënë re këtë problem, e denoncojnë dhe kërkojnë një zgjidhje për "vetminë", nga vështrësia e paafësisë për t'i thënë: Ndal! këtij fenomeni, humbasin nëpër errësirat e një vetmie tjetër.

Një grua që jeton në një vend ku përreth ka plot komshinj dhe njerëz të afërt, në qoftë se ajo do të përjetojë një grindje me bashkëshortin ose me një nga pjesëtarët e familjes së saj, këto situata ia ngushtojnë shpirtin. Duke kërkuar një person që ta qetësojë nga kjo gjendje, megjithëse rreth saj ka komshinj dhe të njohur, ajo e kupton se është e vetme, nëse do t'i hap derën dikujt për t'i hapur zemrën dhe treguar hallet apo problemet që ka, edhe nëse do ta porosisë, -"Të lutem mos i thuaj askujt", është e sigurtë dhe e di mirë se ndoshta pa u kthyer ende në shtëpi, një komshi tjetër do t'i marrë vesh të gjitha problemet dhe hallet e saj.

Një punëtor i cili punon në çfarëdolloj ambienti, sikur një problem të tijin ta ndajë me dikë, e din mirë se në momentin kur ai të largohet nga mjediset e punës, problemet e tij do t'ia marrin vesh të gjithë kolegët e tjerë.

Ky fenomen është i njëjtë si për burrat dhe gratë, si për intelektualët dhe për punëtorët e thjeshtë.

Në fakt sa shumë nevojë ka njeriu që t'i zbrazë të gjitha problemet e tija në një pus të pafund.

Në momentin kur vetmia ia pushton zemrën njeriut, aplikimi apo zgjidhja më dinjitoze e tij është fjala e Allahut të lartmadhëruar: "Unë jam më pranë jush se damari i qafës".

Por mërzia që i shkaktohet nga padija se si mund t'ia përcjellë dëshirën që ka Zotit të tij, e bën atë që ndoshta të kërkojë zgjidhje ose shpëtim në adresa të gabuara.

Njeriu ynë i cili nuk është trashëgimtar në besim, i panjoftuar për mbrojtjen e veçantë të adhurimit, si dhe mosshijues i bukurisë morale, është i zhytur në gjendje depresive.

Vetmia është duke e shkatërruar aq shumë njerëzimin saqë gratë, burrat, fëmijët si dhe të gjithë shoqëritë nuk e kanë për gjë që të shtypin dhe nëpërkëmbin njëri-tjetrin.

Dhe ata të cilët kërkojnë një zgjidhje në karriget e psikiatrisë, nga njëra anë bëjnë terapi dhe nga ana tjetër zbrazin xhepat. Ndërsa për ata të cilët nuk kanë para ose librezë sociale, "vetmia" është një fakt i pashmangshëm.

Shpresa të zhdukura, familje të shkatërruara, gra pa mbështetje, fëmijë jetim, pleq të përvëlur nga malli për bijtë e tyre që presin nëpër qoshet e vetmisë.

Tashmë në jetën tonë nuk ekziston më një kopsht i bukur durimi. Jetojmë në një botë ku janë tharë farëzat e luleve të durimit dhe vendin e tyre e kanë zënë bimët gjembaçe.

Në këtë shtet që ndoshta nga natyra tepër magjepse, po jetojnë dhe bëhen faktike gjëra të padëgjueshme më parë. Burra që nuk u dalin për zot familjeve të tyre, gra që nuk gjykojnë për braktisjen e fëmijëve të tyre në mes të rrugës, vlerësim i papërgjegjshëm me anë të justifikimeve të ndryshme, njerëz që lënë pas dore fëmijët dhe familjet e tyre, dhe çuditërisht për mbrojtje shfaqin maskën e drejtësisë përballë të tjerëve.

Nuk mund të qëndroj pa e pyetur veten kur shoh njerëz pa mbështetje.

Ku është vallë shenjtëria e familjes?

Në mosmarrëveshjen më të vogël të rinjtë janë flamurtarë të ndarjes nga njëri-tjetri. Të rinj nga familje të njohura u japin fund martesave kushedi sa vjeçare, dhe çuditërisht për këtë familjet as që preokupohen apo shqetësohen.

Ku janë ato fjalë të të parëve tanë që thoshin; "O ju të rinj, bëni durim se do të kalojnë shumë shpejt këto ditë, nëse ti sillesh mirë dhe bashkëshorti yt do të sillet mirë ndaj teje".

Në momentin kur vetmia ia pushton zemrën njeriut, aplikimi apo zgjidhja më dinjitoze e tij është fjala e Allahut të lartmadhëruar: "Unë jam më pranë jush se damari i qafës"

Thuhet se çdo përfundim të mjerë ose fatkeqësi e vuajnë fëmijët, por faktikisht ata bien mbi gjithë shoqërinë mbarë.

Shkaqe për shtimin e ndarjeve janë mosbesimi në familje, komshinjtë apo të afërm të panevojshëm. Pasi vetë faktori "shoqëri" është shumë i rëndësishëm për vazhdimësinë e lumturisë për një familje.

Ku janë ata këshilltarë që me mbështetjen e tyre materiale dhe shpirtërore, mundohen të zbusin të dy palët qoftë për një mosmarrëveshje krejt të vogël, ata të cilët tregojnë rëndësinë e të qenit bashkëshort apo bashkëshorte?

Ata që tregojnë peshën e rëndë të të qenit prind si dhe pamundësinë e jetës normale për fëmijët pa nënë dhe baba, ku janë vallë këshillat e tyre me aftësi depërtuese në zemrën e shoqërisë?

Ku janë ato nëna, baballarë, gjyshe dhe gjyshër që thoshin: "Bëhu i dashur ndaj gruas tënde, se ajo është nderi yt! - Kujdes të mos gabosh, dhe dili për zot familjes tënde, sillo mirë me gruan tënde që të kesh marrëdhënie të mira me të".

Në qoftë se kushërinjtë, komshinjtë, si dhe e gjithë shoqëria që e rrethon një familje të ishin pozitive, atëherë përfundimi i marrëveshjeve sociale dhe marrëdhëniet midis bashkëshortësh do të ishin shumë më të forta.

Ndoshta për këtë arsye në vendet ku ka popullsi të pakët edhe ndarjet janë të pakta, ndërsa në qytete me popullsi të mëdha shoqëria përballet shpesh me faktorin ndarje.

Sikur të gjendej dikush që t'u përgjigjej vetëm disave prej këtyre pyetjeve ndoshta shumëkush do të shpëtonte nga vetmia.



Ku janë ata të cilët mendojnë se zbatojnë kushtetutën e thënies: "Nuk është prej nesh ai i cili fle gjatë kohës kur komshiu i tij është i uritur e në nevojë"?

Ku është thënia e dijetarëve të mëdhenj: "Çdokush mund të kalojë mirë me të mirin, e rëndësishme është të përballosh dhe të bësh durim ndaj fqinjit të lig"?

Ku janë ata bij e bija që tregojnë respekt ndaj prindit, u japin vendin më kryesor në shtëpi, marrin dobi prej përvojës së tyre, bëjnë durim ndaj kapriçove të tyre të pleqërisë dhe drujnë nga shfryrja "uf" qoftë edhe për një herë të vetme.

Ku janë ata baballarë që kthehen në kohë në shtëpi vetëm për të mos i lënë në pritje familjet e tyre, ndajnë të njëjtën tryezë me ta, interesohen për problemet dhe shkollimin e fëmijëve?

Krijimi i shoqërive të vërteta, pranimit i njerëzve me gjithë ndryshueshmërinë e tyre, dashuria vetëm për hir të Allahut si dhe ndryshimi i psikologjisë sonë nga "unë" në "ne", do ta shpëtonin njeriun tonë nga vetmia. Sepse ai i cili nuk mund të krijojë marrëdhënie të mira me njerëzit kurrsesi nuk mund të krijojë marrëdhënie të mira me Allahun.

NJERIU I MENÇUR

“Njeriu i mençur është ai që di ta mbajë veten dhe që punon për jetën e përtejme. Ndërsa njeriu i pafuqishëm është ai që nuk e përmban veten e vet dhe ai që vetëm kërkon nga Allahu.”

Sipas transmetimit të Sheddad b. Evs Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Njeriu i mençur është ai që di ta mbajë veten dhe që punon për jetën e përtejme. Ndërsa njeriu i pafuqishëm është ai që nuk e përmban veten e vet dhe ai që vetëm kërkon nga Allahu.” (Tirmidhi, Kijame, 25; Ibn Maxhe, Zuhd 31; Ahmed bin Hanbel IV, 124, Hakim, el-Mustedrek, IV, 251)

Në çdo sistem dhe bile sipas çdo njeriu ka një përcaktim të “njeriut të mençur”. Këto përcaktime bëhen duke u pranuar si “të rëndësishme” për nga natyra. Por çdo lloj përcaktimi që merr në konsideratë çdo lloj vlere apo më saktë një përcaktim që do të mund të bëhet “sipas të vërtetës së njeriut dhe jetës” padyshim që do të jetë më ndryshe. Ja pra, përcaktimi i hadithit tonë na nxjerr para nesh një tematikë dhe përmbajtje të tillë. Një përcaktim që i sjell mençurisë edhe anën e “ahiretit” ...

Njeriu që është përgjegjës në një botë të fundme dhe që ka një jetë të caktuar duke analizuar botën dhe jetën e përtejme, krejt natyrshëm, mbetet nën influencën e disa fokusimeve të caktuara. Bota, nefs, uni dhe shejtani janë disa nga këto fokusime. Mes punëve që i japin formë mënyrës së sjelljes dhe veprimeve të njeriut, një tjetër fokusim influencues që mundëson analizimin dhe perceptimin më në detaj dhe në një spektër më të gjerë të ngjarjeve, është edhe besimi.

Treguesit e mençurisë që i përcakton hadithi ynë si: “mbajtja nën kontroll e vetvetes” dhe “përpjekja për jetën e përtejme” janë të lidhura mjaft ngushtë me një besim të plotë. Padyshim që ditët dhe stinët në të cilat shtohet ndikimi edhe i besimit kanë një lloj pranvere. Është pikërisht ajo ripërtëritje në verë e gjithësisë e cila është aq e fuqishme sa të tërheqë vëmendjen e secilit. Dhe arsyeja është ngaqë kemi një zhvillim të përgjithshëm. Stinët në të cilat robëria dhe sjelljet fetare janë më intensive, sikurse është Ramazani, janë më të qeta dhe më shpirtërore meqenëse jetojnë në një shoqëri madje me gjithë ymetin. Pra nëse shoqëria do të ndajë të njëjtën jetë, lumturia dhe qetësia që lind nga influenza e besimit do të rritet në gjithë shoqërinë dhe do të përfshijë çdo drejtim.

Nga ana tjetër, këto lloj stinësh janë mundësi të mëdha për të siguruar “vetëkontrollin” që është shumë më e vështirë për t’u arritur në kohët e tjera. Edhe “të punosh për jetën pas vdekjes” shumë natyrshëm është e lidhur me arrijten në një masë të madhe të “vetëkontrollit”. E thënë ndryshe, çdokush që përpjeket të shfrytëzojë këto ditë, do të jetë i futur në rrugën e mençurisë aq sa të jetë përpjekur.

“Vetëkontrolli” do të thotë të përqendrosh mendjen tek jeta brenda parimeve të Islamit. Kurse lumturia në “ahiret” është një rezultat i natyrshëm i një jetë të këndshme nën kontrollin e mendjes. Dhe në fakt edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) në një tjetër hadith të Tij

urdhëron e thotë: *“Vlera e vërtetë e punëve matet sipas rezultateve”* (Buhari, Kader, 5, Rikak, 33). Edhe dija dhe vullneti i njeriu bëhen të ditur pikërisht në ahiret. Ai që arrin të japë llogarinë në botën tjetër faqebardhë është një person i lumtur që arrin të mbartë botën me të gjitha mirësitë në jetën e përtejme, në ahiret. Sido që të jenë vlerësimet e njerëzve të kësaj bote për të, nuk kanë asnjë rëndësi. Njeriu që i vlerëson sjelljet e tij duke marrë parasysh rezultatet në ahiret, do të dijë të vlerësojë edhe botën edhe njerëzit dhe gjërat e kësaj bote ashtu siç e meritojnë. Ja pra, edhe “njerëzit që i kalojnë rrethin e tyre” në këtë kuptim janë “të mençur”

Edhe ajeti kuranor **“Secili t’i kushtojë kujdes së çfarë i ka dhënë të nesërmes!”** dokumenton faktin se sa të mençur dhe inteligjentë janë treguar ata që “punojnë për pas vdekjes” Edhe Tirmidhi (v.

Përpara se të kaloni në dhënie e llogarisë, i jepni llogari së pari vetes suaj. Bëni përgatitje për takimin e madh. Llogaria në ditën e gjykimit është e lehtë vetëm për ata që i kanë kërkuar llogari vetes së tyre në këtë botë.

Të shpresosh faljen e Allahut në një situatë të tillë, e thënë me një shprehje kabahe të thuash "Nëse Allahu nuk do të më falë as mua kë do të falë" është "të mashtrohesh me Allahun" Kurse në fakt "të zhgënjehesh me Allahun do të thotë të vazhdosh me gjynahe dhe të shpresosh faljen

279/892) pasi thekson se hadithi është "i saktë" tërheq vëmendjen se shprehja "men dane nefsehu" që e kemi përkthyer si "ai që kontrollon veten e tij" do të thotë "Ai që i kërkon llogari vetes së vet para se të dalë në llogari në ditën e gjykimit", më pas ai transmeton edhe këto ide që e mbështesin këtë kuptim. Mendimi i parë është i Hz. Umerit... Ai pati thënë:

"- Përpara se të kaloni në dhënien e llogarisë, i jepni llogari së pari vetes suaj. Bëni përgatitje për takimin e madh. Llogaria në ditën e gjykimit është e lehtë vetëm për ata që i kanë kërkuar llogari vetes së tyre në këtë botë."

Kurse mendimi i dytë i përket Mejmun b. Mihran. Edhe ai patë thënë:

"- Nuk mund të bëhet kurrë i devotshëm një rob pa e vënë në provë nefsin e vet ashtu sikurse e kontrollon vazhdimisht ortakun e tij të punës duke e pyetur se prej nga vjen veshja dhe ushqimi."

Faktikisht ashtu sikurse e kanë theksuar edhe muhadithinët përkundrejt fjalës "i mençur" është fjala "sefih". Por në hadithin tonë është përdorur fjala "i pafuqishëm" Dhe në fakt e kundërta e "i pafuqishëm" është "i fuqishëm"

Ndërsa një fjalë e tillë nuk është përdorur në hadithin tonë. Si rezultat përdorimi në të tregon që "i mençuri" është i fuqishëm ndërsa "i pafuqishmi" është sefih.

Shprehjet "ta bindësh nefsin ndaj kërkesave vetjake" dhe "të kërkossh prej Allahut" që kalojnë në hadith, janë përcaktuar si treguese të pafuqishmërisë dhe sefahatit. Përveç se ata nuk u dalin për zot përgjegjësisive të marra herë pas here, mëdyshja e tyre për të dhënë llogari i shtyn ata drejt premtimeve të kota, shpresave boshe. Kurse në fakt besimi dhe shpresa nuk ndryshon asgjë, vetëm se e mashton individin dhe e fut atë në një dembelizëm. Ata të cilët u janë bindur nefsit të tyre merren me mërzitjen si zgjidhje të vetme që kanë. Por që sa paralajmërimet serioze janë këto ajete: **"O njeri, ç'të mashton ty ndaj Zotit tënd që është shumë dorëdhënës i cili të krijoi dhe të dha formë, të rregulloi dhe të bëri në formën e duhur?"** (Ahmed bin Hanbel, V, 33)

"Njoftoi robtë e mi se unë jam dhurues dhe mëshirues, që dëni mi është një gjë shumë e dhembshur." (el-Hashr, 18)

Në fenë tonë nuk është e ndaluar të kërkossh nga Allahu përkundrazi një veprim i tillë është nxitur. Por për një shpresë të tillë e rëndësishme është që të bësh atë që të takon. Në ajetin 218 të surës Bakara tregohet se për të shpresuar mëshirën hyjnore, është e nevojshme realizimi i bazave themelore të fesë, si: besimi, hixhreti dhe xhihadi. Ai që mjaftohet me një kërkesë të tillë të thatë padyshim që nuk ka arritur të tregojë atë mençuri dhe vullnet që pritet prej tij që do të thotë se është mërzitur në sjelljen më të pakuptimtë në një rast serioz. Dhe një sjellje e tillë –Zoti na ruajt- sipas një ajeti Kur'anor (el-Infitar, 6) është të ndash të njëjtën pozicion me qafirët që e vendosin fenë në vend të lojës dhe argëtimit. Të shpresosh faljen e Allahut në një situatë të tillë, e thënë me një shprehje kabahe të thuash "Nëse

Allahu nuk do të më falë as mua kë do të falë" është "të mashtrohesh me Allahun" Kurse në fakt "të zhgënjehesh me Allahun do të thotë të vazhdosh me gjynahe dhe të shpresosh faljen" Njerëzve që janë në një gjendje të tillë është e nevojshme t'u tregohet ky ajet kuranor **"Ja pra kjo pandehje që kenit ushqyer ndaj Zotit tuaj ju shkatërroi dhe u bëtë prej atyre që humbën."** (Fusilet, 23)

Nga ana tjetër mos të harrohet edhe ajo që të ngushëllohesh duke krijuar situata të ndryshme është nga taktikat e shejtanit për të mashtruar njeriun. **"Ai u premtonte atyre dhe i bënë të shpresojnë, por djalli nuk pranonte tjetër vetëm se mashtrim."** (en-Nisa, 120)

Si përfundim: hadithi ynë i ka përcaktuar njerëzit "e mençur" dhe "të pafuqishëm" me cilësitë njerëzore, të natyrshëm, të gjithanshëm dhe si individë që krijojnë lidhje me njeriun e çdo besimi.

Përcaktimi i mençur-jo i mençur bëhet sipas vlerësimit dhe konceptimit të botës dhe ahiretit dhe të përgatitjes për ahiret kur je në këtë botë, dhe jo sipas pretendimeve dhe kërkesave.

Për të shfrytëzuar "mëshirën e pafundme" të Allahut të Lartë është e nevojshme të bësh atë që të takon brenda rregullave fetare, shpirtërore dhe Islame. Pasi **"Mëshira e Allahut është afër atyre që bëjnë mirësi"** (el-A'raf, 56)

Atëherë duke jetuar në mënyrë të veçantë Ditët Islame siç është muaji i madhnueshëm i Ramazanit duhet të kontrollojmë sërish veten tonë fund e krye sipas të vërtetave që përcakton hadithi ynë dhe të marrim masat e nevojshme, duhet t'i futemi një mendimi të tillë. Mendja e kërkon këtë, feja jonë e kërkon këtë, Pejgamberi ynë na e këshillon neve këtë.

Një selam jepja vetes tënde

Hapi i parë në “zhvillimin individual” është të qenit i vetëdijshëm për veten, pra të kesh respekt ndaj qenies sate që është një mrekulli e artit hyjnor për të cilën duhet marrë rruga për ta zbuluar. Ky udhëtim më pas do të marrë formën e vet sipas konceptit të udhëtarit dhe qëllimit të tij. Padyshim që “zhvillimi individual” i një parimi të kohës që ka për bazë botëkuptimin që “Kjo jetë është një pjesë e jetës së përhershme dhe ne jemi këtu për një qëllim të caktuar.” është shumë e ndryshme me filozofinë materialiste që thotë: “Jeta është vetëm jeta e kësaj bote, jetojmë dhe vdesim”.

Është i gëzueshëm fakti që kohët e fundit është rritur interesi për zhvillimin individual. Sado që në themelin e këtij orientimi bëhet fjalë për “idenë që të fitohet më tepër” kjo do të mund të bëhet shkak për të kuptuar “ajetet në brendësinë tonë” që janë një udhëtim i njeriut drejt vetes së tij. Ky udhëtim do të japë shumë fryte për sytë që shohin dhe zemrat që marrin mësim.

Zhvillimi individual nuk është zbukurimi i anës së jashtme ashtu siç mund ta kenë kuptuar disa. Ndoshta është edhe shkalla e ndjeshmërisë edhe nga jashtë të konceptimit më në detaje të çështjes. Zhvillimi individual fillimisht merr parasysh ndryshimin e paradigmave dhe më pas sipas saj formon edhe sjelljet. Kjo situatë është e njëjtë sikurse edukimi mistik që merr parasysh edukimin shpirtëror për të rregulluar sjelljet dhe

veprimet.

Është shumë tërheqës ky përcaktim i S. Covey i cili shprehet se ka gjetur mundësinë për të studiuar të gjitha veprat e botuara në Amerikë në dyqind vitet e fundit në fushën e zhvillimit individual: Tashmë kam filluar t’i besoj akoma edhe më tepër faktit se shumica e librave në lidhje me zhvillimin individual që janë shkruar gjatë periudhës së fundit pesëdhjetë vjeçare kanë mbetur shumë sipërfaqësor. Këta kanë qenë të mbushur plot me vetëdije imazhi shoqëror dhe teknika, pra me ngjitëse të sëmundjeve shoqërore. Këto këshilla zbatoheshin në zgjidhjen e problemeve të vështira dhe kishte edhe raste që ato duke-shin sikur mënjanoreshin për një kohë goftë edhe të përkohshme. Çështjet që ishin të ndrydhura ndikoheshin dhe bëheshin shkak që të dilnin shpesh herë në pah. Përkundrajt kësaj, pothuajse të gjitha librat e dalë brenda njëqind vjeçarit të parë qëndronin mbi disa principe të arta, si: sinqeriteti, zemërçiltërsia, drejtësia, maturia, guximi, durimi, të qenit punëtor dhe bërja e punëve të dobishme që mund t’i përkufizojmë si themelin e suksesit që është “etika e karakterit”. Një ideim i tillë u mësonte njerëzve se ata mund të arrinin përherë lumturinë dhe suksesin e vërtetë “Vetëm duke mësuar bazat e këtij themeli dhe duke u bashkuar me karakteret themelore të tyre”. Zhvillimi individual është shkalla e një suksesi. Ai synon formimin e një botëkuptimi për jetën dhe suksesin në të. Ai tregon rrugën se pse duhet bërë një gjë e caktuar dhe ajo që është edhe më e rëndësishmja

si duhet bërë. Ai është një udhërrëfyes ndihmës që tregon se në ç’mënyrë do ta luajë secili rolin e tij në skenën e jetës. Duke menduar se secili e ka anën e tij të drejtuesit, duke marrë parasysh se “Aftësitë e drejtimit” i jeton së bashku me të tjerët, ai e pranon “zhvillimin individual” që do të sigurojë “aftësitë e komunikimit” dhe atë që është më e rëndësishmja sigurimin e një jetese të suksesshme duke qenë i vetëdijshëm për veten. Në fakt nuk është e lehtë të vendosësh një kufi për temat e zhvillimit individual që kanë për synim zhvillimin në çdo fushë të njeriut. Kjo pasi njeriu është një botë e vogël dhe ai vazhdon të bëjë kërkime në këtë botë.

Në vendin tonë ka shumë pak për të mos thënë aspak punime apo studime në lidhje me këtë temë. Nëse i hidhet një sy librave apo punimeve në këtë fushë, do të vihet re se pjesa më e madhe është përkthim nga perëndimi. Padyshim që këto të dhëna që ne mund t’i quajmë si një grupim i një përvoje të përbashkët të njerëzimit, janë një thesar i pashtershëm. Por për sa kohë që të mos ushqehemi nga kultura dhe qytetërimi i vendit pra nga kultura që ka vendi, ato informacione mund të jenë edhe të dëmshme. Sikur të jetë e mundur që qytetërimin dhe kulturën tonë ta shihnim me syrin e “botëkuptimit të zhvillimit individual” nuk do të ishte e vështirë të zbulonim një botë të madhe dhe të pasur sa yjet që janë në qiell.

Zoti na ndihmoftë dhe na lehtësoftë punën tonë në rrugën e “pjekurisë njerëzore”

Ejani të rinj! Të kërkojmë vetveten!

Amund të themi se në familjet tona konceptimi i fesë ka qenë një problem? Kam përshtypjen se është diçka më tepër se kaq.

Të gjithë jemi në dijeni të faktit se gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë apo siç jemi mësuar ta shprehim ndryshe këtë "të parët tanë" në një mënyrë apo në tjetrën e kanë jetuar fenë dhe janë përpjekur me të gjitha mundësitë që ta praktikojnë atë. Por që fatkeqësisht ishte periodha e sistemit komunist që i la njerëzit në errësirën e injorancës duke i larguar nga konceptimi dhe mendimi mbi fenë dhe duke i bërë ata që të përkëdhelinin ateizmin, pa e ditur në fakt se ç'po bënin. Dhe është pikërisht brezi i prindërve tanë që mbetën peng e kësaj fatkeqësie aq sa herë herë mendonin se ato lutje apo ato rite fetare që vazhduan t'i bënin tashmë haptazi në periudhën e demokracisë të moshuarit, u përkisnin vetëm atyre (pra të moshuarve). Shumë herë kur të rinjtë pyesin prindërit e tyre për këto rite fetare, prindërit të zhytur në këtë "injorancë", ngaqë nuk dinin t'u kthenin përgjigje, përpiqeshin që t'u shmangeshin në mënyra të ndryshme dhe kjo bëri që brezi i ri asnjëherë të mos merrte përgjigje qoftë edhe të pjesshme për problemet fetare, por që këta prindër nuk e kuptonin këtë që ato vetë po bëheshin shkaktarë që të mbanin peng të injorancës edhe fëmijët e tyre edhe pse jeta evoluon me hapa tepër të shpejtë.

Nga ana tjetër e medaljes kemi një realitet të zymtë ku për vetë kushtet dhe realitetin që jetohet, ka shumë të rinj që kërkojnë të

dinë diçka më shumë nga ato që kanë dëgjuar në lidhje me problemin në fjalë, por që fatkeqësisht pengohen nga prindërit e tyre të cilët vazhdojnë të paragjykojnë mjaft ashpër duke shkuar deri në atë pikë saqë pandehin se të merrësh me një problem të tillë është një "prapambetje".

Unë jam i mendimit se çdo mendje e shëndoshë njerëzore do ta shqyrtonte si tepër të gabuar një reagim të tillë kaq të ashpër.

Së pari, nuk duhet harruar që detyra e prindit nuk është vetëm thjeshtë sigurimi i veshmbathjes apo i ushqimit për fëmijën. Detyrë parësore e tyre është padyshim arsimimi i fëmijëve. Dhe tashmë dihet që ky arsimim fillon pikësepari tek familja, pasi prindi është edhe mësuesi i parë i fëmijës. Asnjëherë s'mund të pajtohem me ato prindër që thonë: "nuk përziem në mësimet e fëmijës". Është detyra juaj prindër që të kujdeseni hap pas hapi me edukimin e fëmijës suaj pasi kjo është një përgjegjësi që keni marrë përsipër dhe është edhe një domosdoshmëri që e kërkon vetë jeta.

Së dyti, jam i mendimit se sot çdo njeri që i thotë vetes se është i pjekur mendërisht, duhet patjetër të informohet për shumë e shumë probleme të kohës. Dhe një nga këto probleme është edhe çështja fetare. Një filozof i shquar thoshte "Ajo që di unë është se nuk di asgjë" Ndërsa vetë Profeti ynë Muhammedi (a.s) thoshte: "**Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr**" duke theksuar kështu edhe domosdoshmërinë e kërkimit të dijes dhe faktin edhe më të rëndësishëm që kërkimi i dijes nuk njihet moshë.

Atëherë mos vallë jemi aq të aftë aq sa nuk kemi nevojë për të mësuar më tepër, për të ditur diçka më shumë nga ajo që dimë, për t'u informuar më shumë për problemet që na shfaq koha dhe që presin përgjigje vetëm prej nesh? A nuk mendojmë se çdo ditë që kalon është një kohë e humbur për ne?

Unë besoj se të gjithë kemi nevojë për më shumë arsim dhe kulturë dhe asnjëherë nuk duhet të mjaftohemi me aq sa kemi, pasi dija është një brilant i çmuar dhe po e lë të ikë, nuk të vjen më në dorë. Dija është një burim uji i pashtershëm ku çdo moment kemi nevojë për të. Asnjëherë nuk është vonë për të ditur diçka më shumë. Prandaj nga këtu del edhe ajo që prindërit e kanë për detyrë të informojnë fëmijët e tyre për problemet e jetës dhe në rastin konkret për çështjen e fesë. Ata vetë nuk duhet t'i pengojnë asnjëherë fëmijët e tyre që të merren apo të mësojnë diçka për fenë e tyre dhe për fetë e tjera. Bile përkundrazi duhet të jenë ato të parët që të mësojnë për fenë në mënyrë që të dinë t'u japin shpjegim edhe problemeve që hasin ato dhe fëmijët e tyre. Ata duhet t'u shmangen paragjykimeve, të mos pajtohen asnjëherë me to, por të kërkojnë gjithmonë të vërtetën në mënyrë që edhe ato vetë të orientohen dhe të udhëzohen në rrugë të drejtë.

Me këtë rast unë i bëj një thirrje së pari të gjithë prindërve që t'u hapin rrugë fëmijëve të tyre që ta kërkojnë dijen dhe së dyti të rinjve:

Ejani të rinj! Të kërkojmë vetveten.

KARAKTERI GJITHPËRFSHIRËS I THIRRJES

Para së gjithash: Mëshirë!
Një besimtar i përkushtuar ndaj thirrjes Islame para së gjithash duhet të kërkojë mëshirën, një ndjenjë kjo që fuqizon bashkimin e gjithë njerëzimit, sepse Islami është një botë e bukur, e bukur në jetën e kësaj dhe të asaj bote. Thirrësi Islam nuk mund ta shohë Islamit si një mundësi prej së cilës do të përfitojë vetëm për vete. Mëshira e Allahut është e pambarim dhe vetë Islami është burimi i kësaj mëshire në të cilën besimtarët do ta shuajnë etjen në keutherin e lumturisë.

Nëse Allahu është zotëruesi i motrave, për të cilën nuk kemi asnjë dyshim dhe jemi plotësisht të bindur, e nëse këtë fe e ka dërguar si dhunti për t'i bashkuar të gjithë njerëzit në "rrugën e Tij", atëherë thirrja Islame duhet t'i drejtohet mbarë njerëzimit. Për këtë arsye thirrësi islam nuk bën dallime në racë, ngjyrë, apo kontinent. Meqë Allahu i Lartë e ka cilësuar fenë e Tij si "dhunti" atëherë besimtari është në përpjekje të vazhdueshme që i gjithë njerëzimi të përfitojë nga kjo "dhunti".

Nuk ka vend për egoizëm

Egoizmi është dëshira për të ngrirë në vetvetë mëshirën dhe "dhuntinë" e Allahut, e kësaj nuk mund të ketë egoizëm në Islam. Ky është mosrespektim ndaj mëshirës së Allahut. Thirrësi mysliman është një njeri i përkushtuar për t'i bërë dritë zemrave dhe fytyrave të atyre që jetojnë në këtë botë të errët. Dhe nëse arrin të ndriçojë qoftë edhe një prej tyre, është njësoj si t'i falësh botën, sepse a nuk është Pejgamberi ai që na mëson se: "Nëse bëhesh shkak që një person



të pranojë Islamit, kjo është më mirë për ty se e gjithë bota dhe çfarë ka në të."

Pejgamberi edhe pse në atë kohë mbeti i vetëm dhe pa përkrahje, a mos bëri vallë dallime kur filloi thirrjen Islame? Të kundërtën e dëshmon pikërisht veçoria e Tij (a.s.) "mëshirë për botët", mëshirë të cilën ia dërgoi njerëzimit me Islamit. I dërguari i Allahut nuk mendoi për asnjë çast t'i dilte kundër besimit të Hindit, e cila pat përtypur mushkëritë e Hamzait të vdekur... Jo vetëm kaq, i dërguari i Allahut e pat konsideruar kërkesën e saj për të pranuar fenë islame si një të drejtë të çdo njeriu për të rrokur Islamit, pa varësisht se akti i saj në të kaluarën e mundonte shumë. Ebu Sufjani, bashkëshorti i Hindit, i cili pat dërguar ushtri kundër myslimanëve në Bedr, i pat munduar shumë ata në Uhud. Pastaj u orvat të pranonte Islamit, dhe i dërguari i Allahut hapi menjëherë krahët mëshirues ndaj tij. Ebu Sufjani nuk u përball me ndonjë sjellje a gjest që e meritonte një komandant i dështuar, por u prit si "vëlla", sepse tanimë ai ishte vëlla në besim, sepse reja e Islamit tashmë qëndronte edhe mbi kokën e tij.

Nuk ka nënvlerësim në thirrjen Islame.

Në thirrjen Islame nuk ka për askënd nënvlerësim. Çdokujt i jepet mundësia për t'u takuar me udhëzimin e Allahut. Të paktën kështu është i detyruar të sillet një thirrës Islam, sepse asnjëri prej nesh nuk mund të dijë kaderin e tjetrit. Thirrësi nisat në rrugë me shpresën për t'u bërë shkak për çdo njeri që të takohet me udhëzimin e Allahut. Ai i lutet Atij që për çdokënd të bartë dritën e Islamit. Edhe sikur të bëhet fjalë për armikun më të pashoq të tij, nuk resht së luturi Allahun për ta udhëzuar atë. Lutet për të mirën e tij, ashtu sikurse edhe i dërguari i Allahut u pat lutur: " Zoti im, forcoje këtë fe me një nga dy Umerët", ashtu sikurse pati thënë përballë padrejtësive dhe zullumeve: " Zoti im, ata nuk dinë. Tregojua rrugën e drejtë"...

Largon çdo pengesë për të gjetur tek çdokush njeriun besimtar

Thirrësi islam kërkon te çdokush njeriun besimtar. Duke mos pasur paragjykime për askënd, kërkon ta takojë çdo njeri me besimin. Për këtë përpiqet që të zhdukë çdo pengesë që mundon njeriun të arrijë tek besimi apo mundohet që ta lehtësojë sadopak rrugën e tij. Ai i cili mban mbi shpatulla detyrën e thirrjes- duhet thënë që çdo besimtar është i ngarkuar me këtë detyrë- para së gjithash thirrjen e fillon me veten e tij e pastaj përpiqet të zhdukë çdo pengesë të udhëzimit.

Nuk duhet të hedh hije ndaj Islamit

Detyra e thirrësit Islam kërkon para së gjithash që vetë ai të jetë shembull si besimtar. Nuk mund t'ia lejojmë vetes që karakteri dhe personaliteti ynë t'u hedhin hije bukurive të Islamit e padyshim që kjo arrihet përmes ndjesisë së përgjegjësive së një besimtari i cili di fare mirë të drejtën e çdo njeriu për t'u bërë mysliman dhe rolin e tij në këtë mes si thirrës mysliman.

Kur i dërguari i Allahut e pat pyetur nënën e besimtarëve, Hz. Hatixhen: "E kush më beson mua?, ajo i qe përgjigjur: " O Muhammed, Zoti nuk do të të turpërojë ty. Ti gjithnjë ke vepruar mirë, i ke trajtuar mirë të varfrit, i ke përkrahur nevojtarët, i ke respektuar mysafirët, i ke ndihmuar hallexhinjtë dhe u je gjendur pranë atyre që kishin probleme". Në këtë mënyrë duket se Hz. Hatixhja sikur skiconte portretin e atyre që do ishin nesër thirrësit Islam.

I dërguari i Allahut i pati mbledhur kurejshët në Meke e u pat thënë: "Sikur t'ju them se pas



I dërguari i Allahut u pat thënë kështu të krishterëve të Nexhranit kur ata i kërkuan të dërgonte një sahabi për t'ua mësuar Islamín:
"Me të vërtetë do t'ju dërgoj një njeri të besueshëm, me të vërtetë të besueshëm, me të vërtetë të besueshëm."

këtij mali gjendet një ushtri armike, a më kishit besuar? Të pranishmit: "Po, të besojmë" i qenë përgjigjur, sepse deri në atë kohë ata s'kishin dëgjuar asgjë tjetër përveçse fjalës së vërtetë e të drejtë nga Muhammedi (a.s.).

I dërguari i Allahut u pat thënë kështu të krishterëve të Nexhranit kur ata i kërkuan të dërgonte një sahabi për t'ua mësuar Islamín: "Me të vërtetë do t'ju dërgoj një njeri të besueshëm, me të vërtetë të besueshëm, me të vërtetë të besueshëm."

Ndërkohë që secili sahabi priste me padurim se kë do të zgjidhte i dërguari i Allahut (a.s.), ai zgjodhi Ebu Ubejde b. Xherrahun. Ishte "besueshmëria" cilësia që i dërguari i Tij (a.s.) kërkonte tek një thirrës, jo vrazhdësia, kapadaillëku, frika, interesi apo koprracia. Këto ishin veçoritë kryesore që la si shembull i dërguari i Allahut e më vonë miqtë e tij më të ngushtë.

Le të vizatojmë në vetvete një portret të Musab b. Umejrit. Buzëqeshja që nuk mungonte asnjëherë në fytyrën e tij sikur thoshte: "Ju solla ju shpëtimin e përhershëm, andaj ju lutem dëgjoni thirrjen time, mos e refuzoni zërin qe ju sjell nga Profeti." Le të vizatojmë portretin e një të

riu i cili mbante shpirtin në dhëmbë për ta zburuar Medinen me dhuntitë e Allahut. A mos vallë kishte gabuar Musabi në rrugën e thirrjes në Medine? Saqë qoftë edhe një njeri i vetëm të largohej nga Islami? Kjo nuk është e mundur! Si mund ta mendojmë këtë gjë për një njeri i cili edhe atyre që niseshin për t'i bërë keq u drejtohej në këtë mënyrë: "A do të mund të më dëgjonit pak? Pastaj mund të bëni çfarë të doni." Ishte kjo përgjigja e njeriut "brumi i të cilit ishte mbrujtur me mëshirë..."

Le të vizatojmë tani portretin e një Ebu Bekri (r.a.), Muadh b. Xhebeli, Xhafer-i Tajjari apo një ehl-i Suffe të tërë, apo secilin mik, shok të Pejgamberit, një yll më vete. Me cilindo prej tyre të bashkohemi, rruga jonë lëshon vetëm dritë...

Të mos i nënshtrohem kushteve, por të dallohem me Islamin tonë

Një çështje tjetër që ka shumë rëndësi në ndikimin pozitiv të një thirrësi Islam në shoqëri është edhe ruajtja e origjinalitetit të thirrësit duke mos iu nënshtuar kushteve ekzistente. Për këtë arsye mund të flasim për një ndarje të prerë mes Asr-i Sadedit, shekullit të lumturisë dhe xhahilijetit, periudhës së injorancës, aq sa sahabët e nderuar ishin shumë të kujdesshëm ndaj çdo depërtimi të mundshëm të adeteve dhe zakoneve të periudhës së injorancës, të jetës së tyre të vjetër me atë të re. Prandaj edhe personaliteti i myslimanëve ishte një element thirrjeje në vetvete, që barti në brendësi çdo bukuri të Islamit. Më pas çdo thirrës Islam nga Mekja apo Medineja u nis në trevat pa Islam për ta përçarur atë me vetë personalitetin e tyre. I dërguari i Allahut pat thënë për Ebu Dherin: "As toka s'ka mbajtur mbi shpinën e saj, e as qielli nuk i ka bërë hije një qenieje më të drejtë sesa Ebu Dheri." Teksa Ebu Dheri, i lavdëruar në këtë masë, kthehej nga Meka për në fshatin e tij, u paraqitet banorëve të saj pikërisht me këtë personalitet të ri, e kështu të gjithë Gifrarët vrapuan për të pranuar Islamin. Kështu fshati i Gifrarëve kaloi në histori si fshati i parë në të cilin Isla-

mi u thirr haptazi. Mendoni pak për dervishët e shumtë të dërguar në mjediset idhujtare apo të krishtera nëpër Ballkan. Ata para së gjithash ishin persona të cilët me vetë mënyrën e jetesës së tyre sollën frymën Islame në një botë ndryshe. Rumelia e stërmadhe ishte pikërisht rrezatimi i atyre dervishëve. Ishte biseda e Islamit me zemrat dhe drita që buronte prej saj.

Myslimani i sotëm

Edhe thirrësi Islam i sotëm, duhet të jetë mjaft i vëmendshëm ndaj çdo përzjerje me të shëmtuarat e shoqërisë ku jeton, duke ruajtur kështu bukuritë e Islamit. Si? Kush e di, ndoshta duke pranuar borxhin e pastër në vend të fajdesë, apo duke zgjedhur vëllazërimin islam dhe sakrificën në vend të individualizmit... Në vend të vrazhdësisë, dashurisë për Allahun, dashuri që buron nga frika ndaj Tij...

Myslimanit i duhet ta jetojë jetën në atë mënyrë që veçoritë origjinale të tij të flasin për veçoritë e Islamit, saqë kombet të cilët jetojnë pa qetësi, të gjejnë "udhëzimin" nga personaliteti Islam, të mos harrojnë së jetuari si njeri, por të gjejnë qetësinë shpirtërore duke parë botën e brendshme të myslimanit dhe personalitetin e tij të palëkundur.

Kushtet e jashtme dhe thirrja

Pengesat e udhëzimit mund të jenë të ndryshme, ideologjike, ekonomike, sociale, kulturore madje edhe ushtarake, por thirrësi Islam duhet t'i kapërcejë edhe këto pengesa. Përderisa qëllimi: "derisa feja të jetë vetëm e Allahut në këtë tokë" i është treguar myslimanit, patjetër që i është treguar edhe rruga për të kapërcyer çdo pengesë. Nëse analizojmë këtë aspekt të xhihudit, do shohim se ai ecën në rrugën e dashurisë njerëzore për t'i ofruar atyre udhëzimin, duke hequr kësaj çdo pengesë të kësaj rruge.

Për këtë arsye është ndaluar forca qoftë edhe për udhëzim. Në këtë kuadër dihet mirë se sa

ishite mërzhitur i dërguari i Allahut kur Usame b. Zejd kishte vlarë një njeri i cila i pat thënë: "U bëra mysliman" por që Zejdi e kishte vlarë me pretekstin se ai "kishte pranuar Islamin nga frika". I dërguari i Allahut i qe drejtuar duke ia përsëritur disa herë këto fjalë Zejdit: "Mos vallë ishte brenda zemrës së tij që e dite këtë gjë?!!!"

Thirrja do t'i hapë rrugë takimit të njeriut me Islamin, por kjo nuk duhet dhe nuk do të arrihet me çfarëdo lloj vlerësimi personal ndaj xhihadit.

Vlera sasiore e thirrjes

Veçoria gjithëpërfshirëse e thirrjes sjell në rend dite edhe çështjen e vlerës sasiore të thirrjes. Thirrja Islame do t'i përçohet çdo njeriu dhe duhet t'i përçohet, por si? Si çdo Pejgamber tjetër edhe i dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s.) e filloi thirrjen me urdhrin "thirr në atë që të zbri-ti Zoti yt" të cilën e vazhdoi deri në frymën e fundit. Në Hutben e Lamtumirës në Meke i pat kërkuar të pranishmëve të dëshmonin tri herë duke thënë "A ua përcolla thirrjen Islame?"

Kur e filloi thirrjen islame i dërguari i Allahut ishte i vetëm. Në një botë të madhe ishte i vetmi që thërriste në rrugën e Allahut. Të gjithë kushtet ishin kundra tij, aq sa kush e shikonte i dukej sikur po përpiquej të gërmonte pusin me gjilpërë, ndërsa në të vërtetë ai (a.s.) kishte filluar të qëndiste gjergjefin në të cilin Hz. Hatixhja ishte lulja e parë. E lulet pasuan lule të tjera. Në thirrjen Islame sakrificat nuk mungoi asnjëherë. Secili prej nesh e di fare mirë dhimbjen që i dërguari i Allahut përjetoi kur disa sahabi prej ehl-i Suffes u vranë pabesisht, apo kur Ammar b. Jasiri dhe Sumejja (r.a.) u torturuan në mënyrë çnjerëzore.

Thirrësit Islam, të gjithë së bashku mbartin dritën e udhëzimit në çdo cep të tokës. Janë përsëri shokët e Profetit (a.s.) që mbartën thirrjen Islame deri në Romë, Egjipt, Siri e Iran. Në çdo cep të gadishullit ata lartësuan thirrjen Islame.

Në periudhën gjysmëshekullore pas ndërrimit

jetë të Profetit (a.s.) shohim një dominim total të thirrjes Islame nëpër botë. Ndoshta akoma ekzistojnë shtete të fuqishme, por nëse flitet për thirrje në besim, nuk do të diskutohej forca e Islamit në këtë aspekt.

Më pas do të vinte koha në të cilën thirrja Islame do fuqizohej edhe në shtetet e tjera. Xhamitë dhe bibliotekat do jenë në krye të thirrjes Islame, dijetarët po ashtu u bënë yjet e kontinenteve të ndryshme, duke u kthyer kështu në thirrës të pashoq në raport me besimet e tjera.

Po tani?

Aq sa është e vërtetë se myslimanët kanë rënë poshtë ekuilibrit të botës aq është e vërtetë se edhe thirrja Islame si në aspektin sasior edhe në atë natyror ka pësuar rënie të ndjeshme.

Vetëm sikur të analizonim dhe krahasonim numrin e librave të publikuar, tirazhin e gazetave dhe revistave, sasinë e fjalëve që kalojnë në agjencitë e lajmeve, do ishin të mjaftueshëm për të sjellë në dukje pengesat me të cilat përballet thirrja Islame. Gjendja në TV apo radio është më e mjerueshme. Nëse shohim vetëm krahasimet mes botës Islame dhe asaj jo Islame do të shohim diferencat e frikshme mes tyre.

Përmendëm që thirrja Islame ka karakter universal. Të vazhdosh thirrjen në kushtet e sotme... Ja kjo është pyetja që qëndron si mal para myslimanëve. Duke filluar nga vetja jonë ka ardhur koha të punojmë për vlerat tona në shërbim të thirrjes Islame.

S'dihet sa mënyra janë përdorur për t'ia dërguar mesazhin Herakaliut, perandorit të Romës.

Po ne, cilat mënyra po përdorim për të arritur te perandorët e sotëm?

Kjo është pyetja që duhet ta trazojë gjumin tonë...

Rreth veseve

Njeriu është i lirë dhe zotëron aftësinë për t'i kapërcyer të gjitha veset. Ai mund t'i mposhtë ato me anë të përpjekjes, inteligjencës dhe lutjes; e gjithashtu nëpërmjet ndjesisë së të bukurës

Ieta në shoqërinë njerëzore favorizon shfaqjen e veseve shoqërore, ndaj të cilëve duhet bërë një qëndresë e fortë. Ngadhënjimi mbi veset arrihet në sajë të njerëzve rreth nesh si dhe falë Zotit, që na vëzhgon e do të na gjykojë.

Para së gjithash është krenaria (apo kryelartësia): të mbivlerësuarit e vetes duke nënvleftësuar ndërkaq të tjerët; përbën refuzimin e pranimit të përlulesisë kur këtë e kërkon natyra e gjërave; për rrjedhojë, nënkupton marrjen si poshtërim të çdo qëndrimi që thjesht shpalos kufizimet tona.

Pastaj është egoizmi: të menduarit për interesin vetjak duke harruar kësisoj atë të të tjerëve. Pikërisht në këtë sektor gjenden egocentrizmi dhe narcisizmi, pa harruar sedrën.

Trashësia: paaftësia e të shquarit ndërmjet thelbësore dhe dytësore e, për pasojë, shëmtia morale e mendjevogëlsisë; është gjithashtu mungesë e ndjesisë së përpjesëtimit, pra e përparësive.

Ligësia: vullneti për ta lënduar tjetrin, në një mënyrë a një tjetër; (e tillë) është sidomos përfolja, shpifja dhe mëria.

Hipokrizia: qëndron në kryerjen e të gjitha veseve, duke praktikuar ndërkohë ushtrime shpirtërore, të cilat në këtë kontekst bëhen sakrilegje.

Duke iu kthyer krenarisë dhe egoizmit: duhet pasur parasysh refleksi i vetëmbrojtjes dhe refleksi i akuzimit të të tjerëve.

Kurse përfolja e sidomos shpifja nënkupton fa-

jet e mëposhtme: së pari, të thënë e tepërt, pra ekzagjerimin dhe falsifikimin e gjërave; së dyti, të thënë e vetëm gjysmës së ngjarjes – çka përsëri nënkupton falsifikimin e asaj që kërkohet të tregohet – ose thënien e gjërave jashtë kontekstit; së treti, projektimi i qëllimeve të rreme tek të tjerët; së katërti, përgjithësimi arbitrar i fakteve të veçanta; së pesti, thjesht shpikja e gjërave inekzistente, që përbën shpifjen në kuptimin e saj të njohur.

Veset të çojnë në ferr. Ne nuk e dimë si mat Zoti; një gabim që mund të na duket i vogël, mund të jetë i madh tek Ai.

Njeriu është i lirë dhe zotëron aftësinë për t'i kapërcyer të gjitha veset. Ai mund t'i mposhtë ato me anë të përpjekjes, inteligjencës dhe lutjes; e gjithashtu nëpërmjet ndjesisë së të bukurës.

PËRGOJIMET DHE SHPIFJET

Përgojimi është një e keqe sepse ai që nuk është i pranishëm s'mund të mbrohet dhe sepse nxjerrja e një fakti të pafavorshëm mund ta lëndojë, gjithashtu sepse për nga vetë natyra e tij njeriu priret ta mbivlerësojë fuqinë e vet të gjykimit. Nga pikëpamja e logjikës së thjeshtë është normale që një njeri të tregojë fakte që e habisin ose e bëjnë të vuajë, ngase në parim ai e gëzon përherë të drejtën që të kërkojë këshillë dhe të vetësigurohet për korrektësinë e ndjenjës së tij; por kjo kushtëzohet nga saktësia e fakteve dhe paanësia e dëshmuesit, si dhe nga dinjiteti moral i bashkëbiseduesit – kjo, veçmas mbrojtjes së të papranishmëve. Mirëpo, në praktikë nuk ekziston mënyrë për të garantuar që këto kushte të

plotësohen krejtësisht gjithmonë, dhe ç'është e vërteta në nëntë nga dhjetë raste nuk do të jetë ashtu. Rrjedhimisht, përderisa merret me kolektivitetin, ligji moral e ka për detyrë ta flipojë përjashtimin për hir të rregullës dhe të vërtetën e veçantë për dobinë e përgjithshme.

Sa për shpifjen, ajo qëndron në përhapjen poshtë e lart të fakteve të pasakta dhe të pafavorshme, dhe në të interpretuarit e gjërave të pafavorshme që i nënshtrohen një kuptimi të favorshëm, duke mos bërë dallimin midis asaj që është e sigurt, e besueshme, e mundur, e dyshimtë, e pabesueshme dhe e pamundur. Shpifja nuk është çështje gabimesh aksidentale, por pasioni sistematik.

DYSHIMI

Prirja për dyshim nuk është mënyrë më normale inteligjence¹ sesa mashtrimi. Nëse dyshimi është i ligjshëm kur shfaqet rastësisht – dhe si përjashtim – nga një përshtypje e drejtë, ai është i paligjshëm me t'u bërë prirje apo njëfarë parimi, sepse atëherë sjell një sëmundje shpirti të papëruptshme me virtytin dhe përshtypshmërinë.

Dyshimi nuk ushqehet vetëm nga iluzione subjektive: ai jeton edhe në kurriz të përshtypjeve objektive, të cilat janë po aq iluzore, edhe pse të rrënjëzuara në fakte. Në të vërtetë, dyshimi, i cili në thelb shpërfill ligjet e koincencës dhe paradoksit, shpesh e gjen veten të mbështetur nga dukje që mjedisi i krijon krejt pa shkak, çka nuk hyn te aspektet më të pakta të iluzionit kozmik; këto mundësi – akumulime koincencash, dukjesh sipërfaqësore të kundërta me një realitet që fshehin – janë zbatime të domosdoshme të parimit të kundërshtisë, që përfshihet në mundësinë universale. Nganjëherë paradoksi është i qëllimtë nga ana e njeriut, siç tregon shembulli klasik i Omer Hajamit, urtia e të cilit e veshur në mendjelehtësi i kundërvihet farisejizmit të veshur në devotshmëri; nëse hipokrizia fetare është e mundur, paradoksi i kundërt duhet të jetë po aq i tillë.

1. Një hadith pohon: "Largojuni dyshimit, sepse dyshimi është gjëja më mashtruese që shpirti mund të mbartë si ngacmues për njeriun!" Një tjetër thotë: "Mos hetoni e mos spiunoni!" Mentaliteti policor në fakt lidhet ngushtë me një dyshim e moralizim gërryes, dhe me një mani të caktuar persekutimi.

VERBËRIA MORALE

Nëse "Bukuria është shkëlqimi i të Vërtetët", atëherë mund të thuhet se moralizmi qëndron në shkëputjen e bukurisë nga e vërteta. Pa të vërtetën, bukuria nuk mund të qëndrojë, çka shpjegon shëmtinë që i përngjitet moralizmit. Ai e zëvendëson njohjen e të vërtetës me idhujtarinë e një "të mire" shpesh arbitrare dhe të kufizuar.

Në vetë natyrën e gjërave, moralizimi është injorant si për të vërtetën, ashtu edhe për bukurinë: ai nuk e shmang dot të qenit hipokrit në lidhje me të parën dhe karikaturesk me të dytën.

Ndër kriteret më të spikatura të moralizimit është përgojimi i objektit në funksion të korrupsionit të shpeshmërisë së subjektit.

Gabimi i anasjelltë – ai i intelektualizmit – qëndron në shkëputjen e të vërtetës nga bukuria – jo për se, çka i mjafton në vetvete, por të vërtetës së pasqyruar brenda nesh e të përcjellë prej nesh. Çështja e bukurisë nuk ngrihet për të bukurën e kulluar, por për marrësin njerëzor, për substancën që ajo u jep shkëndijave ndriçuese të shpirtit.

Relativiteti i konceptimeve morale dhe i lidhjes së ideve përkatëse shfaqet në mënyrë mbresëlënëse tek përgjithësimet e rreme të moralizimit



të veshjes, që ka asgjësuar shumë fise; njerëzit merakosen për “moralin” – me ose pa motive të mëtejshme komerciale – dhe janë të paafte të vërejnë karakterin imoral të atij lloji të degradimit universal që është përhapur me forma të caktuara të veshjes.

TRASHËSIA, DOBËSIA DHE LIGËSIA

Injoranca që përbën kushtin themelor të shkeljes është e një rendi krejt tjetër nga mosdija e thjeshtë teorike: ajo është padituri efektive, që e ka rrënjën te zemra e jo tek arsyeja apo kujtesa; dhe pikërisht kjo injorancë është ajo që shkrimet monoteiste e quajnë, me saktësi të madhe, “ngurtësim zemre.” Injoranca shpaloset në tri mënyra kryesore: trashësi, dobësi dhe ligësi, të cilat janë privime nga Urtia Hyjnore, Fuqia Hyjnore dhe Mëshira (ose Bukuria) Hyjnore, që kanë si cilësi përkatëse njerëzore inteligjencën, forcën dhe mirësinë. Trashësia është paafësia për të shquar thelbësoren nga aksidentalja: ajo qëndron në të kapurit pas fakteve të thjeshta dhe të konsideruarit e tyre thjesht në vetvete, pra pa kurrfarë induksioni; dobësia është braktisja e iluzioneve dhe mungesa e depërtimit intelektual ndaj dukjeve, e kësaj mungese homogjeniteti të brendshëm e për pasojë edhe qëndrese; së fundmi, ligësia, që është ku e ku më i rëndi “jokonformitet” – sepse është haptazi “aktiv” dhe “i ndërgegjshëm” – përbën një abstraksion i cili është i anasjelli i atij që vjen nga inteligjenca: ndërkohë që inteligjenca lejon shikimin e marrëdhënieve të

brendshme të gjërave, ligësia përfaqëson një prirje qartësisht kufizuese, mohuese e shkatërruese. Para se të kryejë një shkelje, njeriu mashtron veten; për të rrëzuar përkohësisht gjykimin e tij, ai zhvillon argumente që, në varësi të rastit apo individit, karakterizohen ose nga trashësia, ose nga dobësia, ose nga ligësia: i trashi e shpërbën aftësinë e tij shquese në njëfarë topitjeje; i dobëti e braktis karshi iluzionit; i ligu e thyen atë me dhunë. Mund të thuhej më tej se shkelja përmes trashësisë është veprim – ose heqje – e privuar nga arsyeja e mjaftueshme; dhe përderisa është reagim, i përgjigjet thjesht një fakti. Shkelja përmes dobësisë karakterizohet me një arsye të mjaftueshme iluzore; ajo nisat në thelb nga reagimi ndaj një dukjeje. Së fundmi, shkelja me anë të ligësisë ka si arsye të mjaftueshme pikërisht prirjen e ulët të mohimit, me fjalë të tjera, urrejtjen e asaj që duket si afirmim i Normës Hyjnore.

KRENARIA

Kryelartësia qëndron në marrjen e vetes për çka nuk jemi dhe nënçmimin e të tjerëve. Vetrespekti nënkupton njohjen e asaj që jemi dhe moslejimin e poshtërimin tonë. Vetrespekti nuk na pengon të nënshtrohemi para asaj që na tejkalon; ai është larg nga të qenit i kundërti i përvulësisë së vërtetë, çfarëdo që të thonë moralistët sipërfaqësorë.

Sipas Betiusit, “të gjitha veset e tjera i largohen Zotit; vetëm krenaria i ngrihet kundër.”

ÇRREGULLIMI I PËRPPJESËTIMIT GJINOR sipas hadithit dhe shkencës

Allahu i madhërishëm ka bërë që përpjesëtimi në mes fëmijëve meshkuj dhe femra gjatë lindjes (i ashtuquajtur "sex ratio") të jetë 1:1, që d.m.th. përafërsisht lind numër i njëjtë i fëmijëve meshkuj dhe femra. Çrregullimi në baraspeshën e këtij përpjesëtimi ngjan "duke falënderuar" ndikimin e njeriut në proceset natyrore.

Femrat që kanë qenë të ekspozuara ndaj kushteve ekstreme në shumicën e rasteve lindin fëmijë femra. Në qytetin italian Seves në vitin 1976 ndodhi një eksplozim i fuqishëm në fabrikën kimike. Në këtë rast u liruan sasi të mëdha të gazrave helmues. Në studimin e bërë prej prillit në vitet 1976 deri në dhjetor 1984, është konstatuar se përpjesëtimi gjinor nga 106 fëmijë meshkuj, ndaj 100 fëmijë femra, është ndryshuar kah koeficienti prej 26 fëmijë meshkuj ndaj 48 fëmijë femra.

Shënimet ndërkombëtare janë brengosës. Në hulumtimin të cilin e bëri Mocarelli në vitin 2000 theksohet se në dhjetëvjeçarin e parë të avarisë në Seves nuk ka lindur asnjë fëmijë mashkull. Të gjithë të porsalindurit ishin femra! Çrregullimi i përpjesëtimin të porsalindurve ndërkohë vërehet gati në të gjitha vendet e industrializuara. Kështu në SHBA që nga viti 1970 deri më sot kanë lindur 137.000 më pak fëmijë meshkuj. Ndërsa në Japoni ky numër është 127.000.

Shënimet e fundit të cilat janë alarmuese nga shkencëtarët kanë të bëjnë me gjendjen në Groenlandë. Atje marrëdhënia gjinore ndërkohë është 1 : 2 (në afërsi të qytetit Kanak) ku prej 16 të porsalindurve, asnjë nuk ka qenë mashkull.

"Në Groenlandë në një fëmijë mashkull lindin dy fëmijë femra", thotë Akaluk Lyngø, kryetar i mëparshëm i konferencës Inuite polare. Substancat helmuese që mblidhen në polet e Tokës, e nëpërmes kafshëve të detit, arrijnë në organizmin e njeriut. Në fund të këtij zinxhiri të ushqimit është Eskimezi – si depo e helmeve nga atmosfera e Tokës.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ÇRREGULLIMIN E TË PORSALINDURVE

Embrioni mashkullor është më pak rezistues, më i ndjeshëm në sëmundje dhe gjatë stresit tej mase vdesin në mitrat e nënave.

"Dihet se gratë që punojnë me substanca kimike, pesticide dhe metale, lindin më pak fëmijë meshkuj. Gjithashtu dimë se ushqimi artificial dhe gjendja e keqe shëndetësore ndikojnë negativisht në gjini.", thotë Devra Lee Davis nga Universiteti i Pittsburgut e cila është eksperte në këtë fushë.

Shkas për çrregullimet e marrëdhënive gjinore padyshim është kombinimi i ndikimit të mjedisit, stresit dhe prindërve të moshuar. Dhe që stresi është njëri prej faktorëve, e ka zbuluar Ralph Catalano nga Universiteti Berkeley në Kaliforni. Duke krahasuar numrin e fëmijëve meshkuj të lindur më 1991 në Gjermani, vërejtë se numri i tyre në atë vit kishte rënë në mënyrë drastike, pasi që një vit më parë u shkatërrua republika demokratike e Gjermanisë, që ka shkaktuar situatë stresgjene te nënat.

Stresi, ndotja e mjedisit, ushqimi i çrregulluar – të gjithë këto janë faktorë që ndikojnë në çrregullimin e marrëdhënies të porsalindurve meshkuj dhe femra. Për këtë na ka informuar Muhamedi (a.s.) në hadithin që e transmeton Enesi r.a. (këtë e shënon edhe Buha-riu, Muslimi dhe Tirmidhiu), ku thotë:

"Prej parashenjave të ditës së Gjykimit është që do të ketë shumë femra, e pak meshkuj, kështu që në pesëdhjetë femra do të jetë një mashkull."

Kuptimi ynë i postulatit nga burimet primare të islamit varet nga shkalla e civilizimit kohor që na rrethon. Komentuesi më i njohur i hadithit i përmbledhur në librin e Buhariut, Ibn Haxher El-Askalani, hadithin e përmendur e shpjegon në këtë mënyrë: Nga fundi i kohës do të ketë aq shumë lufta, ku do të vdesin meshkujt duke lërrë femrat. Por, hadithi mund të shpjegohet dhe vërtetohet në këtë mënyrë: njeriu do ta ndotë mjedisin deri në atë masë, me ç'rast fetusi mashkull do të vdes në mitrën e nënës. Këtë deri me sot askush nuk ka mundur e as të ëndërrojë. Por, të vërtetat në Kur'an dhe hadithi mbesin të qëndrueshme deri në ditën e Gjykimit.

Ndryshohet, pra, vetëm mënyra e të kuptuarit tonë.

KRIZA E KOMUNITETIT MYSLIMAN

Në ditët e sotme bashkësia islame fatkeqësisht ndodhet vërtetë në një rang të mjerueshëm. Ka shijuar një rënie të dhimbshme si asnjë bashkësi tjetër fetare. Myslimanët u dorëzuan, u ndanë në grupe... iu morën tokat, iu grabitën shpresat. U mashtruan, u kolonizuan... u shfrytëzuan... u dhunuan nga misionarët duke i detyruar të pranonin me çdo kusht fe të tjera.

Me një propagandë keqdashëse u shtynë nga armiqtë drejt të ashtuquajturës moderne duke i larguar ata nga drita e Islamit.

Është i papërbalueshëm keqinterpretimi, poshtërimi dhe mposhtja e myslimanëve duke pasur parasysh vërtetësinë, përhapjen, dobinë dhe karakterin universal të Islamit...përhapjen e myslimanëve në vende të gjera e të begata... zotërimi i potencialeve gjeopolitike dhe materiale si dhe popullsinë e tyre e cila ka kaluar 1 miliard.

Burimi dhe shkaku kryesor i krizës së bashkësisë islame padyshim që është sistemi arsimor... i cili përgatiti edhe prapaskenën e kësaj sëmundjeje. Në këtë drejtim prioriteti që iu dha lirisë pa kufi... duke imituar sistemin arsimor të perëndimit, shkaktoi rrënjosjen e sistemit të ideuar dhe projektuar nga imperialistët. Modernizimi shkaktoi largimin e mësuesve dhe nxënësve nga Islami...kjo frymë fatkeqësisht po përhapet gjithnjë e më tepër në universitete e shkolla

pas universitare. Ndërsa sot nuk është duke u ndërmarrë asnjë iniciativë për të ndaluar këtë padrejtësi dhe pabesi që po i bëhet bashkësisë myslimane. Kjo gjendje është më e mjerueshme sesa vetë kolonizimi.

Shpirti i qëndresës...dashuria për pavarësi...dëshira për të gjetur një zgjidhje të drejtë mundon çdo mysliman.

Në ditët e sotme metodat që përdoren në botën islame nuk janë gjë tjetër veçse një kopje e atyre të perëndimit. Këto metoda pa "shpirt" si pa e kuptuar po kryejnë detyrën, edhe të ecjes përpara edhe të modernizimit...ndërsa nga ana tjetër në mënyrë të pabesë janë duke ndikuar në largimin e të rinjve nga fryma e mësimeve islame.

Me shpatë përballë tankeve!

Nxënësit e universiteteve në botën islame përballë ideologjive të huaja që po u imponohen, i përngajnë ushtarit që lufton me shpatë kundrejt tankeve dhe armëve të motorizuara.

Bota islame në asnjë vend nuk ngul këmbë në idetë themelore të saj duke u krahasuar me ideologjinë perëndimore e cila ka depërtuar thellë në damarët e të rinjve.

Zgjidhja e problemeve në sistemin arsimor përbën detyrën kryesore dhe më imediate që duhet të përmbushë bashkësia islame. Nëse nuk realizohet kjo atëherë është e kotë të ëndërrojmë për një shoqëri islame të bashkuar. Duhet filluar nga dhënia fund sistemit të dyfish-

të të arsimimit, pikërisht atij islam dhe perëndimor. Këto dy metoda duhen gërshetuar, por me kusht që të triumfojë metoda islame ... e pastër nga ideologjitë e huaja. Bashkësisë islame i duhet të tërheq drejt vetes të gjithë ata që Allahu i Madhëruar i ka veçuar duke i konsideruar "njerëz të dijes" dhe shuma të mëdha duhen shpenzuar vetëm për arsimin.

Në këtë kontekst çdo mysliman i ri duhet të ketë njohuri të mjaftueshme mbi fenë, moralin, drejtësinë dhe historinë islame. Përderisa pri-jësit e bashkësisë islame nuk do arrijnë t'u mësojnë të rinjve temat bazë të islamit do shijojnë edhe humbjen edhe ndëshkimin e Allahut.

Nuk duhet të mbesë asnjë i ri pa u përballur me kulturën islame... pa u bashkuar me bashkësinë islame.

Pikërisht kjo do të jetë arma më e fortë kundrejt ideologjive të huaja duke i dhënë mundësinë e një kryengritjeje të fuqishme ndaj perëndimit, sepse nga kultura islame do të kuptojnë thelbin e qytetërimit islam, logjikën islame...rrugën në të cilën duhet të shkelë këmba e çdo myslimani. Kështu ai do të jetë krenar për bashkësinë e tij duke e veçuar, mbrojtur dhe duke kërkuar që edhe të tjerët të bashkohen me ta.

Tashmë myslimanëve nuk u ka mbetur gjë tjetër... ose të përqafojnë forcën e ripërtëritjes ... ose të rrënjosen në faqet e historisë përbri thënies "na ishte një herë...!".

Çdo fjalë një konkurrencë...

Fjalitë e formuara me fjalët që përdorin njerëzit për t'u kuptuar me njëri-tjetrin, ose çdo fjalë e cila del nga goja jonë, e hidhur, e ëmbël, transparente, e fshehtë, e mërzitur, e lumtur, me shpresë, e zyrtë, e ndjeshme ose fjalë pa vlerë, na tregojnë ne dhe shoqërisë që na rrethon, veten dhe karakterin tonë.

Allahu (xh.sh.) në Kur'anin famëlartë thotë: "E ti robërve të Mi thuaju: Le ta thonë atë që është më e mira, sepse djalli ndërson mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut." (Isra:53)

Ndonjëherë në kuptimet e fjalëve që përdorim hasim vështirësi, dhe kur duam t'i tregojmë dikujt diçka apo të krijojmë lidhje me të, vëmë re se ose ne kemi zgjedhur fjalët e gabuara, ose personi përballë nesh e ka perceptuar gabim.

Mospërcjellja e mendimeve tona në mënyrë të plotë, ka të bëjë drejtpërdrejt me përtacinë tonë kundrejt leximit dhe studimit, si dhe nga fjalori i varfër që ne posedojmë.

Edhe fjalët që ne përdorim për të ndrequr gabimet tona janë tepër të rëndësishme. Personat të cilëve nuk ju pëlqen të marrin këshilla nga të tjerët, por ndjejnë kënaqësi vetëm kur veprojnë sipas mendimeve të veta, do të ishte shumë më e dobishme dhe njerëzore t'u bëhej thirrje në formë lutjeje dhe jo urdhri apo detyrimi.

Pothuajse të gjithë e kuptojnë domethënien e një fjale të urtë:

"Fjala të bën me thesare, fjala të bën ndër të vrarë".

Duke ju mbështetur domethënies së kësaj fjale të urtë, na tre-

gohet se zgjuarsia e njeriut është e fshehur në fjalë, dhe se pasqyrimi i një zgjuarsie të mprehtë tek fjalët, bën të mundur shpëtimin dhe ndryshimin e një jete!

Persona të cilët kanë aftësi pasqyrimi të zgjuarsisë së tyre në fjalë dhe arrijnë të shprehin dijen dhe suksesin e tyre, ndonjëherë vetëm heshtja e tyre është e mjaftueshme!

Kur qëndrojmë me këta njerëz të zgjuar e të urtë, me mënyrat e tyre tepër ndikuese dhe depërtuese në zemra, koha kalon pa u kuptuar.

Me të vërtetë, ai që qëndron pranë këtyre poseduesve të diturive dhe urtësive, gjen një qetësi shpirtërore, nuk e ndjen veten inferior dhe nuk është aspak i detyruar t'i përzgjedhë fjalët sikur përzgjedh gurët e vegjël nga kokrrat e orizit.

Sa kënaqësi të madhe gëzojnë këta njerëz!?

Edhe në Kur'anin famëlartë përmenden në këtë mënyrë: "Ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij, ata janë të sinqertët dhe shehidët tek Zoti i tyre, ata kanë shpërblimin dhe dritën e vet". (Hadid, 19)

Përveç këtyre, dhe fjalët e personave të mbushur me ndjenja dhe me shpirt poetik, janë tepër domethënëse dhe të zgjedhura.

Mospërcjellja e mendimeve tona në mënyrë të plotë, ka të bëjë drejtpërdrejt me përtacinë tonë kundrejt leximit dhe studimit, si dhe nga fjalori i varfër që ne posedojmë

Njerëz të cilët e realizojnë fort mirë shprehinë me pak fjalë për ndjenjat dhe mendimet që posedojnë, depërtojnë tek njerëzit në mënyra magjepsë, ndonjëherë me sy të përlotur që ngajnë si një re qaramane, ndonjëherë me shpirt të mbushur plot hare si një bilbil!

Faktikisht, për fjalët që ne nxjerrim nga goja jonë mund të qëndrojmë e të bëjmë komente të shumta.

Këto rreshta që unë u mundova të shkruaj, nuk janë gjë tjetër veçse një pjesë e vogël e një rruge të gjatë e të vështirë.

Në këtë rrugë është dhe një qoshe në të cilën gjenden, gojë që gënjejnë, bëjnë thashetheme, shprehin plot armiqësi si dhe fjalë të rënda e të shëmtuara.

Të gjitha këto nga gojë të cilat Allahu i lartmadhëruar i ka krijuar në mënyrë të përsosur dhe prej tyre nuk meritojnë tjetër veçse të dalin fjalë të bukura e të dobishme.

Atëherë, duke i pasur të gjitha këto mundësi, dhe të zgjedhësh qëndrimin në këtë qoshe të fëlliqur, është njësoj sikur të pranosh qëndrimin në cepin e një humnere ku nga çasti në çast mund të biesh.

Allahu i lartmadhëruar përsëri këtyre njerëzve u drejtohet: "Urrej-tja kundër jush duket nga gojë e tyre, por ajo që fshehin në kraharorët e tyre është më e madhe." (Ali Imran, 118)

E lusim Allahun (xh.sh.) të na ruaj të mos bëhemi si këta njerëz si dhe nga bisedat me to.

Allahu na bëftë prej atyre që janë të drejtë, me fjalë dhe me shpirt të pastër!

Profeti i dashurisë

Dashuria, tek qenia njerëzore shpreh kulmin e përsosmërisë, kurse në fe shpreh madhështinë kulminante

Dashuria është ajo ndjenjë universale dhe e pakrahueshme, të cilës njerëzimi në çdo kohë dhe në çdo vend ia ka ndjerë nevojën dhe mallëngjimimin dhe me të cilën ai ka mundur të kapërcëjë çdo vështirësi dhe pengesë që ka hasur gjatë jetës.

Dashuria, tek qenia njerëzore shpreh kulmin e përsosmërisë, kurse në fe shpreh madhështinë kulminante. Muhamedi (a.s.) është shembulli më i bukur në përsosmëri dhe më absoluti në fe. Është e pamundur që majat e përsosmërisë të mund të arrihen nga të gjithë. Ata që nuk mund të arrijnë këtë gradë përsosmërie, kanë mundësinë të ushqehen me virtytet e tyre nëpërmjet burimeve që rrjedhin pa shterim. Në sajë të tyre ata arrijnë të gjithë të shijojnë kënaqësinë, gëzimin, lumturinë dhe dashurinë që fal jeta.

Feja islame i ka ofruar njerëzimit vetëm më të përsosurën, sepse ajo është feja e fundit. Për këtë arsye Kur'ani është libri më i përsosur, profeti Muhamedi (a.s.) është profeti më i përsosur, sistemi islam është sistemi më i përsosur. Përsosmëria e një sistemi shprehet me forcën

dhe aftësinë për t'i thënë ndal të keqes, për t'u dhënë zgjidhje problemeve të njerëzve qofshin këto edhe prej çështjeve më elementare, që kanë lidhje me botën e njeriut, dhe jo vetëm kaq por që kanë lidhje edhe me gjithësinë në çdo kohë dhe çdo vend.

Ja pra feja islame i ofron njerëzimit këtë sistem të përsosur dhe universal që nuk ia ofron dot asnjë sistem apo fe tjetër që ekziston mbi sipërfaqen e tokës.

FEJA DHE DASHURIA

Në gjuhën arabe përdoren rreth 60 fjalë që shprehin dashurinë. Shumica e këtyre kalojnë në Kur'an dhe traditën profetike. Feja islame jo vetëm qenien e gjallë, por edhe krijimin e gjithësisë e ka lidhur fort me dashurinë

dhe e vlerëson atë si një pasojë e dashurisë universale. Në themelin e të gjithë llojeve të adhurimeve dhe veprave, gjithmonë qëndron dashuria. Feja islame edhe burimin e frikës e ka lidhur ngushtë me dashurinë. Besimtari druhet nga sjelljet që nuk e kënaqin dhe që bëhen shkak për të humbur dashurinë e Allahu (xh.sh.). Sepse qëllimi kryesor i një besimtari është të bëhet një rob që e do Allahu dhe që e do Allahun. Për këtë arsye duhet të largohet nga çdo gjë që pengon dashurinë. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të respektohen urdhëresat dhe ndalesat në fe.

Mosrespektimi i tyre çon në humbjen e dashurisë aq të dashur dhe aq të kërkuar nga çdo njeri prej nesh.

Në shumë ajete të Kur'anit flitet për individët që i do Allahu dhe që ata e duan Allahun, që janë modestë dhe të butë ndaj besimtarëve, por të ashpër, krenar dhe të fortë ndaj mohuesve, që luftojnë në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohen kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo është dhuratë e Allahut që ia jep atij që do. Allahu është dhurues i madh, i dijsëm. (Maide,5/54)

Ndërmjet atyre që do Alla-



hu hyjnë ata që bëjnë vepra të mira, të penduarit, ata që ndjehen thellë në zemër dashurinë për Allahun dhe durimtarët.

Që të arrish të bëhesh pjesëtar qoftë edhe i njerit prej këtyre grupeve do të ishte një sukses i madh për çdo njeri, por pa dyshim që në të tilla grada nuk mund të arrijnë të gjithë por vetëm ata që janë pajisur me forcën e besimit, ata që u janë ndriçuar zemrat me dritën e besimit. Për të fituar dhe për t'u bërë një njeri i dashur tek Allahu, duhen kapërcyer shumë pengesa dhe sakrifikuar në këtë jetë.

Besimi është shkalla e parë drejt dashurisë së përsosur, sepse besimi është themeli kryesor që e shpëton njeriun nga të cilësuarit shok Allahut. T'i atribuosh Allahut shok në dashuri, është burim i të gjithë llojeve të tjera të shirkut. Çdo dashuri që ekziston dhe që është e lejuar në islam e ka burimin nga kjo dashuri universale. Dashuria për profetin, dashuria për prindërit, dashuria për fëmijët nuk duhet ta kalojë asnjëherë dashurinë për Allahun

MUHAMEDI (A.S.) DHE DASHURIA

Nëse do donim ta përkufizojmë Muhamedin (a.s.) me dy fjalë, do të mjaftonte togfjalëshi "profeti i dashurisë". Shkalla më e lartë e dashurisë është të adhurosh Allahun ashtu siç i ka hije madhështisë së tij.

Siç e përmendëm edhe më sipër Muhamedi (a.s.) në adhurim ka qenë shembulli më i përsosur, adhurimi është shkalla më e lartë dhe më e vyer që shpreh më së miri dashurinë, përkushtimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut. Adhurimi i takon vetëm Allahut dhe askujt tjetër. Për këtë arsye në suren Ftiha urdhërohet "vetëm dhe vetëm Ty të adhurojmë, o Zot", ndërsa Allahu fal çdo mëkat tjetër përveç të bërit shok në

adhurim, mëkat që Ai nuk e fal (Nisa,4/48)

Kurani na informon në shumë ajete se Muhamedi (a.s.) gjendet në shkallët më të larta të adhurimit të Allahut dhe se është robi më i dashur dhe më i nderuari tek Allahu. Ja disa nga ajetet që e cilësojnë dhe e përshkruajnë Muhamedin (a.s.) si një rob të përkushtuar dhe i dashur i Allahut:

"E nëqoftëse jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kapitull të ngjashëm si ai (Kur'ani)" (Bakara, 2/23)

"Pa të meta është Lartmadhëria

**Bindja ndaj
Muhamedit (a.s.)
është bindje ndaj
Allahut, besa e dhënë
atij është besë e
dhënë ndaj Allahut,
dashuria dhe mëshira
Allahut fitohet duke ju
bindur atij dhe traditës
së tij profetike**

e Tij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar" (Isra, 17/1)

"Kur u ngrit robi i Allahut ta adhurojë Atë, ata (xhinët) gati hipnin njëri mbi tjetrin për të dëgjuar" (Xhin, 72/19)

Të gjitha këto ajete nxjerrin në pah pozitën e lartë të Muhamedit në këtë botë edhe në botën tjetër.

Sipas një transmetimi të saktë në ditën e gjykimit, grupe të mëdha njerëzish do të gjezdisin të

gjithë profetët duke kërkuar prej tyre ndërmjetësim tek Allahu dhe kur të arrijnë tek Isai (a.s.) ai do t'i këshillojë duke u thënë: Shkoni tek Muhamedi (a.s.) robi i Allahut që i janë falur të gjitha gabimet. Përmendja e Muhamedit si rob i Zotit nga ana e Isait është shumë e rëndësishme, sepse sa e vështirë është të jesh rob i Allahut në kuptimin e plotë të fjalës e theksuam edhe më sipër.

Pëlqimi dhe nxitja që ka bërë Muhamedi (a.s.) për vendosjen e emrave si Abdullah dhe Aburrahman tregon për rëndësinë e të qenit rob i Allahut.

Të jesh mik i Allahut është një pozitë me e lartë se sa të jesh rob i Tij. Kësaj pozite vetëm dy profetë ia kanë arritur. Ata janë Ibrahim dhe Muhamedi (a.s.)

PREZANTIMI I MUHAMEDIT NË KUR'AN

Kur'ani ndërsa prezanton dhe jep informacion për cilësitë dhe veçoritë e Muhamedit (a.s.) përdor fjalë të zgjedhura, të mbushura plot me dashuri dhe mëshirë që lënë gjurmë në zemrën e njerëzve. Do të ishte me vend dhe e mjaftueshme sikur të jepnim ca shembuj nga vetë Kur'ani.

1. "Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat" (21/107)

Fjala mëshirë e rehaton atë që e dëgjon, i qetëson zemrën dhe i jep siguri. Ajo që të vjen menjëherë ndër mend nga kjo fjalë është urtësia, mirësjellja, dashamirësia, dhembshuria, mirësia dhe dashuria. Cilësimi i Muhamedit me këtë fjalë nuk përfshin vetëm besimtarët por edhe jobesimtarët. Kështu që Muhamedi është një i dërguar për mëshirë.

2. "Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe qortues" (Sebe, 34/28) Që peygamberi është

një myzhdedhënës kalon në shumë ajete. Imazhi dhe përshtypja që krijon fjala myzhdedhënës në mendjen e njeriut është e mbushur me plot kuptime që kënaqin zemrën dhe e mbushin shpirtin plot me gëzim. Në shumë ajete të tjera krahas këtyre veçorive mbresëlënëse përmendet që ai është dëshmues dhe dritë që ndriçon rrugën drejt lumturisë së përhershme. Të gjitha këto cilësi të Tij që i përmend Kur'ani janë jashtëzakonisht mbresëlënëse dhe ndikuese në zemrat e njerëzve.

3. "Thuaj (Muhamed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju" (Araf, 7/158)

Përmendja në këtë ajet si i dërguar për gjithë njerëzimin është një veçori vetëm e Muhamedit (a.s.), sepse profetët e tjerë kanë qenë të dërguar me mision vetëm për popullin e tyre. Pra Muhamedi (a.s.) mbart një mesazh universal që i drejtohet gjithë njerëzimit dhe ky mesazh natyrisht që është Kur'ani. Ngaqë Muhamedi (a.s.) mbartë gjithë këto cilësi e veçori, Allahu e ka vendosur dashurinë për Të si kriter për t'u bërë rob të dashur tek Allahu. "Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë mëkatet" (Ali-Imran, 3/31)

Krahas kësaj është vendosur edhe parimi i famshëm në Kuran: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun".

Këto janë vetëm disa cilësi të Profetit të dashurisë. Në të vërtetë Muhamedit (a.s.) i janë dhuruar të gjitha virtytet. Të flasësh për këtë nuk mjafton një libër, jo më një artikull.

MUHAMEDI (A.S.) NGA KËNDVËSHTRIMI I KUR'ANIT

Prezantimi dhe përshkrimi më i mirë dhe i plotë i Muhamedit bëhet nga Kur'ani prandaj pa e zgatur shumë ta shikojmë Muhamedin (a.s.) nga drita e Kur'anit.

Allahu ka marrë besën e të gjithë profetëve që ta ndjekin dhe ta ndihmojnë Muhamedin (a.s.) që në botën e shpirtave.

"Përkujtoni (o ithtarë të librit) kur All-llahu mori zotimin e peygamberëve nga ajo se juve ju dhashë libër e urtësi, dhe do vijë një i dërguar që vërteton atë që ju keni pranë. Atë do ta besoni dhe

Dashuria është ajo ndjenjë universale dhe e pakrahasueshme, të cilës njerëzimi në çdo kohë dhe në çdo vend ia ka ndjerë nevojën dhe mallëngjimin dhe me të cilën ai ka mundur të kapërcejë çdo vështirësi dhe pengesë që ka hasur gjatë jetës

ndihmoni. Tha (All-llahu): "A pranuat, a e morët sipër obligimin Tim? "Ata thanë: "Ne e pranuan!" Tha (All-llahu): "Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju!" (Ali-Imran, 81)

Librat hyjnorë para Kuranit kanë informuar njerëzit për veçoritë e këtij profeti që do të vijë.

"Atyre që u kemi dhënë librin, ata e njohin atë (Muhamedin) siç i njohin bijtë e vet, dhe një grup pre tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke e fshehur të vërtetën" (Bakara, 146)

Allahu e ka krijuar Muhamedin (a.s.) të parin e myslimanëve dhe vulën e gjithë profetëve. Ai është

i dërguar për gjithë njerëzimin pa përjashtim. "Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes" (Sebe, 28)

Krahas kësaj Allahu e ka bërë Muhamedin (a.s.) shkak për të mos u goditur nga fatkeqësitë dhe rreziqet, e ka bërë atë burim sigurie dhe qetësie.

Allahu është betuar në vendin ku profeti ynë ka jetuar. Allahu ka ndaluar të thirret thjeshtë në emër dhe na ka mësuar që të jemi kundrejt personalitetit të profetit Tij të sjellshëm, me edukatë, ndërsa sahabet i pat urdhëruar të mos e ngrënë zërin tepër përpara tij. Allahu ka shpallur në Kur'an se: Bindja ndaj tij është bindje ndaj Allahut, besa e dhënë atij është besë e dhënë ndaj Allahut, dashuria dhe mëshira Allahut fitohet duke ju bindur atij dhe traditës së tij profetike. Allahu na ka urdhëruar t'i dërgojmë selam, sepse Atij i dërgon vazhdimisht selam Allahu dhe engjëjt.

Allahu na ka paralajmëruar që të mos jemi të pakujdesshëm me të dërguarin e tij të nderuar që është shembulli më i mirë, më i përsosur dhe se ata që e kundërshtojnë Atë, do të poshtërohen dhe për këtë do të qëndrojnë pafundësisht në ferr.

Besimtarët nuk i duan ata që janë armiq të Allahut dhe të peygamberit qofshin këta edhe ballarët, fëmijët apo të afërmit e tyre.

Allahu na bëftë prej atyre që janë të denjë të jenë ndjekësit e tij.

Shokët e donin Atë si malli që ndjen i eturi për ujë në shkretëtirë.

Kur u pyet Aliu se si ishte dashuria për Muhamedin (a.s.) ai u përgjigj:

Ne e donim Atë më shumë se pasuritë, fëmijët dhe prindërit tanë. Ne ishim të etur për Të më shumë se i eturi për ujë të ftohtë.

Imam Ebu Hanife

Nu'mani- imami i imamëve fukahâ

Prej thesareve të mençurisë së Imam Ebu Hanifes (80-150 h.), tabiut të nderuar, njeriut që pati fatin e mirë të takonte gjatë jetës së tij shtatë sahabe të Resulull-llahit (a.s), dijetarit që meritoi dëshminë e më të mirit të krijesave njerëzore: "Shekujt më të mirë janë shekulli im, pastaj ata që vijnë, pastaj ata që vijnë pas tyre" – sepse bënte pjesë në shekullin e artë të tabinëve dhe ishte njëri prej tyre – janë edhe urtësitë e mëposhtme, të cilat na i ka shërbyer në një mënyrë mjaft tërheqëse dhe me shumë dashuri, dijetari dhe edukatori i shquar shqiptar, Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi Shkodrani, në librin e tij me titull: "Ebu Hanife Numani- imami i imamëve fukahâ", në gjuhën arabe, botim i shtëpisë botuese prestigjioze "Darul-Kalem", Damask, 1999.

Nga botimi i gjashtë i këtij libri me shumë vlera, përzgjedha edhe disa pjesë të kapitullit: "*Thesare nga thënie e Imanit*", për t'i paraqitur para lexuesit, me qëllimin e mirë të përfitimit nga fjalët e këtij tabiu të ditur dhe përkujtimit të vlerës dhe madhësisë së tij në dijet islame, në një kohë e në një vend ku po humbin vlerat dhe po shtohen *adhuruesit injorantë dhe lexuesit e shthurur*, siç paralajmëronte edhe i dërguari i Allahut duke treguar për shenjat e kohës së fundit.

Ebu Hanife (r.a) është prej dijetarëve të tre shekujve të parë, për mirësinë e të cilëve ka dëshmuar vetë Resulull-llahi (a.s). Ai është prej tabinëve, ka parë gjashtë apo shtatë sahabe (r.a), ka marrë dituri nga 93 tabinë dhe ka përfituar dituri nga 4000 (katër mijë) hoxhallarë...

Transmeton Kerderiu me sened deri te Jahja ibn Said el-Kattân që thoshte: "Kemi ndenjur me Ebu Hanifen dhe kemi dëgjuar prej tij. Pasha Allahun, sa herë që e shikoja, e kuptoja nga fytyra e tij se ai i frikësohej Allahut të Madhëruar".

Thotë Ibnul-Mubarek: "Hyra në Kufe dhe pyeta për më të diturin e saj, më thanë: Ebu Hanife! Pyeta për më asketin ndër ta, më thanë: Ebu Hanife! Pyeta për më të ruajturin, më thanë: Ebu Hanife!"

Tregon Sajmiriu me sened të Hasanit që thoshte: E kam dëgjuar Imamin të thoshte: "S'kam pasur vështirësi më të madhe sesa stresin e nënës time ditën që më goditën¹. Më tha: O.Numan, kjo dituri që të sollti deri në këtë pikë, e meriton të largohesh prej saj! I thashë: *E kam mësuar diturinë për Allahun, jo për këtë botë!*" ...

Ai ishte në të vërtetë pishtar: në fikh, në hadith, në adhurim, në ruajtjen e tij, në moralin e lartë, në edukatën e madhe, në dijen e vlefshme dhe në këshillat ndaj njerëzve. Ishte me të vërtetë pishtar në thënieën e të vërtetës për të cilën urdhëroi Allahu i Madhëruar, lartësimin dhe përcjelljen e saj te njerëzit, durimin në rrugën e saj derisa i erdhi edhe shehadeti² në këtë rrugë.

Kur i mbërriti lajmi i ndërrimit jetë të Ebu Hanifes, Shu'bes (tabiut të njohur), tha: "U fik drita e dijes në Kufe. Ata s'do të shohin më shembullin e tij, kurrë!".

Ndërsa Ibnu Xhurejxh, muhadithi i Mekës në kohën e tij, kur mësoi për këtë lajm, tha: "Ah, çfarë dijetari paska shkuar!"

E ku ka si Ebu Hanife, shëmbëlltyrë dhe prijës!³

Prej thesareve të urtësisë së tij, përmendim:

Transmetohet nga Zufer ibnul-Hudhejl se Imami ka thënë: "Atë që s'e ndalon dituria nga ndalesat e Allahut dhe s'e pengon nga gjynahet, është prej të humburve".

Transmeton Fudejl ibn Dukejn prej tij, të ketë thënë: "Nëse nuk janë eulijatë e Allahut në këtë botë e në tjetrën, ulematë dhe fukahatë, nuk ka eulija!".

Transmeton Ibnul-Mubarek prej tij, të ketë thënë: "Kush e kërkon udhëheqjen para kohës së saj, do të jetojë i përdhosur sa të jetë!".

Transmeton Ebu Shihabi prej tij, të ketë thënë: "Atij që e kërkon diturinë për këtë botë, do t'i ndalohet begatia e saj dhe s'do të ketë shumë dëbi prej tij njeri! Atij që e mëson për të mirën e fesë, do t'i jepet begati në diturinë e tij, do t'i ngulitet në zemër dhe do të përfitojnë kërkuesit e saj nga dija e tij!".

Transmeton Rexha Hereviu prej tij, të ketë thënë: "Shembulli i atij që kërkon hadithin pa mësuar fikhun, është si shembulli i farmacistit që mbledh ilaçe por që nuk e di se për çfarë sëmundje janë, derisa të shkojë te mjeku. Kështu edhe kërkuesi i hadithit, nuk e njih qëllimin e hadithit derisa të mos shkojë te fakihu!".

E pyeti Ebu Jusufi, Imamin, një ditë se kush ishte më i madh në dije e mirësi, Alkame apo Esvedi? Ai u përgjigj: "Pasha Allahun, nuk jam në atë gradë që t'i përmendi veçse me lutje e falje, në shenjë respekti për ta, jo më të bëj dallim në mes tyre!".

1. U burgos dhe u godit në burg, sepse refuzoi postin e lartë të kadiut, në ditët e kalifatit abasit të Ebu Xhafer Mensurit. (M.S.)

2. Vdiq shëhid. (M.S.)

3. Vehbi S. Gavoçi: "Ebu Hanife Numani- imami i imamëve fukahâ", fq.82 e më poshtë.

Duatë e Profetëve

1. Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetvetes sonë, e në qoftë se nuk na mbulon (mëkatin) dhe nuk na mëshiron, ne me siguri jemi prej të shkatërruarve!(Araf-23)

2. Zoti im! Më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që hynë në shtëpinë time, duke qenë besimtar, edhe besimtarët e besimtaret ndërsa jobesimtarëve mos u shto tjetër, vetëm dëshpërim.(Nuh-28)

3. Zoti im! Unë mbështetem në mbrojtjen tënde që të (mos) kërktoj prej teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur! (Hud-47)

4. Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!(Kamer-10)

5. Zoti im! Më bën mua nga ato që falin namazin, e edhe prej pasardhësve te mijë dhe pranoje lutjen time o Zoti ynë! (Ibrahim-40)

6. Zoti ynë! Më fal mua (gabimet) edhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria. (Ibrahim- 41)

7. Zoti im! Më dhuro mua urtësi dhe më bashko më të mirët! (Shuara'-83)

8. Zoti im! Më dhuro mua(një fëmijë) prej të mirëve! (Saffat-100)

9. ...Zoti ynë! Vetëm Ty të jemi mbështetur, vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja! (Mumtehine- 4)

10. Zoti ynë! Mos na bën sprovë në duar të atyre që nuk besuan dhe falna, Zoti ynë, Ti je ngadhënjyesi, i urti. (Mumtehine-5)

11. Zoti im! Më ndihmo kundër popullit të prishur! (Ankebut-30)

12. Zoti ynë! Pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di. (Bekare-127)

13. Zoti ynë! Bëna neve dyve besimtarë të singertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje , na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tonë dhe falna neve, vërtetë Ti je që falë shumë, je mëshirues!(Bakare-128)

14. Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim, ia parashtroj Allahut... (Jusuf-86)

15. O krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestar imi në dynja e në Ahiret, më bën të vdes mysliman dhe më bashko me të mirët!(Jusuf-101)

16. ...Më gjeti belaja, e Ti je më mëshiruesi ndër mëshiruesit! (Enbija- 83)

17. Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes! (Enbija- 87)

18. E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve. (Araf-143)

19. Zoti im! Më fal mua dhe vëllain tim dhe na dhuro mëshirën Tënde, se Ti je mëshirues i mëshiruesve.(Araf-151)

20. Ti je mbrojtësi ynë, pra na falna e mëshirona, se Ti je më i miri që falë (gabimet).(Araf-155)

21. Cakto për ne (jetë) të mirë në dynja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtetë jemi kthyer nga Ti.(Araf-156)

22. Ma zgjero gjoksin tim dhe më lehtëso në këtë punën time dhe më zgjidh nyjën e gjuhës sime. (Taha-25,26,27)

23. Zoti im! Unë e ngarkova veten e Ti më fal mua! (Kasas-16)

24. Zoti im! Më mundëso që të falënderoj të mirat Tuaja që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më shtie në mesin e robërve Tuaj të mirë. (Neml-19)

25. Zoti im! Më fal (gabimin), më dhuro asi pushteti që askush pas meje nuk do ta ketë; vërtetë Ti je dhuruesi më i madh.(Sad-35)

26. Zoti im! Më fal edhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtetë, Ti je dëgjues i lutjes. (Al-i Imran -38)

27. Zoti im! Më shpjer në vend të mirë dhe më nxjerr në mënyrë të ndershme dhe nga ana Jote më dhuro fuqi ndihmuese.(Isra-80)

28. Më mjafton mua Allahu, s'ka të adhurar pos Tij, vetëm te Ai jam mbështetur, e Ai është Zoti i Arshit të madh!(Tevbe-129)

29. O Allah! O krijues i qiejve e i tokës, Njohës i të fshehtës dhe i të dukshmes, Ti je që gjykon mes robërve Tu për atë që ata kundërshtoheshin. (Zumer-46)

30. Zoti im! Gjyko (mes meje dhe atyre gënjeshtarëve) me të vërtetën! E Zoti ynë, Mëshirues është ai prej të cilit kërkohet ndihmë kundër asaj që ju përshkruani. (Enbija-112)



Muri i ekzistencës

Për njeriun, të cilin e prek thellë në zemër çdo shfaqje e dashurisë hyjnore, kjo botë nuk është gjë tjetër veçse një pasqyrë urtësish hyjnore që i ofrohet intelektit dhe vetëdijes.

Meqenëse është një qenie fisnik për shkak të kuptimit dhe jo për shkak të anës materiale të tij, ai atëherë mund të mbërrijë në thellësitë shpirtërore të perfeksionimit shpirtëror të njeriut. Kjo është edhe cilësia

humane që
lëvdohet aq
shumë në Kur'an.

Ndanë bregut të detit qëndronte një mur. Meqenëse muri që i lartë ishte e pamundur ta kapërceje dhe të mbërrije në det. Majë murit qëndronte një njeri i zhuritur nga etja dhe i mbytur në brenga. Ajo që e ndalonte atë nga uji që lartësia e lartë e murit mbi të cilin qëndronte. Prandaj personi në fjalë rrinte e ofshante si të që një peshk që rreh në zall dhe e ka të nevojshme të hyj në ujë.

Teksa rrëmonte në majë, arriti të këpusë një copë muri dhe e lëshoi poshtë në ujë. Tingujt e krijuar kur copa e tullës u përplas me sipërfaqen e ujit, i përngjanë me gurgullimën e eliksirit. Njeriu majë murit të lartë u shkri i tëri nga kënaqësia që i dhuruan tingujt harmonikë që lëshoi uji. Njeriu që i qenë zhuritur buzët nga etja e madhe, nisi të përpiqej të këpuste sa më shumë copa gurësh nga muri dhe t'i hidhte ato në ujë. Por uji i tha:


"- O eremit! Ç' ka ngjarë me ty që rri e më hedh me aq ngazëllim copëza gurësh mbi mua?"

Eremiti, të cilin e kishte përcëlluar etja e madhe, u përgjigj duke i thënë:

"- O ujë! Nga këto copëza gurësh që lëshoj mbi ty, kam dy të mira. Prandaj mos më kërkohet që të heq dorë. E mira e parë është:

"Dëgjoj tingujt e ujit që njerëzve të cilët janë të etur si unë, u përngajnë me meloditë më të bukura."

"Ai tingull më përngjan me shirat e begatë të muajit prill të stinës së pranverës. Kopshtet dhe bostanet heqin mallin me ata lot qiellor, ringja-



llen dhe lulëzojnë."

"Ai tingull i përngjan ftesës për t'i dhuruar nevojtarit dhe të ngratit që përpëlitet në skamje."

"Ai tingull më përngjan me frymën mëshiruese të të Dërguarit të Allahut tek gjendej në Jemen, i cili në lidhje me Vejsel Karanin pat thënë: I dëgjoj pëshpëritjet mëshiruese që vijnë nga Jemeni."

"Ai tingull më përngjan me klithmat shpëtimtare për ndërmjetësim të të Dërguarit të Allahut për mëkatarët myslimanë që gjenden përballë agorës hyjnore."

"Ai tingull më përngjan me aromën e brishtë të Jusufit, të cilën e nuhaste Jakubi i drobitur."

"Ai tingull, më përngjan me erën e agimit që fryn mbi të dashuruarit pas fesë atje, nga minaret e Kubbetu'l-Hadra në Medinën e Ndritshme."

"Ai tingull i përngjan flladit prehës së Lejlasë që shkonte drejt Mexhnunit të dërrmuar dhe të brengosur."

"Ai tingull më përngjan me krahët e hapur drejtuar jetimit."

E mira e dytë është kjo:

Me çdo copëz sa do të vogël që shkëpus, muri zvogëlohet dhe kështu unë mund të arrij tek ti, o ujë!

Libri i distikëve (methnevi):

"O njeri i ndërgjegjësuar! Nuk ka dyshim se pak nga pak po të gërryesh murin, ai do zvogëlohet një ditë sado i lartë që të jetë"

"Zvogëlimi i murit do të thotë të mbërrish te uji që ka përreth."

"Në Kur'anin Fisnik Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë:

"Bjer në sexhde dhe afromu!"

"Për sa kohë që ky mur të ngrihet i lartë, kjo do



të pengojë që të vësh ballin në sexhde!"

"Për sa kohë që kjo tokë nuk pastrohet nga nevojat trupore, është e pamundur që t'i biesh në sexhde pronarit të eliksirit dhe të pish me dëshirë nga oqeani shpirtëror."

"Ai person të cilin e ka marrë më shumë etja majë murit, është njeriu që do t'i shkëpusë sa më parë gurët dhe tullat e tij."

"Njeriu që është më shumë i dashuruar pas tingujve të ujit, do të shkëpusë copat më të mëdha nga muri që e pengon të mbërrijë tek uji."

"Ai njihet, dashurohet si i marrë pas gurgullmës së ujit dhe nuk dëshiron të dëgjojë tjetër tingull të ndryshëm nga ai."

"I lumi ai që ditët e jetës i vlerëson si kapital dhe përpiqet ta shlyejë sa më parë huan e tij."

Mistiku islam Sadi e përshkruan njeriun me këto fjalë:

"Disa pika gjaku dhe mijëra mëdyshje...".

Në rrëfimin e mësipërm muri që e pengonte njeriun të mbërrijë tek uji, simbolizon dëshirat e pafund dhe të pasosura të kësaj jete dhe ato individuale, veçanërisht "ego-ja" që e pengojnë individin të mbërrijë tek e vërteta absolute.

Deti dhe oqeani simbolizojnë dashurinë hyjnore dhe njohjen e Allahut (marifet).



Mistiku islam Sadi e përshkruan
njeriun me këto fjalë:

“Disa pika gjaku dhe mijëra
mëdyshje...”

Njerëzit që i ndriçojnë zemrat e tyre me dashurinë hyjnore, e kalojnë një jetë të tërë me përdëllimin dhe pasionin për të mbërritur tek ai oqean i pafund. Çdo tingull dhe frymë që vjen nga ai oqean dashurie dhe njohje hyjnore, i përgatit ata individë për një udhëtim të gjatë drejt të Vërtetës Absolute duke i zhytur në shije të pafundme përjetimesh shpirtërore.

Për njeriun, të cilin e prek thellë në zemër çdo shfaqje e dashurisë hyjnore, kjo botë nuk është gjë tjetër veçse një pasqyrë urtësish hyjnore që i ofrohet intelektit dhe vetëdijes. Meqenëse është një qenie fisnik për shkak të kuptimit dhe jo për shkak të anës materiale të tij, ai atëherë mund të mbërrijë në thellësitë shpirtërore të perfeksionimit shpirtëror të njeriut. Kjo është edhe cilësia humane që lëvdohet aq shumë në Kur'an.

Është e mirënjohur që një ditë e kësaj bote që kalon me një jetë shtazarake të mbushur me llojlloj dëfrimesh dhe marrëzish, na privon nga dashuria hyjnore dhe shijet e jetës së amshueshme. Natyrisht që këtë natë të zezë pus nuk do ta zhदारariste një agim i lumtur. Sa e dhimbshme në emër të nderit dhe dinitetit human është të mbetesh

i tromaksur përballë shfaqjeve dhe ngjarjeve mësimdhënëse hyjnore, të mbetesh pa qëllime, të humbasësh brenda vorbullës së dhimbjeve të vdekjes! Jeta kalimtare e kësaj bote është e mbushur me ftohtësinë e jetës së përtejme, kurse gajasjet e tyre janë të ngopura me krikëllimat e xhehenemit.

Në hadithin fisnik thuhet:

"Kini kujdes që të mos qëndroni tok me të vdekurit!"

Sahabet e pyetën:

"- O i dërguar i Allahut (xh. sh.), kush janë këta të vdekur?"

Muhamedi (a.s.) urdhëroi e tha:

"- Të vdekur konsiderohen ata që zhyten pas botës..."

Kur një person përzihet me menefregistët ndaj mësimëve të fesë, njerëz që nuk kanë dallim nga të vdekurit, e përthith helmin e vdekjes prej tyre, pa e vënë re. Ky efekt që bie mbi të, ia shndërron zemrën në zemër të vdekur.

Prandaj ilaçi i vetëm është shoqërimi me njerëzit, zemrat e të cilëve ndaj mësimëve të

fesë janë përherë të gjalla. Në rast pamundësie kur gjendemi larg nga personalitete të këtyllë, atëherë duhet të lexojmë sa më shumë Kur'an, duke u thelluar në pikat delikate që na mëson ai.

Në një hadith thuhet:

"Personi që dëshiron të bashkëbisedojë me Zotin e tij, le të lexojë sa më shumë Kur'an!"

Personi që i vihet udhës së drejtë me Kur'anin, vishet me moralin që na mëson Kur'ani dhe profeti ynë, Muhamedi (a.s.) Mes rrëfimeve të profetëve që tregohen në Kur'an dhe vetë personit, lind një familjarizim dhe krijohet një marrëdhënie solide. Nga ajo kulturë shpirtërore në shpirtin e tij reshonjë shirat e frymëzimit.

Në një raportim nga Xhabiri (r.a.) rrëfëhet.

"Shkova në shtëpinë e të dërguarit të Allahut (a.s.) dhe trokita në derë.

"- Kush është?" u dëgjua një zë nga brenda shtëpisë.

"- Unë!" u përgjigja.

I dërguari i Allahut (a.s.),

nuk i pëlqeu fakti që përdora shprehjen "unë", brenda së cilës fshiheshin "mendjemadhësia dhe krekosja".

Mevlana me gjuhën e tij e rrëfen kështu këtë tregim:

"Trokita në derë. Kur thashë "Jam unë!", "i dashuri" më tha:

"- Shko!, Nuk është koha që ti të hysh brenda!. Nuk ka vend për shpirtra të këtillë të papjekur në këtë fushë begatish shpirtërore!."

"I ngrati u kthye pas. Për një vit doli rrugësh i ndezur flakë me xixëllimën e përdëllimës dhe ndarjes nga "i dashuri"."

"I dashuruari i djegur nga dashuria u poq dhe u kthye pas. Sërish shkoi në derën e "të dashurit"

"Trokiti në portë duke shtrënguar dhe mbajtur buzët me forcë nga frika se mos lëshonte ndonjë fjalë që nuk do t'i kishte hije."

"Kur pas derës u dëgjua një zë tek pyeste:

"- Kush është në derë?"; u përgjigj:

"- O ti që më ke fituar zemrën!.. Je "ti" në derë..."

"I dashuri" tha:

"- Meqë tani edhe ti je në të njëjtin nivel shpirtëror me mua, hyr brenda, sepse dy "unë" nuk kanë vend brenda një shtëpie."

Mevlana shton e thotë:

"Çdokush që artikulon fjalët "unë" dhe "ne" në portën e Të Vërtetit, ai është i destinuar që të sillet dhe shëtisë në luginën e "Jo-së". Të tillët nuk e kalojnë dot derën e miqësisë."

Ashtu sikurse një farë gruri në fund shndërrohet në bukë dhe hyn në trupin e një të gjalli duke u bërë pjesë e tij;

Ashtu sikurse një gur antimoni pasi të rrihet dhe kthehet në pluhur për të lyer me të më pas syrin duke humbur cilësinë e përbërjes së gurit, i fal pamje të bukur syrit dhe shndërrohet në forcë tërheqëse për të.

Ashtu sikurse një përrua kur derdhet në det e humbet cilësinë e ujit të përroit dhe hyn në brendi të detit dhe bëhet kështu një pjesë e tij;

Po qese një person fiton nga

bota shpirtërore, frymëzimi dhe vështrimi nga një mik i Zotit (veli) nga shpirti i tij zë fill përfeksionimi dhe kultura shpirtërore. Shpirti i tij nga i vdekur gjallëron përballë ngjarjeve, sendeve dhe krijesave.

Edhe ndërgjegjes humane i bën thirrje të ndërtohet jo mbi jetën e ngushtë frymore, por mbi dashurinë dhe përkushtimin të cilët fronin e tyre e lartësojnë në përjetësi.

Për sa kohë që dashuria për Kuranin Fisnik nuk resh në shpirtrat tanë ashtu si reshjnë shirat e begatë të muajit prill mbi shpirtrat tanë të mbetur djerrë, nuk mund të rrokemi pas stinës së trëndafilte të frymës muhamediane.

Kopshtet e shpirtit presin shirat e veprave dhe akteve të mira, ashtu si është e dashuruar toka pas pikave të shiut. Vetëm kështu buisin filizat e dhembshurisë, mëshirës dhe shërbimit human për krijesën në emër të Krijuesit.

Njeriu shndërrohet në ekstraktin e librit të gjithësisë dhe kopjen unike të krijimit. Duke u kthyer në syrin që sheh dhe veshin që dëgjon në përputhje me dëshirën hyjnore të Zotit të tij.

Kopshtet e shpirtit presin shirat e veprave dhe akteve të mira, ashtu si është e dashuruar toka pas pikave të shiut. Vetëm kështu buisin filizat e dhembshurisë, mëshirës dhe shërbimit human për krijesën në emër të Krijuesit



E gjithë bashkësia njerëzore në përgjithësi dhe ajo myslimane në veçanti do të përfitojnë nga duart, gjuha dhe shpirti i tij.

Sa bukur është shprehur në Librin e Distikëve (Methnevi) jeta e halifes së dytë të myslimanëve, Umerit (r.a.):

"Kur delegati i romakëve erdhi për të realizuar një takim politik me halifen e myslimanëve në Medinën e Ndrirshme, të parin nga myslimanët që takoi e pyeti se ku e kishte pallatin e tij Umeri (r.a.) Personi që pyeti iu përgjigj:

"- Halifi ynë nuk ka pallate apo saraje. Ai ka një fron shpirtëror të pastër. Sa për të jetuar ai jeton në një barakë të vogël të njëjtë me ato në të cilat jetojnë të vetmuarit dhe të varfrit. Ky është pallati i tij në këtë botë".

Këto fjalë bën që delegatin romak ta kapte habia dhe ta zinte tmerri. La mënjanë peshën, kalin dhe dhuratat që kishte ma-

rrë me vete dhe u nis fillikat që të kërkonte se ku jetonte Umeri (r.a.) Teksa kërkonte hafifen, mërmëriste me vete:

"Pra paska në këtë botë edhe nga ata mbretër që qëndrojnë larg shikimeve lakmitare që u ofron posti."

Teksa pyeste se ku mund ta gjente halifenë, një grua arabe i thotë:

"- Ja atje nën pemën e hurmës qëndron halifi të cilin je duke e kërkuar! Ndërsa të tjerët prehen mbi shtretër dhe mindere të rehatshme ai preferon të shtrihet mbi rërë! Shko tek pema e hurmës dhe aty do të gesh të shtrirë mbi rërën "hijen e Zotit"!.." (halifet e cilësonin vetveten në mënyrë figurative "hijet e Zotit" (dhilullah) nën të cilën gjennin prehje nevojtarët, të varfrit dhe ata mbi të cilët ishte bërë padrejtësi për hallet dhe problemet e tyre).

Tek sheh Umerin të shtrirë

mbi rërë duke fjetur, në zemrën e delegatit romak përjetohet një ndjesi e re. Delegati habitet sesi në shpirtin e tij ai përjeton dy ndjenja të cilat deri më atëherë kishin qenë të kundërta në zemrat e tij, dashuria për një person dhe madhështia. Delegati thoshte me vete:

"Unë kam parë perandorë dhe mbretër të shumtë dhe kam fituar vlerësimin e tyre për mua! Madhështia dhe dashuria e këtij personi ma gjunjëzoi vetëdijen time."

"Ky halife është shtrirë dhe po fle këtu i vetëm pa pasur përreth njerëz që ta ruajnë apo pa mbajtur shpatë me vete. Ndërsa unë dridhem i tëri përpara tij! Vallë ç'po ngjan me mua?!. Kjo madhështi vjen pa dyshim nga Zoti dhe jo nga ky njeri i veshur kaq thjesht!..".

Teksa delegati romak përjetonte në shpirtin e tij këto fërgëllima, Umeri (r.a.) zgjohet nga gjumi. Delegati romak e për-

shëndet me respekt dhe merr të njëjtën përgjigje nga halifeja.

Njeriu i devotshëm dallohet dhe bie në sy menjëherë për shkak të rrëzëllimit që i merr fytyra, e cila rrezaton përreth saj vetëm prehje dhe bukuri shpirtërore.

Njeriu mëkatar bie në sy për çehren e ngrysur dhe vështimet e ftohta dhe të vrenjtura që lëshon tek sheh rreth e rrotull vetes.

Arkitekti shpirtëror i Pakistanit Muhamed Ikbali duke vizituar një ditë prej ditësh haxhilerët që ishin kthyer nga Medineja, u drejton atyre këtë pyetje e cila ekspozon horizontin shpirtëror të një besimtarit të vërtetë:

“E vizituar Medinën e Përndritshme! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medinës? Dhuratat materiale që keni sjellë, taket, tesbihët, sexhadet pas ca kohësh do të

vjetrohen, do të vyshken dhe do të marrin fund. A na keni sjellë nga dhuratat e Medinës që nuk fishken kurrë, që i japin jetë shpirtëve?

A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit, drejtësi si të Umerit, ndjenjë turpi dhe bujari si të Uthmanit, klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut? A do të mund t'i falni botës Islame që sot përpëlitet me mijëra halle, emocionet e shekullit të lumturisë?”

Me këto fjalë Muhamed Ikbali e ka zemrën vrer për situatën e mjerë dhe qorrrokakun në të cilën ka hyrë bota islame. Pa dyshim që ai ka qenë një poet dhe mendimtar mysliman i madh që jetonte me dhimbjen që të fal realitetin ku shpirti dhe fryma islame nuk kalohet në jetë.

Në një hadith thuhet:

“Kjo botë dhe jeta e përtejme janë si të kesh dy bashkëshorte të ligjshme. Sa herë ta gëzosh njërin ke për të fituar mërzinë

dhe pezmatimin e tjetrës.”

Poqese në shpirtat tanë zë vend thirrma e ftesës ndaj botës, atëherë edhe këshilla për botën e përtejme po aq është e huaj. Poqese ftesa për jetën e përtejme hedh rrënjë, atëherë ftesat e kësaj bote janë të huaja për të.

Mevlana thotë:

“Poqese pranon një nga këta tinguj as nuk ke dëshirë të dëgjosh tjetër melodi në jetë, sepse ai që dashurohet shndërrohet në të verbër dhe të shurdhër për çdo gjë tjetër.”

Karvanët e dashurisë kreu i të cilëve zgjatet deri në kiamet, do të qetësohen dhe ngushëllohen me lotët e Tij të dashurisë, amshimit dhe dhembshurisë.

Lum ata që arrin në ndjenjat e bamirësisë duke marrë pjesë nga bota personale dhe shpirtërore e shembullit për njerëzinë mbarë, Muhamedit (a.s.)

Raporti i njeriut ndaj Krijuesit: revoltë apo frikë-respekt

Ytetërimi i vjetër grek marrëdhëniet mes njerëzve dhe zotave i përfytyronte si revoltë dhe sfidim. Sipas tij, zotat gjithnjë duan ta nënshtrojnë njeriun dhe, në mënyrë që ai të mos i gëzojë frytet e punës së vet, sa herë që ai arrin sukses, zotat e hedhin në fatkeqësi. Ndërkaq, njeriu, në anën tjetër, i sfidon vazhdimisht zotat dhe kur bie, ai përsëri e merr veten dhe vazhdon luftën e tij me zotat.

Legjenda e njohur për Prometeun thotë se Zeusi, perëndia më e madh, babai i perëndive dhe i njerëzve e urdhëroi Epimeteun, që ishte i biri i Titan Japet që t'i jepte çdo qenie të gjallë armët që i duheshin për të mbrojtur jetën. Kështu Epimeteu i pajisi kafshët me thonj, dhëmbë e shkathtësi që të mbi-jetonin, por ai bëri një gabim sepse harroi njeriun. Raca njerëzore do të ishte zhdukur sikur atë mos ta ndihmonte Prometeu, vëllai i Epimeteut.

Meqenëse nuk kishte mbetur asnjë armë për njeriun, Prometeu i dhuroi atij diçka më të çmuar: trurin. Edhe pse ai i dha njeriut zgjuarsinë që të mund të përballonte armiqtë e tij, njerëzit përsëri vuanin, sepse u mungonte diçka që të mund tua bënte jetën të mundshme: zjarri. Zjarrin e kishin dhe e përdorin vetëm perënditë. Ata donin ta mbanin vetëm për vete. Sipas këtij miti, titani, Promete duke parë se njerëzit jetonin në errësirë e në të ftohtë, i erdhi keq për ta, andaj ua rrëmbeu zjarrin perëndive dhe ua dha njerëzve dhe që atëherë filloi epoka më e rëndësishme për njerëzimin. Mirëpo Zeusi u zemërua për këtë "krim" me Prometeun dhe me njeriun.

Meqë tashmë nuk mund t'ua merrte zjarrin njerëzve, vendosi ta ndëshkonte rëndë Prometeun dhe njeriun. E rrëmbeu Prometeun dhe e çoi në një mal të madh që quhej Kaukaz duke e lidhur me zinxhirë që të mos lëvizte. Ngarkoi një shqiponjë të madhe që të hante ditën mëlçinë e Prometeut, e cila i rritej përsëri natën. Kësaj torture të Prometeut që zgjati 30 vjet i dha fund Herkuli që ishte i biri i Zeusit, hero dhe gjysmë perëndi. Ai iu lut Zeusit,

ta lejonte të vriste shqiponjën dhe të këpuste zinxhirët që kishin mbajtur të lidhur martirin Promete. Zeusi ia plotësoi dëshirën Herkullit dhe e lejoi që ta lironte Prometeun.

Kurse njeriut Zeusi i dërgoi Pandorën dhe së bashku me të i dërgoi dhuratë një kuti të mbyllur. Kur njeriu e hapi atë pa se ajo ishte e mbushur me të këqija, që dolën nga kutia dhe u shpërndanë në sipërfaqen e tokës, në mënyrë që të jenë shkak armiqësie dhe trishtim i vazhdueshëm për njeriun. Pra, përmes kësaj legjende, raportet mes njeriut dhe zotave janë vlerësuar si raporte konkurrence dhe sfidimi mes tyre.

Ndërkaq krejt ndryshe nga ky mit i rremë, sipas doktrinës islame njeriu është i krijuar prej Allahut, çdo gjë i është dhuruar prej Tij, gëzon përkrahjen e Tij dhe mbështetet në çdo çast të jetës tek Ai dhe në fund i kthehet vetëm Krijuesit. Mësimi islam thekson gjithëfuqinë e All-llahut. Kurani na flet për mëshirën e All-llahut dhe vë baraspeshën mes mëshirës dhe drejtësisë së Allahut. Çdo sure e Kuranit fisnik dhe çdo vepër e besimtarit fillon me "Bismillahir Rrahmanir Rrahim", ku janë të përmendur emrat e bukur të mëshirës: err Rrahman dhe err Rrahim, e jo emrat e zemërimit. Sipas një hadithi të Muhammedit (a.s.) mëshira i paraprin hidhërimin të All-llahut.

Njeriu sipas Islamit është rob dhe mëkëmbës i All-llahut. Si rob i All-llahut njeriu duhet t'i nënshtrohet plotësisht vullnetit të Tij, duke pranuar Programin Hyjnor që përmban udhëzimin dhe

Mësimi islam thekson gjithëfuqinë e All-llahut. Kurani na flet për mëshirën e All-llahut dhe vë baraspeshën mes mëshirës dhe drejtësisë së Tij

drejtimin dhe ta zbatojë atë në jetën e përditshme në mënyrë që të fitojë kënaqësinë në këtë botë dhe shpëtimin në botën tjetër. Kurse si mëkëmbësi i All-llahut njeriu duhet të jetë aktiv sepse ka pranuar amanetin që nuk e pranuan as toka dhe as qiejt (El Ahzab: 72).

Kurani na mëson se Zoti nuk është ziliqar ndaj njeriut, sikurse flitet në legjendën greke, përkundrazi Zoti, sipas Kuranit, është shumë bujar ndaj njeriut, madje Zoti i ka dhënë njeriut shumë favore, duke e lartësuar mbi të gjitha krijesat tjera:

“Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam. (El-Isra: 70);

E ka bërë njeriun në formën më të bukur:

“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.” (Et Tin: 4);

I ka dhënë shpirtin:

“...dhe kur ta kem përsosur atë (njeriun) dhe t’i kem dhënë nga ana Ime shpirt, ju menjëherë përlujni atij (në sexhde)” (Sad: 72);

Dhe e ka caktuar të jetë mëkëmbës i Tij mbi tokë: “(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një mëkëmbës!...” (El-Bekare: 30).

Islami nuk e sheh njeriun si rival të Krijuesit apo si një krijesë të pavarur prej tij, që mund të zërë edhe vendin e Krijuesit. Zoti e krijoi njeriun për të dëshmuar Njëshmërinë e Tij dhe për të adhuruar vetëm Atë. All-llahu i është drejtuar njerëzimit që në kohën e shpirttrave me pyetjen: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” dhe njerëzit, pa përjashtim, që të gjithë janë përgjigjur: “Po, dëshmojmë!” (El Araf:172). Nëpërmjet kësaj Po-je njeriu e ka pranuar Allahun si Zot të vetin, madje qysh para ardhjes së tij në këtë botë.

Pra Zoti ka marrë prej shpirttrave të njerëzve zotimin (mithakun) që në botën e shpirttrave dhe gjithë

Në Islam njeriu nuk konceptohet në natyrën e tij titanike ose prometiane, që rebelohet ndaj Vullnetit të Qiellit në mënyrë heroike. Përkundrazi, madhështia e njeriut sipas mësimit islam qëndron në të qenët e tij rob-shërbëtor i All-llahut

njerëzimi ka pranuar Hyjninë e All-llahut. Kjo paraqet besëlidhjen që shpirti i secilit njeri e ka “nënshkruar” para Zotit. Secili njeri është zotuar se do ta njohë dhe se do ta pranojë All-llahun për Krijues dhe Furnizues të tij. Kjo tregon për atë se adhurimi dhe pranimi i Krijuesit është skalitur në vetë natyrën e njeriut (el fitrah) që ndonëse mund t’i nënshtrohet harresës, egoizmit dhe pasionit, megjithatë është i pranishëm në zemrën e çdo njeriu.

Sipas Islamit mëkati dhe rënia e njeriut vjen para së gjithash si pasojë e harrimit të këtij zotimi. Qëllimi i mesazhit të Zotit është që t’ia përkujtojë njeriut zotimin e dhënë para se të vinte në këtë botë. Mu për këtë në shumë vende në Kuranin fisnik lexojmë shprehjen fe dhekir: përkujtoji atyre.

Islami i kundërvihet tërësisht idesë së rebelimit dhe revoltës ndaj Krijuesit. Dyshimi e individualizmi që mund të shihet në Greqinë e Vjetër dhe Evropën pasmesjetare i pasqyrohet në letërsinë e këtyre periudhave, nuk gjendet në Islam. Në Islam njeriu nuk konceptohet në natyrën e tij titanike ose prometiane, që rebelohet ndaj Vullnetit të Qiellit në mënyrë heroike. Përkundrazi, madhështia e njeriut sipas mësimit islam qëndron në të qenët e tij rob-shërbëtor i All-llahut.

Prandaj ideja e pavarësisë së njeriut nga Krijuesi dhe mosnjohja e moszbatimi i urdhrave të Tij, një trend i shoqërisë perëndimore, është i huaj për mësimin islam. Zoti ka përbushur zotimin e tij ndaj nesh duke na dhënë fuqi, aftësi, udhëzim dhe ka vënë çdo gjë në shërbim të njeriut, në mënyrë që ai të mund ta realizojë rolin e tij prej mëkëmbësi mbi tokë. Mbetet në dorën e njeriut nëse dëshiron të jetë konsekuent ndaj zotimit që i ka dhënë All-llahut dhe pranimi të Njësisë së Tij, duke marrë përgjegjësi si mëkëmbësi i All-llahut në tokë, apo të rrëshqasë në një nivel edhe më të ulët se kafshët: (El Araf: 179).

Madhështia njeriut nuk i vjen prej vetes dhe prej të qenët i pavarur, por prej të qenurit krijesë, shërbëtor dhe mëkëmbës i Tij.

Pikërisht për këtë Muhammedi (a.s.) nuk lartësohet nga muslimanët në nivelin e Hyjit, apo në nivelin e birit të Hyjit, sikurse bëjnë të krishterët me Isain a.s (hasha lilah, All-llahu na ruajt) por konsiderohet rob-shërbëtor dhe i dërguari i All-llahut. Kjo është shkalla më e lartë që mund të arrijë njeriu. Këtu qëndron gjithë madhështia e Islamit karshi doktrinave dhe feve të tjera.

Devotshmëri dhe moral shembullor

"...Bëj mirë ashtu siç të ka bërë Zoti ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Zoti nuk i do çrregulluesit." [El-Kassas, 77]

Zoti urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve dhe ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon që të merrni mësim. [En-Nahl, 90]

Foja islame është një sistem që ka për synim të formojë njeriun ideal. Formimin e elitës që është shembull për mbarë njerëzimin. Një elitë kjo e kompletuar nga të gjitha drejtimit që i bën ata për të qenë model për të tjerët. Profeti i fundit Muhamedi (sav) tregon se ky prototip ka dy krahë të fuqishëm që e bëjnë të tillë: *"Devotshmëri ndaj Zotit të Lartë dhe (njeri me) moral shembullor"*. (Tirmidhiu, Birr, 62)

Nisur nga kjo formulë profetike kuptojmë se lumturia e dy botëve arrihet vetëm me dy elemente të pandashme; zbatim i këshillave të Zotit dhe shembulli etik. Kështu që, të mendohet se mjafton morali i vetëquajtur i mirë dhe të thuhet: "e kam zemrën e pastër" duke vlerësuar si të panevojshme orientimin hyjnor, sipas islamit kjo gjë nuk sjell si rezultat lumturinë e vërtetë. Kjo formulë duhet të lexohet mirë edhe nga aspekti tjetër: për një lumturi të dyanashme nuk mjaftojnë vetëm na-


mazet, agjërimet dhe ibadetet e tjera, bashkë me këto duhet paktjetër edhe edukata, mirësjellja, respekti dhe dashuria ndaj të tjerëve. Pra, në një farë mënyre mund të thuhet se besimtar i mirë është ai që përveç linjës së rregullt që duhet të ketë me Zotin duke zbatuar urdhëresat e Tij dhe duke u shmangur nga ndalesat që ka caktuar Ai, besimtar i vëretetë është ai që krahë ka këtyre, vlerësohet me një notë maksimale edhe nga familja e tij, nga të afërmit, fqinjët e nga rrethi shoqëror i tij. Kjo ka këtë domethënie; besimtari i devotshëm medoemos duhet të jetë edhe shembull me sjelljet e

tij, atëherë është i kompletuar. Nuk mund të jetë edhe besimtar i mirë edhe person që nuk respekton familjen tij, që i mërzhit ata. Edhe mysliman i mirë edhe person që fyen të tjerët, që i shqetëson ata, është e pamundur të jetë! Nga e njëjta gojë që dalin edhe fjalë kur'anore edhe fjalë banale, është pamundur të jetë pjesë e karakterit të një myslimani të denjë! Këto dhe shembuj të tjerë kontradiktorë kanë një raport të vetëm: vlera – antivlera, të cilat është e pamundur t'i posedojë i njëjti person, i cili është ndjekës i gjurmëve të Muhamedit (sav).

Morali i mirë është hija e cilësive të Zotit mbi njerëzit dhe reflektimi hyjnor i shfaqur tek njerëzit. Pajisja me moral të mirë tregon afërsinë tek Zoti dhe për këtë arsye morali i lartë është një nga objektivat e adhurimeve. Përshembull, një nga qëllimet e namazit dhe të agjërimet është t'i formojë njeriut moralin shembullor. Vetëm me anë të moralit të lartë mund të ketë dashuri dhe harmoni në një popull. Një popull që e

Nisur nga formulat profetike kuptojmë se lumturia e dy botëve arrihet vetëm me dy elemente të pandashme; zbatim i këshillave të Zotit dhe shembulli etik

Nga e njëjta gojë që dalin edhe fjalë
kur'anore edhe fjalë banale, është
pamundur të jetë pjesë e karakterit të një
myslimani të denjë! Këto dhe shembuj të
tjerë kontradiktorë kanë një raport të vetëm:
vlëra – antivlerë



prish moralin, është i destinuar të shkatërrohet e të zhduket dhe për këtë është dëshmitare edhe vetë historia.

Profeti ynë Muhamedi (sav.) duke na treguar për natyrën njerëzore na e bën të ditur edhe se çfarë e bën njeriun më të dashur tek të tjerët:

“Është e pamundur që njerëzit t'i gëzoni dhe t'i kënaqni duke iu gjendur në ndihmë materiale. (Nuk mjafton pasuria për këtë) Prandaj, me fytyrë të qeshur dhe me moral të mirë mundohuni t'i gëzoni ata.” (Hakim, I, 212)

Ata që do të jenë në shkallën më të lartë të xhenetit dhe më pranë Muhamedit (a.s.) në botën tjetër, përsëri janë ata që janë të pajisur me moral të mirë. Për këtë na lajmëron vetë Muhamedi (s.a.v.) duke thënë:

“Ai që është me moral të lartë është më i dashur tek unë dhe më pranë meje në Ditën e Kijametit” (Ibn Hibban, II, 231) Në një rast tjetër Profeti ka thënë: *“Besimtarët më të pjekur në besim janë ata që kanë moralin më të mirë” (Ibn Hibban, IX, 483)*

Morali që e përsos njeriun në të dy botërat, padyshim që është morali islam. Ky moral ka lindur brenda sistemit të vlërave

ve universale të vendosura nga Kur'ani, është formuar me traditën profetike dhe është përsosur duke u zbatuar nga personaliteti shembullor, Profeti i fundit (paqja qoftë mbi të).

Sa'd bin Hishami (r.a.) i tha Aishes (r.anha): “O nëna e besimtarëve! Shpjegomë për moralin e të Dërguarit të Zotit.” Ajo e pyeti:

“-A nuk lexon Kur'an ti?” Sa'di i tha:

“-Po, lexoj.” Atëherë Aisheja (r.anha) i tha:

“-Morali i të Dërguarit të Zotit ishte Kur'ani.” (Muslimi, Musafirun, 139)

Të gjitha cilësitë morale që Zoti i Madhëruar i lavdëron në Kur'anin Famëlartë, me plotkuptimin e fjalës ishin të përmbledhura tek i Zgjedhuri i Zotit, Muhamedi (a.s.).

Prandaj edhe Zoti i Madhëruar i tha:

“Vërtet ti je në një shkallë të lartë të moralit” {Kur'ani, 68/4}

I dërguari i Zotit aq shumë i kushtonte rëndësi zbukurimit të moralit saqë edhe qëllimin e profecisë së tij e ka shprehur në këtë mënyrë:

“Unë jam dërguar që të plov

tësoj moralin e mirë” (Muvatta, Husnul khuluk, 8)

Tani, me pasazhe nga Kur'ani dhe me fragmente nga jeta e Profetit tonë Muhamedit (sav.) le të mundohemi të përmendim disa prej virtyteve kryesore që duhet të jetë i pajisur çdo besimtar shembullor.

MODESTIA

Feja islame i ka kushtuar shumë rëndësi thjeshtësisë. Zoti i Madhëruar thotë: **“Ju mos lavdëroni vetveten, Allahu e di më së miri se kush është i devotshëm”**{Nexhm, 53/32} **“Allahu nuk don asnjërin që lavdërohet”** {Llukman, 31/18}

Fjalët e mëposhtme të Muhamedit (a.s.) janë të spikatura për të kuptuar rëndësinë e thjeshtësisë tek njeriu: **“Allahu e lartëson atë që paraqitet modest para Tij, ndërsa atë që i paraqitet arrogant Atij, e poshtëron.” (Fejzu'l-Kadir, VI, 108-109)** **“Pa dyshim që Allahu, mua ma shpalli që të jeni modestë” (Rijadu's-Salihin, II, 37)**

Ky virtyt ishte pjesë e karakterit të Profetit të fundit. Një ditë Muhamedit (a.s.) i vjen një person në shtëpi, i cili dridheshe nga emocionet. Pejgamberi pa këtë gjendje të tij dhe i tha: **“Qetësohu, unë nuk jam**



Biri im, nuk formohet shoqëri me këdo.

**Nuk bëhet shoqëri me një njeri që ta sjell
shpinën në raste nevojë e as me një njeri që
kur ngrihet në post të sillet me përbuzje e
arrogancë**

**mbret. Jam biri i një gruaje
kurejshite që hante mish të
thatë.”** (*Gazalî, Ihjâu Ulûmi'd-
din, Kajro 1954, II, f. 483, 484*)

Abdullah bin Xhubejri
(r.a.) rrëfen një ngjarje mjaft
domethënëse;

Një ditë Pejgamberi kur po
ecte në rrugë me një grup të
shokëve të tij, njëri prej tyre
desh ta mbronte nga dielli të
Dërguarin e Zotit me një mbu-
lesë. Kur e pa hijen Muhamedi
(a.s.), ngriti kokën lart, e pa që
njëri po i bënte hije. E urdhëroi
që ta lëshonte dhe pasi e vend-
os në tokë mbulesën, i drejtohet
duke i thënë: **Edhe unë jam nje-
ri sikur ju!** (*Hejthemi, IX, 21*).

Muhamedi (a.s.) i qortonte
ata që e lartësonin atë duke u
thënë: **“Mos më ngritni më lart
gradës që kam, sepse Zoti i Ma-
dhëruar para se t’me bënte pro-
fet më bëri rob të Tij”** (*Hejthemi,
IX, 21*)

Një njeri i urtë dikur e
këshillonte të birin:

**“Biri im, nuk formohet shoqëri
me këdo. Nuk bëhet shoqëri me
një njeri që ta sjell shpinën në
raste nevojë e as me një njeri që
kur ngrihet në post të sillet me
përbuzje e arrogancë.”**

MBËSHTETJA NË ZGJEDHËN HYJNORE¹

Të dorëzohesh tek Zoti nuk
e ka kuptimin të braktisësh
punën e çdo gjë t’ia veshësh
skenarit hyjnor (kaderit). Kur
njëri e pyeti Pejgamberin (a.s.)
“A të dorëzohem tek Zoti pasi
ta kem lidhur kafshën apo pa e
lidhur?” Pejgamberi (a.s.) i tha:
“Njëherë lidhe, pastaj dorëzohu tek
Zoti” (*Tirmidhiu, Kijame, 60*) Kjo
tregon, që besimtari duhet të
bëjë aq sa ka mundësi, pastaj të
mbështetet tek Zoti.

Shembulli më i përkryer për
ndjenjën e dorëzimit tek Zoti
është ngjarja e fshehjes së Pej-
gamberit (sav.) me Ebu Bekrin
(r.a.) në shpellën Thevr. Një
njeri kaq i veçantë si Muhame-
di (a.s.), për t’mos rënë në duart
e mizorëve mekas që kërkonin
ta vrisnin, bën maksimumin që
mund të bënte një njeri, gjersa
s’kishte më nga të shkonte veç-
se të fshihej në një shpellë në
majë të një kodre. Profeti i qetë
me ndjenjën që të jep dorëzimi/
tevekkuli, i drejtohet Ebu Bek-
rit (r.a.) i cili ishte i tensionuar
se mos e vrisnin të Dërguarin
e Zotit, duke i thënë: **“Mos ki
frikë, Allahu është me ne!”**.
Muhamedi (a.s.) me këtë vep-
rim sikur iu drejtua Zotit duke
i thënë: **“Zoti im, sikur të kisha**

¹. Në literaturën islame kjo njihet me te-
min “tevekkul”


krahë të fluturoja edhe atë do e
bëja për t’u shmangur nga ar-
miqtë, por ja që me fuqinë time
prej njeriu vetëm kaq munda
të bëj, tashmë Ti e ke çdo gjë
në dorë...” Kjo është mënyra e
dorëzimit që duhet të marrim
shembull ne. Nga kjo kuptoj-
më se çdo njeri, për çfarëdolloj
qëllimi që i ka vendosur vetes,
fillimisht duhet të bëjë maxi-
mumin e mundur dhe pastaj të
dorëzohet plotësisht tek Ai që ta
shohë ndihmën e Tij qoftë edhe
në një “rrjetë merimange”, ash-
tu sikur u shpëtua Pejgamberi
(s.a.v.) nga ajo situatë..

DURIMI

**“Ne do t’ju sprovovmë me
ndonjë frikë, me uri, me ndo-
një humbje nga pasuria e nga
jeta e edhe nga frytet. Përgë-
zoji durimtarët!”** {Bekare, 155}
**“Pa dyshim që Allahu është
me ata që bëjnë durim!”** {Be-
kare, 153, 155}

Të bësh durim nuk do të thotë
të shtrëngosh dhëmbët ndaj pa-
drejtësive që bëhen nga të tjerët.
Të bësh sabër do të thotë të re-
zistosh që të mos kryesh ndonjë
vepër që të pendohesh prapa.
Pejgamberi (sav.) e përkufizon
durimin duke thënë së sabri
është të sillesh me gjakftohtësi
para një lëkundjeje që të shkak-
ton ndonjë ngjarje. (*Buhari, Xhe-
naiz, 32*).

Çdo njeri fillimisht duhet të bëjë maksimumin e mundur dhe pastaj të dorëzohet plotësisht tek Allahu që ta shohë ndihmën e Tij qoftë edhe në një "rrjetë merimange", ashtu sikur u shpëtua Pejgamberi (a.s.) nga ajo situatë.



Qëllimi i sabrit është të mos jesh i tensionuar para ngjarjeve të papritura dhe vështirësive dhe të mos bësh ndonjë vepër të papërshtatshme duke bërë panik.

BUJARIA DHE ALTRUIZMI

"Kurrë nuk do ta arrini mirësinë e plotë derisa të mos e jepni më të shtrenjtën e pasurisë suaj. Çfarë do që jepni Allahu atë e di" thotë Zoti i Madhëruar në versetin 92 të sures Ali Imran.

Dhe profeti Muhamed (a.s.) njerëzit i paralajmëron duke u thënë:

"Nuk beson askush nga ju derisa të mos dëshirojë për të tjerët atë që e dëshiron për veten e tij"

Një ditë, një djalë i vogël shkoi te Profeti dhe i paraqiti kërkesën e nënës për t'i dhënë një këmishë. Në atë çast Profeti s'kishte këmishë tjetër veç asaj që kishte në trup. Ai i tha djalit të vinte një herë tjetër. Djali shkoi por u kthye menjëherë me kërkesën e nënës për t'ia dhënë këmishën që kishte në trup. Profeti hyri në shtëpi, e nxori këmishën dhe ia dha djalit. Në atë kohë, Bilali (r.a.) po këndonte ezanin. Por Profeti nuk doli të falej sepse nuk kishte këmishë në trup.

Një pjesë e shokëve të Profetit u shqetësuan. Hynë në shtëpi të tij dhe e gjetën pa këmishë... (O. N Topbash, Frymëra mëshire nga Muhamedi, f. 109)

Ibn Abbasi (r.a.) e tregon kështu bujarinë e Profetit:

"I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ishte më bujari ndër njerëzit. Bujaria e tij shtohet edhe më shumë në ramazan. Gjatë gjithë jetës s'i pat thënë "jo" asgjë që ia pat shtrirë dorën!" (Buhari, Bedu'l-Vahj, 5-6; Nesai, Sijam, 2)

Profeti thotë kështu:

"Vetëm dy njerëz janë për t'u pasur zili; njëri është ai që shpenzon në rrugë të drejtë pasurinë që ia ka dhënë Zoti dhe tjetri është ai që vepron me atë dituri që i ka dhënë Zoti dhe që ia mëson të tjerëve." (Buhari, Birr, 15)

NDJENJA E FALËNDERIMIT

"Nëse falënderoni do t'ua shtoj të mirat" thotë Zoti tek sureja Ibrahim, verseti 7.

Profeti thotë që "Kush nuk posedon ndjenjën e të falënderuarit dhe të qenurit mirënjohës ndaj njerëzve, nuk di të falënderojë Zotin" (Ebu Davud, Edeb, 11; Tirmidhi, Birr, 35; Musned, 2/258, 295, 388, 3/32, 74) Një që

nuk falënderon për mungesat, as bollekun nuk e falënderon. (Musned, 4/278, 375) Kështu që, myslimanët shembullor në gojën e tyre kanë përherë shprehje falënderimi dhe mirënjohjeje ndaj Krijuesit të tyre dhe ndaj çdo personi që i meriton ato.

Profeti ynë në çdo vepër të tij ishte për ndjenjën e falënderimit, madje edhe ibadetin e bënte me këtë ndjenjë. Aisheja (r.anha) na e tregon këtë gjendje të tij në këtë mënyrë;

I Dërguari i Zotit falte namaz natën gjersa iu frynin këmbët. Kur i thashë që: -Përse bën kështu, o i Dërguari i Zotit, kur ty të janë falë gjynahet? Profeti më përgjigjet:

"-A mos të jem një rob që e falënderon Atë?" (Buhari, Tefsir, 48/2)

Nga kjo kuptojmë se namazi duhet të falet me ndjenjën e falënderimit.

Lutemi që Zoti i Madhëruar t'na bëjë prej atyre që nuk do falimentojnë në botën tjetër për arsye të sjelljes sonë me njerëzit! Lutemi që në të vërtetë të jemi prej atyre që Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) të krenohet me korrektësinë tonë në ibadete dhe me sjelljen tonë shembullore! Amin!

Kontribute të shqiptarëve në zbulimet e mëdha gjeografike

Inkuadrimi i viseve shqiptare në perandorinë osmane u dha shqiptarëve një shtysë të jashtëzakonshme për të shpalosur vetitë më të mira dhe vlerat më të larta, jo vetëm për interes personal por edhe në të mirë të qytetërimit të gjithmbarshëm njerëzor


Zbulimet e mëdha gjeografike të shekujve XV-XVII bënë të mundur vendosjen e kontakteve mes pjesëve deri atëherë të izoluar të qytetërimit njerëzor. Zbulimet gjeografike të europianëve dhe penetrimi i tyre në zonat që më përpara kishin qenë të njohura vetëm përmes legjendash, shkaktoi natyrisht edhe një farë reaksioni zinxhir në shtetet muslimane, veçanërisht të Perandorisë Osmane. Shumë autorë e shohin si një nga arsyt kryesore për pushtimin e Egjiptit nga Sulltan Selimi I, dëshirën për të ndaluar penetrimin e portugezëve në Oqeanin Indian. Ai ndërtoi një flotë të madhe e të fuqishme, por simbas disa autorëve, osmanëve u interesonte kryesisht Mesdheu dhe Europa, dhe vetëm vdekja e ndaloi të niste “pushtimin e Europës”, siç pohon historiani me origjin

në shqiptare, Lutfi Pasha.¹ Ky autor njëkohësisht kishte qenë kryeministër i perandorisë osmane në atë kohë dhe pohimi i tij merr akoma më shumë vërtetësi në këtë rast.

Inkuadrimi i viseve shqiptare në perandorinë osmane u dha shqiptarëve një shtysë të jashtëzakonshme për të shpalosur vetitë më të mira dhe vlerat më të larta, jo vetëm për interes personal por edhe në të mirë të qytetërimit të gjithmbarshëm njerëzor. Në këtë aspekt u bë realitet mundësia që shqiptarët të kontribuonin në zbulimet gjeografike, në shtimin e njohurive të njerëzimit rreth botës që i rrethonte, në afrimin e popujve dhe njohjen mes njëri-tjetrit të popullsive deri atëherë të panjohura mes vete dhe në krijimin e urave të komunikimit ndërnjerëzor.

Në mesin e një numri të madh

1. Lutfi Pasha pohon se vetë Sulltan Selimi I e kishte pohuar. *Das Asafname des Lutfi Pascha*, bot. R. Tschudi, Berlin 1910, f. 32.



shqiptarësh që nëpërmjet kontributit ndaj Perandorisë Osmane, kontribuan në historinë botërore ishte detari i famshëm i Mesdheut të shekullit XVI, Murati Reisi, i Madhi. Një trim dhe aventurier i pashoq të cilin historiani Philip Gosse e konsideron si një nga detarët më të njohur të të gjitha kohërave.² Figura e tij ka qenë një nga personazhet më të spikatura të letërsisë spanjolle të “shekullit të artë”.³ Mirëpo komentuesit e veprave letrare, kanë qenë në mëdyshje në se bëhet fjalë për një personazh real apo imagjinar.⁴

2. Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, nouvelle edition, Paris, Payot, 1952, f. 57. Krhs. Roger Coindreau, *Les corsaires de Sale*, Institut des Hautes Etudes Marocaines, Paris, 1948, f. 25.

3. Në literaturën spanjolle kapidan Murati i Madhi, del për herë të parë më 1599, në veprën e Lope De Vegas, *Festime në Denia* (*Fiestas de Denia*, kap. II, Valencia, 1599, f. 59-61). Po ky autor në veprën *La Dorotea* e shquan Murat Raisin në mesin e katër detarëve më të famshëm të kohës (Lope de Vega, *La Dracontea*, kap. I, edic. Sancha, vëll. III, f. 189).

4. *Obras completas de Cervantes*, Ed. Sch -

Në bazë të dëshmimeve të priftit benediktin Diego de Haedo, në veprën e tij *Topografía e Historia de Argel*, dhe që përbën burimin më të njohur dhe më të rëndësishëm për njohjen e Algjerit të fundit të shekullit XVI vërejmë se ai të cilin shkrimtari Castillo Solorzano e quante “korsari më i madh në mesin e muslimanëve”, është Murat Raisi i Madhi shqiptari. Haedo shkruan:

“Mbi numrin e korsarëve të galeotave dhe të barkave të tyre që kishte në Algjer në vitin 1581: ... 5. Murat Raisi, i Madhi, musliman shqiptar, dy galeota, prej 24 bankash... 7. Murat Raisi, Matrapillo, musliman spanjoll, një prej 22 bankash... 11. Murat Raisi, i Vogli, musliman grek, një prej 18 bankash.”¹ Haedo shkon duke rrëfyer bëmat e tij detare vit për vit deri më 1595 kur i jep fund edhe kronikës së tij.²

Figurën historike të këtij detari shqiptar që ka patur një vend aq të rëndësishëm në letërsinë spanjolle të shekullit të artë, kemi mundur ta qartësojmë dhe ndriçojmë edhe në bazë të dokumenteve dhe të dhënave të tjera, të cilat për nga vëllimi i tyre mund të themi se nuk janë të pakta. Nuk mund të jetë ndryshe përderisa edhe bashkëkohësit e tij evropianë e shquanin në mesin e një morie të tërë kapidanësh detarë që mbanin emrin Murat, me epitetin i Madhi.


Simbas të dhënave që jep

vill-Bonilla, *Comed. y Entrem.*, I, f. 241-242

1. Diego de Haedo, *Topographia e Historia General de Argel, repartida en cinco tratados, do se veran casos estraños, muertes espantosas, y tormentos exquisitos, que conuine se entienden en la Christianidad: con mucha doctrina y elegancia curiosa*, Valladolid, 1612, fl. 18r.

2. Haedo, thotë se ishte shqiptar, “de nación que nosotros llamamos albanes” lindur nga prindër të krishterë. Haedo, *po aty*, fl. 84v.

Pikërisht më 1585 Murat Raisi realizoi bëmën më të famshme të jetës së tij duke arritur të bëjë atë që asnjë detar tjetër musliman, qoftë maroken qoftë osman nuk e kishte bërë kurrë më parë: kalimin e ngushticës së Gjibraltarit dhe realizimin e inkursioneve në Oqeanin Atlantik



Haedo, Kapidan Murati ishte shqiptar i lindur nga prindër të krishterë. Në moshën 12 vjeçare bie në duart e detarit të shquar të Algjerit Kara Ali, i cili duke parë dhuntitë e tij e ushtron në artin e lundrimit. Që i ri shquhej për guximin dhe për karakterin e tij të fortë. Philip Gosse, thotë se Murati ishte i pari ndër kapidanët e pavarur osmanë, pra që e ushtronin detarinë më shumë për llogari të vet se sa të inkuadruar në flota ushtarake.³

Në rrethimin e Maltës më 1565, mbas dështimit të flotës osmane, u lodh nga disiplina dhe monotonia e shërbimit në flotë dhe u largua pa pyetur njeri për të lundruar për llogari të vet, me galeotën që i kish dhënë Kara Aliu. Duket se në këtë kohë akoma nuk i kishite mësuar të fshehtat e detit, mbasi anija e tij u përplas në shkëmbinjtë e bregdetit toscan dhe megjithëse pat shpëtuar për mrekulli me gjithë ekipazhin, kur u kthye në Algjer, në një anije algjeriane, që rastezisht kishte kaluar në afërsi të ishullit ku ndodheshin, iu

3. Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, nouvelle edition, Paris, Payot, 1952, f. 57. Krhs. Roger Coindreau, *Les corsaires de Sale*, Institut des Hautes Etudes Marocaines, Paris, 1948, f. 25.

desh të përballej me zemërimin e Kara Aliut, i cili ia mori robërit remëtarë dhe nuk i dha më anije tjetër. Por Murati, akoma i ri, i tërhequr nga jeta detare, bëri si bëri dhe mundi të gjejë një galerë prej 15 remash dhe u largua drejt brigjeve të Spanjës. Pa kaluar 7 ditë u kthye duke sjellë me vete tre bergantinë spanjolle dhe 140 robër. Ky inkursion i suksesshëm i dha reputacion të madh. Më pas vihet nën urdhrat e kalabrezit Uluxh Ali, detar i vjetër dhe i njohur në Algjer, ku kryen një aksion që përfundoi sërish me sukses me kapjen e tre galerave malteze në bregun e Sicilisë. Në janar të 1578 kishte mundur të ketë një flotilje të përbërë prej disa galeonësh në pronësi të tij personale dhe nis të veprojë tashmë si kapedan ose rais. Bëma më e rëndësishme e këtij viti ishte kur mori galerën *Santangel*, në të cilën udhëtonte për në Spanjë Duka i Terranovas, ish zëvendës-mbret dhe kapiten i përgjithshëm i Sicilisë.

Kjo nuk ishte asgjë në krahasim me atë të një viti më pas e cila’ siç thotë Ph. Gosse’ e bëri emrin e tij aq të famshëm sa atë të detarit anglez Francis Drake, që sapo ishte kthyer prej ekspeditës së tij pirateske përqark

globit.¹ Mbasi kishte dalë nga Algjeri në prill 1580 vetëm me dy galeonë, Murati lundronte qetësisht përballë brigjeve të Toskanës kur vëren dy galera të mëdha të cilat ishin pronë e Papës Gregorit XIII, madje njëra prej tyre me emër “la Capitania”, ishte anija admirale papnore. Megjithëse galerat papale ishin të pajisura e të armatosura shumë mirë, zgjuarsia dhe aftësia e Muratit triumfoi duke u bërë zot i të dy galerave. Edhe pse zyrtarët kryesorë papalë ia dolën të arratisen, Murati nuk doli pa gjë, mbasi i kishin lënë anijet mbushur me thesare dhe njerëz. Të prangosur në rrema kishte qindra robër muslimanë si edhe një numër të madh të burgosurish të krishterë, një pjesë e mirë e të cilëve, ishin zyrtarë kishtarë, fretën e murgesha që për arsye të ndryshme ishin burgosur nga papati.

Murat Shqiptari vazhdon te bëmat e tij, i mbrojtur dhe i mbështetur edhe nga miku i tij, detari dhe diplomati i madh shqiptari, Muhamet Arnauti. Pikërisht më 1585 Murat Raisi realizoi bëmën më të famshme të jetës së tij duke arritur të bëjë atë që asnjë detar tjetër musliman, qoftë maroken qoftë osman nuk e kishte bërë kurrë më parë: kalimin e ngushticës së Gjibraltarit dhe realizimin e inkursioneve në Oqeanin Atlantik. Deri atëherë detarët dhe korsarët më të shquar osmanë lundronin në afërsi të brigjeve përveç rasteve kur u duhej të kryqëzonin Mesdheun. Murati u nis nga Algjeri me 3 galeone lufte. Mbasi u ndal në portin e Salesë u përforcua edhe me disa bergantinë të vegjël. Skuadrilja

1. Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, po aty, f. 58. Krhs. Alonso Castillo Solórzano, *Tiempo de regocijo y Carnestolendas de Madrid*, Madrid, 1627, fl. 164v.

Në ekstremin tjetër,
në Oqeanin Indian
gjithashtu dëshmohet
kontributi i shqiptarëve
në njohjen më të mirë
të popujve e viseve të
Lindjes së Largët, pra
në pasurimin e dijes
njerëzore dhe unifikimin
e qytetërimit njerëzor

e Murat shqiptarit kaloi ngushticën e Gjibraltarit dhe lundroi duke përshkuar gjithë atë distancë që i duhej për të mbërritur në ishujt Kanarie. Një hapësirë kjo po aq e panjohur për osmanët sa ç’ ishte një shekull më përpara për europianët. Murati kishte marrë me vete një rob nga Kanariet që thoshte se e njihnte itinerarin, por kur mbas shumë ditësh lundrim të mundimshëm me rrema, piloti kanarien e humbi orientimin dhe i tha Muratit që kishte frikë se mos ishin shmangur nga drejtimi dhe se i kishin kaluar Kanariet, përgjigja e Muratit i habiti të gjithë: « edhe pse nuk kam qenë kurrë, e kam të sigurtë se ajo që thua është e pamundur. Prandaj, vazhdo në këtë drejtim». Murati kishte të drejtë. Pak kohë më vonë, shquan një nga ishujt e arqipelagut, atë të Lanzarotit. Mbasi zbarkuan rreth 250 ushtarë natën, morën rreth 300 robër, mes të cilëve edhe e ëma, e shoqja dhe e bija e guvernatorit të arkipelagut.

Është e paarsyeshme të insistojmë në ndonjë parandjenjë të tij lidhur me lokalizimin

e ishujve Kanarie. Nuk ka pse të përjashtohet mundësia që Murati të ketë pasur dijëni hartografike e gjeografike të sakta rreth brigjeve të Afrikës dhe Oqeanit Atlantik. Vepra e detarit osman Piri Reis, *Kitab-i Bahriye*, e shkruar më 1526 dhe që mbështetet në harta origjinale të Kolombit mbi konfiguracionin e Atlantikut dhe të territoreve të sapozbuluara të Amerikës është një dëshmi monumentale e informacionit gjeografik që dispononin osmanët.²

Të nesërmen, Murati shpallosi flamurin e armëpushimit dhe nisën tratativat e lirimit të robërve kundrejt shpërblimit. Familja e guvernatorit si edhe pjesa më e madhe e robërve u liruan. Edhe pse Murati nuk vonoi të ndërmarrë udhëtimin e kthimit, lajmi i sulmit kishte mbërritur në oborrin mbretëror spanjoll përpara se ai të mbërrinte në Gjibraltari. Në afërsi të ngushticës së Gjibraltarit e priste kryeadmirali i Spanjës, Don Martin de Padilla në krye të një skuadrilje përbërë prej 18 galeash nga më të mirat. Mirëpo ia doli të kalonte nëpër ngushticë në një natë me mjegull dhe madje kur kaloi shtiu disa herë me top, në shenjë sfide ndaj admiralit spanjoll.

Ekspedita e kapiten Murat Raisit ishte një ndër ndërmarrjet më të guximshme në historinë e detarisë, mbasi ky lundrim atlantik u krye me anije që ishin të destinuara për lundrimin në Mesdhe, por jo në Oqean. Dallimi thelbësor mes të dy zonave është se në Mesdhe përdoreshin anijet me rrema, ndërsa në oqean rremat ishin të pafuqishëm për të përballuar dallgët

2. Svat Soucek, “Piri Reis and Ottoman Discovery of the Great Discoveries”, në *Studia Islamica*, Paris, MCMXIV, f. 134.

dhe erërat e forta, prandaj përdoshin anije me vela. Do të jetë një hollandez disa vite më pas, Jan Sanz, i kthyer në Islam me emrin Murat, që do të fusë në përdorim në Algjer e Marok anijet rrumbullake me vela të përshtatshme për lundrimin oqeanik.

Murat Shqiptari e mbylli karrierën e tij si admiral i Algjerit, detyrë të cilën e mori më 1595. Çdo pranverë ia ngarkonte të gjitha detyrat zyrtare një zëvendësi dhe ai nisej për të lundruar. Zhduket nga kronika i plagosur në pesë vende të ndryshme, megjithatë ka mundësi se nuk vdiq prej këtyre plagëve, por prej pleqërisë.¹ Dimë se mbas Algjerit, qe dërguar nga Porta e Lartë në Tuniz, ku e hasim në dokumente deri në vitin 1604.

Në ekstremin tjetër, në Oqeanin Indian gjithashtu dëshmohet kontributi i shqiptarëve në njohjen më të mirë të popujve e viseve të Lindjes së Largët, pra në pasurimin e dijes njerëzore dhe unifikimin e qytetërimit njerëzor.

Në vitin 1536, sulltani i Guzeratit, Bahadir Shah dërgon një delegacion në Stamboll për të kërkuar ndihmë nga Halifi i botës islame kundër sulmeve të portugezëve. Mirëpo i biri i Bahadir Shahut, u mor vesh me portugezët dhe një vit më vonë vjen në fron me ndihmën e tyre. Në këto rrethana Sulltan Sulejmani I i ngarkon guvernatorit të Egjiptit Sulejman Pashës (Hadim) që të luftojë kundër portugezëve në ujrat e Oqeanit Indian me një flotë prej 80 anijesh dhe një ushtri prej 20 mijë ushtarësh, mes të cilëve 7 mijë

1. Philip Gosse, *Histoire de la Piraterie*, po aty, f. 59-60.

Vepra e
detarit osman Piri
Reis, *Kitab-i Bahriye*, e
shkruar më 1526 dhe
që mbështetej në harta
origjinale të Kolombit
mbi konfiguracionin
e Atlantikut dhe
të territoreve të
sapozbuluara të
Amerikës është një
dëshmi monumentale e
informacionit gjeografik
që dispononin osmanët

jeniçerë. Sulejman Pasha ishte shqiptar dhe më vonë ka qenë edhe vali i Hixhazit, pra i Mekës dhe Medinës.² Flota e udhëhequr prej tij zbarkoi në Kathi, në gadishullin e Guzeratit dhe pushton fortesat e Kukas dhe Kaçit. Synimi kryesor i tij ishte fortesa e Diut, por nuk ia doli dot. Atëherë Sulejman Pasha e heq rrethimin nga Diu, të cilin e mbronte një komandant portugez i quajtur Antonio da Silveira.³

Hajredin Mehmet Reisi, që ka themeluar koloninë turke në Tajlandë, ishte një detar ose kapidan që kishte marrë pjesë në fushatën e Indisë të drejtuar nga Sulejman Pasha, më 1538. Me urdhër të vetë Sulejman Pashës nisët për të eksploruar ujrat që gjendeshin më në lindje të Indisë.

Kapiteni Hajredin Mehmet është ndarë nga Sulejman Pa-

2. En Nehravali, *Alam bil alam bejtullahi el Haram*, (*Geschichte der Stadt Mekka*) bot. F. Eüstenfeld, Leipzig 1854, f. 399.

3. Cemalettin Taşkiran, "Les relations ottomano-portugaises au XVI^e siècle", në XXIV *Congresso Internacional de História Militar*, Lisboa 24 a 29 de Agosto de 1998, Lisboa 1999, f. 134.

sha në portin e Diut në Guzerat të Indisë. Duke ndjekur brigjet perëndimore të Indisë (brigjet e Malabarit) ka kaluar në detin Ohman. Ka zbritur nga Diu që ndodhet në 21 gradë gjerësi gjeografike deri në 12 gradë. Mbasi ka kaluar ngushticën e Palikut, që gjendet ndërmjet Indisë dhe Cejlonit, ka mbërritur në gjirin e Bengalit. Është ndaluar në portin e Tenaserimit në verilindje të gadishullit të Malajës, 12 gradë gjerësi gjeografike. Në këtë kohë Tenaserimi i përkiste mbretërisë së Siamit. Në pamundësi për të larguar flotën prej aty, mbasi këtë nuk ia lejonte mbreti, Hajredin Mehmeti u detyrua që t'i shërbejë mbretit të Siamit. Priifti portugez Fernao Mendes Pinto në një letër të datës 5 dhjetor 1554 shkruan se kapiteni turk merrte një rrogë prej 2 mijë monedhash ari nga mbreti i Siamit dhe që kryente veprime ushtarake në Laos me flotën e tij.⁴

Mbi arsyet që e shtynë shqiptarin Sulejman Pasha të urdhërojë këtë espeditë drejt vendeve më të largëta të Azisë nuk mund të hamendësojmë, por fakti është se ky shqiptar u bë ideatori dhe mbështetësi i udhëtimit më të largët të kryer deri atëherë nga flota osmane në lindje. Kjo ekspeditë e mbështetur prej tij, arrin të njohë dhe të eksplorojë zona të Lindjes së Largët, të cilat prej europianëve vetëm portugezët kishin arritur deri atëherë t'i eksploronin. Pra, shumë kohë më përpara se sa anglezët, spanjollët, holandezët apo francezët.

4. Cemalettin Taşkiran, "Les relations ottomano-portugaises au XVI^e siècle", po aty, f. 134-135.



PËRSE VETËVRITEN?

e koklavitur sa nuk mund të mbështetet vetëm në një shkak. Mirëpo përhapja e dobësimit të besimit po përhapet në popull si një sëmundje ngjithëse. Fakt është se degjenerimi i moralit dhe veset e pirjes së alkoolit dhe të narkotikëve i kanë prirë këtij fenomeni. Herë herë njëra është bërë shkak i tjetrës.

Populli ynë mjaftohet me besimin imitues dhe me njohuritë e mangëta islame të marra nga familja. Kështu, po përjetohet një zbrazëti fetare dhe një besim i dobët. Shkalla e parë e arritjes në diturinë e vërtetë është Kur'ani. Në përgjithësi familjet tona myslimane nuk i kushtojnë rëndësi mësimit të Kur'anit nga fëmijët. Njohuritë e tjera të fëmijëve duhet të ndërtohen mbi themelet e besimit. Njohuritë e së kaluarës përgatisin të tashmën tonë dhe njohuritë e së tashmës përgatisin të ardhmen tonë. Në Islam çdo gjë ka domethënien e saj; namazi, agjërimi, abdesti. Çdo lëvizje, çdo shenjë që bëhet gjatë faljes së namazit, ka kuptimin e saj. Namazi, nga kuptimi formal i tij, do të thotë qëndrim para Zotit të Madhëruar, afrim me Allahun e Lartmadhërishtëm. Namazi është miraxhi i besimtarit dhe kjo gjë realizohet në sexhde.

Abdesti, në kuptimin formal të tij, do të thotë afrim tek Allahu i Madhëruar. Ai që merr abdest, kur lan duart bën dua: "O Zot, bëje

të mundur që duart e mia të përdoren brenda qëllimit që Ti i ke krijuar." Kur lan këmbët lutet: "Bëje të mundur që këmbët e mia të qëndrojnë fuqishëm në rrugën Tënde!" T'i bësh mes' h kokës ka kuptimin që orientimet që jep Allahu, të bëhen kurorë për kokën. Kur adhuret bëhen thjeshtë formalisht, të rinjtë nuk afrohen. Zbrazëtia që posedojnë të rinjtë përplaset me ndjenjën sipërfaqësore që kanë një pjesë e mirë e praktikantëve myslimanë.

Feja Islame e ka ndaluar vrasjen e padrejtë të njeriut. Nëse ky akt i keq kryhet kundrejt vetes, ndëshkimit nuk i shmangesh dhe kjo gjë nuk mbetet vetëm në dorën e njeriut. Nuk duhet harruar se ç'ka në qiej e në tokë është pronë vetëm e Allahut. Zoti i Madhëruar thotë: "**Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhinët veçse për të më adhuruar Mua**" dhe "**Fillimi dhe fundi i kësaj jete** (dynjaja dhe ahireti) **është vetëm e Allahut**". Prandaj, qëllimi i ardhjes dhe largimit nga kjo botë është t'i bësh adhurim Allahut, të dalësh faqebardhë nga provimi i kësaj bote gjer në momentin e fundit të jetës. Jeta e kësaj bote është një lloj loje dhe një lloj testi për njeriun. Allahu i Madhëruar i shpërblen ata që i besojnë dhe që ia kanë frikën Atij. Në këtë kontekst, një dijetar e pat krahasuar njeriun me atë librin që i është shkëputur faqja e parë dhe e fundit, kopertina.

Kohët e fundit ka nisur një situatë e cila ka marrë përmasa alarmante. Një lloj mashtrimi i çmendur, një lloj rrokullisje drejt greminës së frikshme dhe të errët. Vetëvrasja, fatkeqësia që vjen me duart e vetë njeriut kundrejt vetes së tij. Ky fenomen kaq i përhapur tashmë na trondit të gjithëve, na e bën zemrën copë-copë. Vetëvrasja sikur do të thotë se ka disa probleme në jetë që nuk kanë zgjidhje tjetër veç një fundi të tillë kaq të frikshëm. Vërtetë, a mund të konsiderohet si e pazgjidhshme çështja e pumundësive ekonomike e cila parashtrohet si shkak i përfundimeve të tilla të moshave të rritura? A mund ta bëjë këtë gabim një person që është i vetëdijshëm për qëllimin e ardhjes dhe largimit të tij nga kjo botë?

Çështja e vetëvrasjes është aq

Vetëvrasjen të cilën feja jonë e ndalon kategorikisht, mund ta mbështesim në dy shkaqe kryesore:

1. Shqetësim psikologjik.
2. Dobësi besimi.

Detyra jonë është që t'i bashkojmë këto, të meditojmë këtë të vërtetë; ta gjejmë e ta njohim Allahun e Madhëruar. Si mund të dalim me sukses nga ky provim? Kjo gjë arrihet vetëm duke qëndruar fuqishëm në rrugën e vërtetë Islame, duke u zhveshur nga egoizmi dhe duke u pajisur me etikën kurane. Andaj, mos ta konsumojmë kohën kot, por të përpiqemi që të arrijmë në enigmën e shprehjes "Men arafe nefsehu, fakad arafe Rab-behu" ("Kush arrin të njohë veten e tij, atëherë do njohë Zotin e tij").

Vetëvrasjen të cilën feja jonë e ndalon kategorikisht, mund ta mbështesim në dy shkaqe kryesore: 1. Shqetësim psikologjik. 2. Dobësi besimi.

Nëse ngjarja e vetëvrasjes ndodh si pasojë e shqetësimit psikologjik, nga sëmundjet mendore, ajo është e njëjtë si një vdekje që vjen si pasojë e një sëmundjeje. Kur shqetësimet psikologjike paraqiten në moshë të vogël, zakonisht fatkeqsisht anashkalohen, nuk u jepet rëndësia e duhur. Mirëpo, familjet kanë përgjegjësi për të njohur fëmijën e tyre, veçoritë dhe karakterin e tij, anëtarë pozitivë dhe negativë të fëmijës së tyre. Fëmija mund të mos ketë talentin dhe veçoritë e ndonjë pjestari të mirarsimuar të familjes. Prindrit e fëmijës duhet të respektojnë personalitetin e fëmijës së tyre, duhet ta pranojnë e ta duan fëmijën e

tyre me të gjitha veçoritë ashtu siç është. Familja duhet të ketë kujdes ndaj ndryshimeve psikologjike të çastit që mund të shfaqin fëmijët në mënyra të ndryshme dhe në se është e nevojshme, duhet bërë ndërhyrje psikiatrike, sa do që kjo gjë mund të paragjykoet nga opinioni.

Specialistët thonë se shkaqet e vetëvrasjes janë këto:

Pesimizmi, gjendje dëshpërimi e thellë, rënie në sy, dënim për të dashurën/dashurin, një lloj ndjenje për të shoqëruar të vdekurin, ikje nga ndëshkimi, revoltë për ndryshimin e sjelljes së të tjerëve, një mënyrë për të shprehur dashurinë, humbje e diçkaje të rëndësishme (dashurinë, punën, etj.), mosrezistenca ndaj presionit të opinionit, etj..

Këto që përmendëm janë si një fitil bombe tek njerëzit me besim të dobët, tek ata që e kanë të dëmtuar mburojën e quajtur etikë dhe motivim për të jetuar, me të cilat feja i pajis besimtarët. Një besim i mirë dhe një mbështetje e plotë tek Zoti njeriun e ka nxjerr nga çdo situatë, sa do e vështirë të ketë qenë ajo. Zoti na drejtohet kështu për momentet e testimit që na bën Ai: **"O besimtarë! Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz! Padyshim që Allahu është me ata që durojnë."** Atyre që bëjnë durim kundrejt një fatkeqësie, atyre që kryejnë me

sukses provimin e kësaj bote, do t'u jepet një veshje kaftani. Durimi dhe nënshtrimi nuk lihen kurrë pa shpërblim.

Ngaqë është zbehur dashuria, respekti dhe edukata në lidhjet mes njerëzve, gjithnjë po vërejmë prishjen e sistemit shoqëror me në krye familjen. Mund të fajësojmë problemet ekonomike, televizionin apo kompjuterin i cili po vret komunikimin, bisedën në familje, si do qoftë, fakt është se tashmë familja është në krizë. E rëndësishme është se si familje e si komb ne duhet të vërejmë mirë veten, ta analizojmë atë, t'i kontrollojmë dhe t'i rikonstruojmë vlerat që kombin tonë e bëjnë më të fuqishëm. Përndryshe, kjo plogështi, kjo përgjumësi do ta drejtojë për në vetëvrasje të gjithë kombin, ashtu siç është. Secili, duhet të kryejë në mënyrën më të plotë dhe me përgjegjësi detyrat që ka në punën e tij dhe në familjen e tij. Edhe pak më tepër duhet dashuri, respekt dhe mirëkuptim. Duhet t'ua bëjmë të ditur fëmijëve tanë se sa të vlefshëm janë për ne dhe t'u përforcojmë pozicionin e tyre në familje duke u dhënë detyra të ndryshme sipas vendit dhe moshës. Përherë t'i bëjmë thirrje Zotit me dua për mbarësinë, lumturinë dhe të ardhmen e tyre. Nuk do mbeten pa shpërblim përpjekjet tona, as duatë pa përgjigje, shpresa dhe besimi ynë medoemos do ketë frytet e veta.



Hafiz Ibrahim Repishti

(1882-1943)

Me rastin e 125 vjetorit të lindjes dhe 65 vjetorit të vdekjes

Ibrahim Repishti është një personalitet i shquar i jetës qytetare, politike, shoqërore e fetare në Shkodër.

Nga një vështrim përgjithësues i jetës dhe i veprimtarisë së Hafiz Ibrahim Repishtit dallohen qartë dhe prerazi dy periudha:

Njëra është e ngjeshur me përpjekjet të shumta atdhetare, ushtarake, politike e shoqërore, gjatë së cilës Hafiz Ibrahim Repishti luan një rol tepër aktiv në luftë për mbrojtjen e atdheut kundër sulmeve sllave, në luftë për interesat kombëtare, në përpjekjet për themelimet e shtetit të ri shqiptar dhe të institucioneve të tij demokratike. Në këtë etapë të jetës ai është demokratë konsekuent, ku idetë e tij filozofike e fetare i shkrin në një me interesat kombëtare dhe demokratizimin e shoqërisë shqiptare.

Tjetra, periudha e dytë e veprimtarisë së tij mbas një vrulli djaloshar e burror për t'u tërhequr në një shteg jete më të shtruar, ndoshta më kuptimplotë, që lidhej drejtpërsëdrejti me idealin e përgatitjes e tij në udhën e edukimit të njerëzve me moralin e lartë islam, me fjalën e madhërueshme të Kur'anit famëlartë e të traditës profetike. E gjithë përgatitja e tij, dituria e tij, përvoja e tij e pasur tashmë drejtohet në këtë objektiv,

në përhapjen e besimit islam në banorët e lagjes së vet. E në këtë fushë veprimtarie gjeti prehjen e kënaqësinë e tij shpirtërore, aq sa u bë shembull i rrallë devotshmërie dhe edukate për të gjithë.

Hafiz Ibrahim Repishti ka lindur në Shkodër në vitin 1882.

Familja e tij merrej me tregti dhe gëzonte një nderim të veçantë mes gjithë atyre familjeve të asaj lagjeje të nderuar. Kur çetat vullnetare niseshin për luftë për mbrojtjen e Plavës, Gucisë, Hotit e Grudës, Haxhi Jusuf Repishti, babai i Hafiz Ibrahimit, do të luante një rol me rëndësi në këtë periudhë heroike të lëvizjes popullore.

Ai do të nënshkruante memorandumin e 13 qershorit 1878, dërguar Kongresit të Berlinit për mbrojtjen e tokave shqiptare e jo vetëm kaq, por Haxhi Jusuf Repishti ishte

Hafiz Ibrahim Repishti trashëgoi bibliotekën nga i ati, duke e bërë një nga më të mirat në qytet. Aty ka pasur libra të rrallë, me shumë vlerë. Qindra e qindra libra teologjike e të diturive të tjera radhiteshin hijshëm. Aty vinin të gjitha botimet që dilnin në gjuhën shqipe

zgjedhur Kryetar i Komisionit për financimin e forcave të Lidhjes për Shkodrën.

Duke ndjekur traditën e familjes, të babait të vet, Ibrahim Repishti që në fëmijëri merr një edukatë të shëndoshtë fetare, ndjek mejtepin e njohur të lagjes dhe pastaj vazhdon studimet në Medresenë e Pazarit.

Në vitin 1907 me shpenzimet e veta shkon në Stamboll për të ndjekur studimet e larta teologjike, duke u kualifikuar për të drejtën kanonike islame, shkencën e Sheriatit. U kthye në Shkodër në verën e vitit 1912.

Hafiz Ibrahim Repishti fillon të marrë pjesë gjallërisht në jetën politike të Shkodrës. Janë kohë të vështira për Atdheun dhe ai, duke ndjekur traditën e të parëve, është i lidhur me problemet që shqetësojnë vendin dhe çështjet e Atdheut i vë në një peshë me ato të fesë.

Gjatë Luftës Ballkanike Shkodra bëhet përsëri pre e sulmeve të shteteve fqinje, edhe në Luftën e Parë Botërore bëhet qendër e Komandës së Lartë të trupave pushtuese austriake.

Pushtuesi austriak filloi të marrë masa ekonomike shtrënguese ndaj popullsisë vendase e në raste të veçanta edhe përndjekje politike e ndëshkime të rrepta ndaj kundërshtarëve të vet. Mes shumë masave, më tepër bëri përshtypje rekrutimi ushtarak e stërvitja e djemve

Me mbarimin e luftës Hafiz Ibrahim Repishti angazhohet në veprimtarinë arsimore. Drejtoria e Arsimit të Shkodrës me shkresën nr. 570/II e njofton Përlimtaren e qytetit të Shkodrës me datën 26 shtator 1919 se Këshilli Arsimor me shkresën e datës 18 shtator ka vendosur për kryetar të tij Hafiz Ibrahim Repishtin. Shkresa është firmosur nga Drejtori i Arsimit të Shkodrës, Gaspër Beltoja

shqiptarë për t'i dërguar në luftë për mbrojtjen e kufijve të shtetit austro-hungarez.

Popullsia myslimane e Shkodrës nuk pranoi t'i bindej atij urdhri që të derdhesh gjaku i bijve të vet për në frontin e Austrisë. Paria myslimane e qytetit duke mos përfillë urdhrat ushtarake që në kohë lufte ndalojnë çdo mbledhje me karakter politik, pa leje me datën 15 prill 1916 mbledhet në Xhaminë Plakë për të formuluar një peticion, që të ndalonte masat arbitrare.

Me mbarimin e luftës Hafiz Ibrahim Repishti angazhohet në veprimtarinë arsimore. Drejtoria e Arsimit të Shkodrës me shkresën nr. 570/II e njofton Përlimtaren e qytetit të Shkodrës me datën 26 shtator 1919 se Këshilli Arsimor me shkresën e datës 18 shtator ka vendosur për kryetar të tij Hafiz Ibrahim Repishtin. Shkresa është firmosur nga Drejtori i Arsimit të Shkodrës, Gaspër Beltoja.

Si Kryetar i këshillit arsimor ai do të luaj një rol me rëndësi për arsimimin e bijve të qytetit tonë, sidomos në lagjet e banuara me popullsi të besimit mysliman. Një rëndësi e veçantë i kushton edhe mësimin të besimit në shkollat e shtetit. Në arkivin e Muzeut Historik të Shkodrës ka një dokumentacion të pasur lidhur me këtë problem. Sidoqoftë duhet theksuar se ndërtesa e re e mejtepit, sot kopshti i Dudasit, është vepër e ngritur me kujdesin direkt të Hafiz Ibrahim Repishtit.

Me mbarimin e Luftës së Parë

Botërore dhe krijimin e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës ai përkrahë dhe solidarizohet me kërkesat e udhëheqësve kosovarë. Disa nga mbledhjet e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës janë mbajtur në shtëpinë e tij.

Hafiz Ibrahim Repishti trashëgoi bibliotekën nga i ati, duke e bërë një nga më të mirat në qytet. Aty ka pasur libra të rrallë, me shumë vlerë. Qindra e qindra libra teologjikë e të diturive të tjera radhiteshin hijshëm. Aty vinin të gjitha botimet që dilnin në gjuhën shqipe.

Në luftën politike të viteve 1920-1924 Hafiz Ibrahim Repishti zë një vend nderi. Ai u radhit me vendosmëri në opozitën demokratike, duke qenë një nga figurat kryesore të luftës politike kohës e një nga përkrahësit e flaktë të mendimit e të veprimit demokratik më të përparuar. Në votimet e dhjetorit 1923 Hafiz Ibrahim Repishti zgjidhet përfaqësues i qytetit të Shkodrës.

Gjatë qëndrimit të tij në Parlament ka kryer funksionet e Nënkrjetarit të Komisionit Parlamentar për jurisprudencën dhe të Komisionit Parlamentar për arsimin.

Me ardhjen e Zogut, 24 dhjetor 1924, e tërë familja e Hafiz Ibrahimit u detyrua të largohej nga qyteti, për t'iu shmangur përndjekjeve. Vetë Hafizi u detyrua të hidhej në ilegalitet për 9 muaj dhe në vend të tij u arrestua i vëllai, Jonuz Repishti, që kishte dhënë kontribut të madh në jetën politike në Shkodër, si në Luftën e Koplikut, ashtu edhe

në organizimin e mbarëvajtjes së Bashkisë së Shkodrës, anëtar i së cilës kishte qenë për shumë kohë. Mbas amnistisë së përgjithshme u kthye pranë familjes dhe u largua definitivisht nga jeta politike. Megjithatë, gjatë vitit 1928 ai u internua në qytetin e Kavajës si armik i regjimit monarkist, ku qëndroi për 8 muaj.

Prej vitit 1925 deri në vitin 1943 ka shërbyer si imam i xhamisë së Dudasit. Gjatë kësaj periudhe u shqua si një teolog dhe hoxhë i nderuar prej të gjithëve. Tashmë ai i përkushtohet një fushe tjetër, asaj të fesë islame, edukimit të banorëve të lagjes me besimin në Zotin e madhërueshëm, me moralin e lartë islam. Në shtëpinë e vet studion e thellon kulturën fetare e shkencore në sajë të bibliotekës së ngritur me aq kujdes që vitet e studimeve universitare. Fliste mirë turqishten dhe arabishten dhe lexonte mirë persishten dhe frëngjishten. Që në kohën e studimeve në Stamboll i ishte vënë studimit të shqipes nga kolegët shqiptarë të kryeqytetit turk.

Hafiz Ibrahim Repishti më në fund ra viktimë e terrorit fashist italian. Mbas kësaj goditjeje Hafiz Ibrahim Repishti vdiq mbas dy javësh, me 29 shtator 1943.

Varrimi i tij qe një funeral madhështor, qindra hoxhallarë miq e shokë të tij i falën xhenazen. Në varrezat e lagjes "Dudas" pushonte trupi i tij. Këta varre u shkatërruan plotësisht gjatë regjimit komunist. E me këtë rast humbën varret e sa burrave të nderuar të Shkodrës.

Mënyra e thirrjes, shpjegimit të islamit dhe cilësitë e thirrësit

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit”



metodën që kishte Pejgamberi (a.s.) gjatë predikimit të Islamit. Allahu i Madhëruar e kishte urdhëruar atë që të jetë sa më i butë, tolerant, dhe dashamirës në thirrje. Në këtë kontekst, e urdhëron Pejgamberin (a.s.) por edhe të gjithë myslimanët në përgjithësi:

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit”¹

Pasi që ky ajet i përfshin të gjithë myslimanët, e në veçanti thirrësit islamë apo bashkësitë myslimane, duhet që gjithmonë të kemi si shebull Pegamberin (a.s.) Për t'i realizuar planet dhe për ta plotësuar mesazhin e Allahut (xh.sh.), Muhammedi (a.s.) ka ndjekur dhe përcjell këto hapa të cilat do të shërbejnë edhe për ne:

a) Përgatitja e shumanshme e tij për thirrje;

b) Formimi dhe organizimi i kuadrove më të mira që i nevojiteshin;

c) Shumimi i numrit të myslimanëve që të kenë një qendër të veçantë;

1. Nahl, 16/125

Komunikimi me shtresa të ndryshme njerëzore, kërkon një angazhim të mirëfilltë dhe intensiv. Andaj, thirrësi duhet të jetë i përgatitur shumë mirë për atë që thërret, të ketë njohuri të gjera fetare e kulturore dhe të ketë parasysh vendin, kohën dhe shtresën që i drejtohet. Njohja e opinionit dhe mentalitetit të tyre, lehtëson punën e thirrësit, po ashtu edhe i nxit ata që të jenë më të gatshëm për pranimin e asaj që predikon ky thirrës.

Pasi që Kur'ani Fisnik është një libër hyjnorë, i zbritur nga All-

llahu (xh.sh.), ai, u drejtohet të gjithë popujve, pa bërë kurrfarë dallimi etnik apo nacional. Vlen për të gjitha shtresat, si për të pasurin ashtu edhe për të varfrin, si për të bardhët ashtu edhe për të zitë, qofshin qytetarë apo fshatarë. Për këtë shkak, përmbajtja apo ajetet e Kur'anit, kanë një stil dhe mënyrë të ëmbël por edhe të mrekullueshme, që me anë të saj, ai që ftohet në këtë fe hyjnore, qysh nga hapat e para të ketë mundësi ta shijojë këtë mrekulli si në aspektin stilistikor që përmban Kur'ani ashtu edhe në aspektin e pranimit të këshillave që ofron ai. Për këtë shkak, predikuesi fetar duhet ta ketë parasysh

**Së pari nevojitet që
Islamin ta ngulitni
në gjokset dhe
zemrat tuaja në
mënyrë që shteti
Islam të jetë prezent
edhe në vendet tuaja**

d) Më në fund përpilimi i administratës shtetërore dhe shpallja e shtetit Islam.

Për t'i realizuar këto, Muhamedi (a.s.) është dashur të ketë një durim dhe përqendrim tejet të madh sepse këto pika dhe tjera nuk janë realizuar për një apo dy vite. Plot njëzet e tri apo njëzet e pesë vite i janë dashur Muhamedit (a.s.) dhe shokëve të tij që të ia arrijnë qëllimit, që ne sot ta kemi Islamin sa më të gatshëm dhe më të saktë. Të gjitha këto në vete ndahen në pika të tjera që nga dita kur filloi thirrja Islame. Ndërsa këtyrë u duhet kushtuar një rëndësi e veçantë nga të gjitha shtresat njerëzore të cilët deklarojnë se janë myslimanë.

a-a) Në këtë grup vlen të ceken fjalët e thirrësit bashkëkohor mysliman Hasan el-Hudejbiut, ku ndër të tjera thotë: "*Së pari nevojitet që Islamin ta ngulitni në gjokset dhe zemrat tuaja në mënyrë që shteti Islam të jetë prezent edhe në vendet tuaja*".¹ Me një thënie tjetër, thirrësi duhet të jetë i përgatitur shpirtërisht, duke qenë i edukuar personalisht, të jetë i përpiktë në punët e sidomos në adhurimet farze bashkërisht me xhemat. Pas kësaj të ketë njohuri të literaturës burimore, të njohë shkencën dhe metodologjinë e hadithit, tefsirit etj. njohja e metodologjisë dhe renditjes së ajeteve dhe haditheve luajnë një rol të

madh në suksesin e thirrësit. Edhe përgatitja trupore dhe materiale ka një rëndësi të madhe sepse edhe Pejgamberi (a.s.) ka theksuar se myslimani i fortë është më i vlefshëm tek Allahu se ai i dobëti.

b-b) Për të pasë sukses në punë patjetër se nevojiten mbështetësit dhe kuadrot e forta në mënyrë që të arrihet në qëllimet dhe çlirimet e zemrave të injorantëve. Nevojitet mbështetja familjare dhe e të afërmeve të tjerë në mënyrë që më lehtë të kalohet tek klasa më e largët; vendasit, atdhetarët, shtetet fqinje dhe në këtë mënyrë të gjithë të arrijnë lumturinë dhe shijojnë Islamin. Ndihma e Hatixhes kur i kishte thënë Pejgamberit (a.s.) se nëse askush nuk do të besojë, unë do të përkrah, ishte një ndihmë ndër më të mëdhatë që pat Pejgamberi qysh nga dita e parë. Më pas pasuan shokët e ndërshëm të tij që më së shumti u besonte dhe u bënë një kështjellë e pathyer.

c-c) Pasi që thirrja filloi nga të afërmit, përmes këtyre mesazhi Islam u shpërnda nëpër të gjithë gadishullin arab. Pejgamberi (a.s.) përmes ambasadorëve filloi t'u dërgonte shkresa² mbretërve dhe me këtë pas një kohe u rrit numri i myslimanëve, më pas dërgoi edhe mësues etj. Sot ne i kemi në dispozicion radiot, gazetatat, faqet e internetit dhe kanalet e ndryshme televizive përmes të cilave mund të përcjellim rrugën e Pejgamberit në përhapjen e Islamit.

d-d) Kryerja e të gjitha planeve me sukses ka bërë që më në fund Muhamedi (a.s.) të formojë administratën shtetërore dhe të shpallë shtetin Islam. Kur e panë fiset arabe dhe të vendeve të huaja drejtësinë e Pejgamberit (a.s.), filluan që t'i bashkëngjiten në formimin e një shteti, ku të gjithë do të ishin të njëjtë. I gjithë thelbi i synimit është që të dihet zyrtarisht vendi dhe udhëheqësi i myslimanëve. Sepse shteti është shumë i lidhur ngush-

të me vendin dhe hapësirën e tij sa që nuk pranohet një shtet nëse nuk ka vend dhe hapësirën e tij.³ Në anën tjetër mori fund hixhreti i myslimanëve dhe shqetësimet e tyre. Tani më ata kishin një qendër ku drejtoheshin edhe pse më parë kanë pasur qendrën e quajtur Bejtu'l-Erkam e cila kishte luajtur një rol të madh në organizimin dhe tubimin e myslimanëve.

Xhaminë të cilin e kishin ndërtuar në Medinë, kryente rol të madh, duke filluar me faljen e namazit, tubimet për çështjet shtetërore, organizimet, mësimi i besimit, aktivitetet e ndryshme, dërgimi i ambasadorëve etj. Thënë shkurt në atë kohë xhamia nuk ka shërbyer vetëm si vend për faljen e namazeve përderisa sot shërben vetëm për ibadet. Ndër pikat tjera shumë të rëndësishme që i realizoi Pejgamberi (a.s.) për krijimin e shtetit mund të themi se ai menjëherë filloi të bënte numërimin e popullatës, caktimin e kufijve, nënshkrimin e marrëveshjeve me të huajt etj.

Të gjitha këto u bënë me një përpikëri dhe besnikëri të lartë nga të gjithë ata myslimanë që morën pjesë. Nga kjo konkludojmë se, për të qenë i suksesshëm një thirrës Islam, në mesin e disa kushteve që duhet t'i ketë parasysh veçojmë:⁴ që të jetë i durueshëm me njerëzit dhe parinë njerëzore, të ketë vullnet në punë, të ketë shpresë se puna e tij do të ndikojë në opinion, të ketë sjellje të buta, të jetë i sinqertë në atë që fletë, sa të ketë mundësi të bashkohet me popullin që nga afër të kuptojë gjendjen e tyre, të vlerësoj mendimet e të tjerëve, të mos bëhet pesimist në rastet kur nuk mund të arrije atë që dëshirojnë etj. Në këtë mënyrë do të kishte sukses të madh çdokush që të merrte për barrë këtë detyrë të shenjtë hyjnore.

3. Muhammed Hamidullah, "İslâm'da Devlet İdâresi" f. 61-90, İstanbul 1998.

4. Lidhur me kushteve dhe cilësive që duhet t'i ketë thirrësi preferohet libri në gjuhën shqipe nga Dr. Jusuf el-Kardavi, "Edukimi Kulturorë i Thirrësit", Përktheu, Agim Abazi, Prishtinë 2002.

1. Prof. Dr. Ramadan el-Bûtî, Fikhu's-Sire, f. 268, Bejrut, 1978.

2. Më gjerësisht shih: Muhammed H - midullah, "Hazreti Peygamberin Altı Orijinal Diplomatik Mektubu ve Arap Yzsızının Temeline Giriş", İstanbul 1990.

Disa prej xhamive të Malit të Zi që dokumentohen në dosjet e arkivit shtetëror të Stambollit

Po ti hedhim një vështrim katalogëve të arkivit shtetëror të Stambollit do të vërejmë lloje nga më të ndryshme regjistrash dhe dosjesh, duke filluar nga ato të pronave, vakfëve, zyrtarëve të lartë të shtetit etj. e deri tek dosjet e ndryshme të xhamive gjatë periudhës otomane. Por kësaj rradhe ne do të ndalemi vetëm në disa prej xhamive të Malit të Zi që ruhen në dosjet e arkivit shtetëror të Stambollit.

Deri më tani punimet e bëra në lidhje me xhamitë e Malit të Zi janë për tu numëruar me

gishtat, si brenda shtetit ashtu edhe jashtë tij, dhe në asnjërin prej tyre nuk janë përdorur dokumente në osmanisht nga arkivi shtetëror i Stambollit. Për këtë shkak e pamë të arsyeshme shkrimin e një artikulli të tillë.

Duke shfletuar dosjet në këtë arkiv, vërejmë se një pjesë e mirë e këtyre xhamive nuk kanë arritur ta ruajnë egzistencën e vet deri në ditët e sotme. Disa prej tyre janë prishur vetvetiu si shkak i mospranisë së myslimanëve në ato troje, kurse disa të tjera me pretekstin se nuk janë në vendin e duhur ose ngritjen e ndërtesave dhe parqeve të ndryshme në vend të



tyre. Në dosjet e mëposhtme nganjëherë flitet për rikonstruksionet, emërtimet e nëpunësve të rinj, apo ndërtimin e tyre nga fillimi etj. dhe për këtë data e ndërtimit të ndonjëres prej këtyre xhamive mund të jetë më e hershme se vet dokumentet në fjalë. Edhe pse ndonjëra prej dokumenteve bën fjalë në mënyrë indirekte për këto xhami, përsëri ato kanë rëndësi të veçantë sepse tregojnë të paktën për ekzistencën e këtyre xhamive më parë.

Xhamia e Ibrahim Pashës në kazanë e Ulqinit (Ülgün): Dokumenti që bën fjalë për këtë xhami është i përkthyer nga departamenti i përkthimit pranë Portës së Lartë në vitin 1890. Kjo xhami është ndërtuar nga Pashai i Shkodrës Ibrahim nga i cili merr edhe emrin. Me këtë rast ai i dhuroi xhamisë të ardhurat e katër magazinave që gjendeshin në pazarin e Shkodrës më qëllim shpenzimin e nevojave. Por nga ky moment nëpunësit e vakëfit ia vononin të ardhurat që vinin nga këto magazina xhamisë së Ibrahim Pashës. Për këtë imamit të xhamisë i është dashur disa herë të shkonte në Shkodër për zgjidhjen e këtij problemi. Gjithashtu është bërë kërkesë edhe me shkrim autoriteteve të asaj kohe për vazhdimin si më parë. Dokumenti edhe pse bën fjalë për magazinat që ishin vënë në dispozicion të xhamisë, përsëri ka rëndësi të madhe sepse na tregon për ekzistencën më parë të xhamisë së Ibrahim Pashës në Ulqin.

Xhamia e Sultan Selimit në kalanë e Ulqinit (Ülgün): Dokumenti i parë që bën fjalë për këtë xhami është ai i vitit 1104/1692. Më pas vijnë ato të viteve 1106/1695, 1109/1697, 1110/1698, 1118/1706 etj. Pothuajse në të gjitha këto dokumente bëhet fjalë për emërimin e imamëve, predikuesve, muezinëve, pastruesve të xhamisë etj. Gjithashtu në këto dokumenta bëhet fjalë edhe për emërimin e mësuesve të rinj në shkollën fillore pranë kësaj xhamie. Një dokument i vitit 1189/1775 bën fjalë për ardhjen e rrogave të nëpunësve të xhamisë, ku predikuesi i kësaj xhamie kishte vdekur dhe për këtë është kërkuar që rroga e tij t'i jepej një personi të quajtur Mehmet.



Xhamia e Ali Pashë Gucisë (Gosine): Dokumenti që bën fjalë për këtë xhami i përket vitit 1316/1901. Në këtë dosje gjendet një telegram i dërguar nga vali i Kosovës Hafiz Mehmeti. Ndersa tjetri është shkruar pranë Divan-i Humajunit nga sadrazami. Dokumenti bën fjalë për rënien e një zjarri gabimisht natën e premte në kasabanë e Gucisë. Si pasojë e këtij zjarri janë djegur dyqind e tetë dyqane, tre hane, njëmbëdhjetë kafene, gjashtë shtëpi, xhamia e Ali Pashës dhe një xhami tjetër se bashku me telegrafhanen. Në këtë dokument kërkohet që të bëhet kompensimi nga shteti si shkak i dëmeve të shkaktuara nga zjarri. Nga ky dokument vertetohet se ekzistojnë dy xhami; xhamia e Ali Pashës dhe një tjetër që dokumenti nuk e emërton.

Xhamia Fethije në Bijelo Pole (Akova): Ky dokument i përket vitit 1316/1901 dhe është i shkurtër. Në këtë dokument nuk flitet për xhaminë, vetëm bëhet fjalë për emërimin e një habitibi, predikuesi të ri në këtë xhami, me urdhër të udhëheqsit drejtuar organeve kompetente që caktonin nëpunësit e xhamive.



Xhami në Plevlë (Taşlıca): Kjo dosje që bën fjalë për këtë xhami i përket vitit 1290/1874 dhe ka vetëm një faqe. Këtu bëhet fjalë për riparimin e xhamisë, mektebit/shkollës dhe ujësjellësit në Plevlë që në atë kohë administrohej nga sanxhaku i Novi Pazarit/Yeni Pazar. Shpenzimet për riparimin e këtyre janë paraqitur para vakf-i humajunit dhe është menduar që të jenë rreth shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë grosh.

Një xhami në Gollobovcë (Golobovçe): Kjo dosje i përket vitit 1290/1873 dhe numron tetë faqe. Në këtë dokument tregohet për vënien e zjarrit nga ana e disa personave të panjohur një xhamie të lagjes Beraz të Gollobovcit që i përkiste kazasë së Podgorices. Si shkak i kësaj të nesermen mbrëma po nga disa persona të panjohur ishte vënë zjarr kishës së asaj lagje. Në këto dokumente thuhet se janë vënë në dyshim gjashtë personë të besimit islam dhe tetë të atij krishterë dhe për këtë është vendosur që të dërgohen në Shkodër për tu marrë në pyetje. Nuk kemi për qëllim të zgjatemi në shpjegimin e kësaj ndodhie, por ajo çka na

intereson neve tani dëshmon për ndodhjen e një xhamie në Beraz të Gollobovcit, por dokumentet në fjalë nuk e emërojnë me ndonjë emër.

Dy xhami në kazanë e Tuzit (Tuz)

Dokumenti i parë që bën fjalë për njërin nga xhamitë i përket vitit 1309/1891 dhe ka një faqe të shkruar me llojin e shkrimit rika. Në këtë dosje bëhet fjalë për urdhërin e dërguar për ndërtimin e një xhamie dhe pazarin, por në qendër të kajmakamit nuk kishte më tepër se pesëdhjetë shtëpi. Si shkak i kësaj është kërkuar që kjo xhami të mos ndërtohej perkohësisht, por në vend të saj të rikonstruktohet një xhami tjetër për ushtarët dhe popullsinë myslimane të Tuzit me rrethinë. Sipas kësaj sipërfaqja e xhamisë duhej të zgjerohej dhe t'i ndërtohej një minare prej druri.

Kurse dokumenti tjetër i përket një viti më vonë gjithsej ka tre faqe dhe bën fjalë për rindërtimin e disa mektebeve në kazatë e Shkodrës, Lezhës, Tuzit si dhe disa fshatra të Malësisë dhe Mirditës. Shpenzimet për rikonstruktimin e këtyre shkollave ishin menduar të qenë njëzet e shtatë mijë e nëntëqind grosh. Kurse rroga mujore e mësuesve ishte njëqind e njëzet e pesë grosh. Në këtë dosje tregohet edhe për rëndësinë dhe ndërtimin e mënjëhershëm të dhjetë xhamive në vendet që kemi përmendur më sipër, njëra prej të cilave edhe në kazanë e Tuzit.

Xhamia e Sulltan Fatih Mehmedit në kalanë e Podgoricës (Podgoriçe): Dokumentët që flasin për këtë xhami u përkasin viteve 1131/1718, 1173/1759. Gjithashtu ekziston edhe një regjistër ku jepen emrat e punonjësve dhe pensionistëve të vakëfit të Sulltan Mehmedit në Podgoricë dhe disa vendeve të tjera. Dokumenti i vitit 1759 bën fjalë për mosdhënien e hakut të punës puntorve që kishin riparuar vakfin e kësaj xhamie dhe urën e Sulltan Muradit.

Xhamia në lagjen Garud të Kasabasë së Nikshiqit (Nikšik): Kjo dosje i përket vitit 1280/1863 h. dhe ka vetëm një faqe. Në të thu-

het se xhamia ka mbetur e shkretë që para dy-mbëdhjetë vjetësh dhe si shkak i kësaj personat si Bekir Jusufi, Mujo Ali Aga etj. që shfrytëzonin të ardhurat e dyqaneve të vakëfit të xhamisë ishin detyruar të jepnin të holla për rikonstruksionin e kësaj xhamie.

Ndërtimi i një xhamie në Mojkovac (Mojkovac): Ky dokument i përket vitit 1326/1908 dhe në të bëhet fjalë për ndërtimin e një xhamie dhe medreseje në nahijen e Mojkovacit. Arsyeja ishte se në atë vend nuk kishte as shkollë, as xhami, kur dihej se 9/10-ta e popullsisë së vendit i përkiste besimit islam, ndërsa malazezët që jetonin në anën tjetër të lumit Tara posedonin një kishë dhe shkollë të madhe që ishte ndërtuar para disa viteve. Gjithashtu thuhet se për ndërtimin e saj janë të mjaftueshëm njëzetëmijë kurush. Kërkesa për ndërtimin e kësaj xhamie i është dërguar ministrisë së punëve të brendshme si nga autoritetet e Mojkovacit, ashtu edhe nga valiu i Kosovës.

Xhamia e Sulltan Mehmetit në Kalanë e Kollashinit (Kolaşin): Ky fond i përket vitit 1119/1707 dhe ka një faqe. Në të bëhet fjalë për kërkesën që bëjnë shërbëtorët e kësaj xhamie për rinovimin e vërtetimit të punës me rastin e ardhjes në pushtet të sulltanit.


Sipas një dokumenti tjetër të dërguar minis-

trisë së punëve të jashtme nga Cetina thuhet se shërbëtorët e xhamive të **Nikshiqit (Nikşik)**, **Shpuzit (İşpuzi)** dhe **Kolashinit (Kolaşin)** nuk posedonin asnjë vërtetim pune nga ana e shtetit. Ky dokument i përket vitit 1887, është i përkthyer nga zyra e përkthimit dhe numëron dy faqe.

Në këtë arkiv gjenden edhe dosje të tjera që bëjnë fjalë për ekzistencën e disa xhamive në kalanë e **Tivarit (Bar)** si ajo e **Sulltan Selimit** (1102/1690; 1187/1764); **Sulltan Muradit** (1122/1710: 1211/1796), në Ulqin (**Ülgün**) xhamia e **Fatih Mehmetit** (1173/1759) Plevles (**Taşlica**) si ajo e **Gazi Hysejnit** (1320/1904); **Berane** (1319/1901) ku tregohet për imamin e kësaj kasabaje Jusuf Efendiu, si dhe vendet e tjera që sot i përkasin Republikës së Malit të Zi.

Marrë nga arkivi shtetëror i Stambollit:

Fondi: İ.MF.. Gömlek: 1 Dosya; 1310/M-3; **Fondi:** HR.TO 49/5; **Fondi:** İ.HUS: 66/1316/Ra/093; **Fondi:** İ.TAL. 255/1319-Ca-O35; **Fondi:** İ.DH.. 1265/99437; **Fondi:** TR.TO. 47/53; **Fondi:** İ.DH.. 710/49673; **Fondi:** C.EV.. 590/29780; **Fondi:** C.EV.. 94/4667; **Fondi:** Y.A.HUS. 388/29; **Fondi:** Y.MTV 312/136; **Fondi:** A.MKT.MHM. 461/23; **Fondi:** C.EV.. 272/13876; **Fondi:** TŞR.BNM. 7/90; **Fondi:** C.EV.. 137/11802



GËZIMI QË TË FAL DËSHMIA E DITËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS



Mbas diskutimeve të tejzgjatura me serbët, popullin që firmosi dhe qe protagonist i paturpshëm në shek. e XX-të krimet më makabre ndaj popujve të Ballkanit dhe një periudhe të gjatë vetëpërmbytjeje me dëshirën e mirë që të mund të gjejë mirëkuptim në planin ndërkombëtarë të shumë shteteve, për ironi të fatit edhe atyre që firmosën më përpara copëtimin fatal të tokave etnike të shqiptarëve më në fund lidershipi i Kosovës zgjodhi datën 17 shkurt për të shpallur pavarësinë e saj. Një gjetje vërtet origjinale ka qenë papirusi 700 vjeçar i blerë në Londër.

Ora ka shënuar 15:49 minuta, kur 109 deputetët e Kosovës, ngritën dorën dhe votuan pro dokumentit të pavarësisë. Menjëherë pasi ka përfunduar seanca në parlament, kryeministri Thaçi i ka dërguar letër 192 vendeve anëtare të OKB-së, përfshi edhe Serbinë, për të njohur pavarësinë e Kosovës. Gjatë seancës në Kuvend, presidenti dhe kryeministri dhanë garanci për minoritetet, sidomos atë serb, në gjuhën serbe. Pavarësia e Kosovës shënon fundin e procesit të gjatë të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kanë përjetuar të njëjtat emocione si homologët e tyre në Ko-

sovë, gjatë shpalljes së pavarësisë. Me nismën e kryeparlamentares, deputetët kanë ndjekur drejtpërdrejtë seancën e Kuvendit të Kosovës. Ata janë çuar në këmbë të gjithë në momentin kur Thaçi niste të lexonte deklaratën e pavarësisë. Duartrokitjet nuk kanë munguar në të dyja Parlamentet kur u shpall pavarësia.

Kosova tashmë do të ketë flamurin e saj. Sfondi me ngjyrë blu, me hartën e bardhë të Kosovës në mes dhe gjashtë yje të verdhë është dizenjimi i flamurit të ri të vendit. Ky version i flamurit është përzgjedhur ndërmjet 1700 propozimeve të mbërritura nga të katër anët e globit. Sipas dizajnesve të këtij flamuri, ngjyra e kaltër paraqet paqen, kurse me gjashtë yjet e verdhë janë paraqitur komunitetet që jetojnë në Kosovë, ndërsa harta paraqet popullin shqiptar.

I ndodhur në një tur në disa vende të Afrikës, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhorxh W. Bush ka vënë theksin pikërisht te garancia që Kosova u ka dhënë ndërkombëtarëve për pakicat serbe, pas shpalljes së pavarësisë. "Ne jemi pro pavarësisë, por nënmbikëqyrjen e ndërkombëtarëve". Kandidatja demokrate, Hillari Klinton ka përsëritur dje deklaratën e pavarësisë së Kosovës, ndërsa u ka bërë thirrje vendeve mike dhe aleate "të bashkohen me SHBA dhe BE për njohjen e Kosovës së pavarur"



RRUGËTIMI I KOSOVËS NË SHEK. XX DREJT PAVARËSISË



Kosova ka treguar një kulturë të pamasë demokratike dhe ka pohuar se është një shoqëri e gatshme për të përfaqësuar një shtet të pavarur me festën që organizoi ditën e madhe të pavarësisë. Një festë që zgjati më shumë se 24 orë dhe nuk shënoi asnjë incident në të gjithë vendin.

1968 - Ndodh demonstrata e parë pro pavarësisë nga shqiptarët e Kosovës, shumë arrestohen.

1974 - Kushtetuta jugosllave e deklaroi Kosovën një provincë autonome brenda Serbisë.

1989 - Presidenti serb, Slobodan Millosheviç, i heq Kosovës autonominë.

1990 - Jugosllavia dërgon trupa ushtarake në Kosovë. Serbia shpërbën qeverinë e Kosovës.

1991 - Separatistët proklamojnë Kosovën republikë, e cila njihet vetëm nga Shqipëria.

1992 - Ibrahim Rugova zgjidhet president i të ashtuquajturës Republikë.

1996 - Formohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës pro pavarësisë, bomba kundër policisë.

Mars 1998 - Dhjetëra të dyshuar si separatistë shqiptarë vriten nga policia serbe.

Prill 1998 - Grupi i Kontaktit për Ballkanin, sanksione ndërkombëtare kundër Jugosllavisë.

Shtator 1998 - Forcat serbe sulmojnë fshatrat në Drenicë; masakrohen dhjetëra shqiptarë.

Tetor 1998 - Aleanca NATO autorizon sulmin ajror kundër ushtrisë serbe.

Tetor 1998 - Millosheviç bie dakord për bisedime me të dërguarin e SHBA-së, Richard Holbrooke për tërheqje.

Tetor 1998 - I dërguari i SHBA-së, Christopher Hill, përpiqet për marrëveshje politike, shpërthen dhuna.

Shkurt 1999 - Të dyja palët bien dakord për një konferencë paqjeje për Kosovën.

Mars 1999 - Beogradi autorizon marrëveshjen e paqes, të nënshkruar nga shqiptarët.

24 mars 1999 - NATO nis fushatën bombarduese kundër Jugosllavisë për 78 ditë.

Mars 1999 - Forcat serbe përzënë 800 000 shqiptarë drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Qershor 1999 - Millosheviç pranon të tërheqë trupat nga Kosova, pas propozimit të NATO-s për administrimin e saj nga OKB-ja. NATO stop bombardimeve.

Qershor 1999 - 50,000 paqeruajtës zbarkojnë në Kosovë. Kthehen të ikurit shqiptarë.

Mars 2004 - Shpërthen dhuna më e madhe etnike mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

Janar 2006 - Rugova vdes nga kanceri i mushkërive në Prishtinë.

Shkurt 2006 - Nisin bisedimet e ndërmjetësuar nga OKB-ja për statusin e Kosovës.

Qershor 2006 - Liderët shqiptarë dhe serbë mbliidhen për të diskutuar statusin, pa marrëveshje.

Janar 2007 - Serbia zhvillon zgjedhjet parlamentare. Fitojnë radikalët.

Janar 2007 - I dërguari i OKB-së, Marti Ahtisari, paraqet planin e tij para Grupit të Kontaktit.

Shkurt 2007 - Ahtisari paraqet propozimin e tij para presidentit serb dhe liderëve shqiptarë, Kosova shkollon drejt shtetësisë.

Qershor 2007 - Presidenti amerikan, Bush, deklaroi nga Tirana mbështetjen për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Dhjetor 2007 - Përfundojnë pa asnjë marrëveshje negociatat shtesë mes Serbisë dhe Kosovës për Statusin

Shkurt 2008 - Kosova shpall pavarësinë



TANI PRINTERI EDHE NE XHEPAT TUAJ

Firmit Polaroid dhe Zink Imaging lajmërojnë se doli në treg një printer fotografish i vogël xhepi dhe i cili mund të përdoret për telefonat celular dhe aparatet fotografike dixhitale.

Firma Polaroid e cila prodhon aparate fotografike mori pjesë në një panair të zhvilluar në Las Vegas (Consumer Electronic Show), por këtë rradhë duke prezantuar një printer me përmasa të vogla për fotografi.

Ndihmës presidenti i Polaroidit John Pollock pohon se këtë verë do të hidhen në treg këto printera dhe do të kenë një çmim nën 150 \$.

Përdoruesit e këtij aparati do të kenë mundësi që fotot e tyre ti dërgojnë nga celularët ose aparatët fotografikë dixhitalë për në printer me anë të një bluetoothi, pa kablo, si dhe të printohen foto me përmasa 12 cm × 18 cm.



AUTOMOBILE PA SHOFER



Po dalin në treg makinat që ecin vetë. Këto makina vitesh mendohen që të dalin në treg në vitin 2015.

Zevëndës presidenti i firmes GM Rick Wagoner është duke u punuar për një mjet i cili do të dalin në treg në vitin 2015.

Burns, për automobilin në fjalë nënvizon rëndësishmja për këtë automobil janë udhëzuesit dhe komunikimi me qytetit. Ai shton se deri në vitin 2015-të këto makinat do të dalin në treg mendohet të jenë aty rreth vitit 2015.

Ekspertët e teknologjisë pohojnë se është e mundur të bëhet me radar që kontrollojnë shpejtësinë, aparatet e tregut dhe komunikimi me qytetit.

Profesori i inxhinierisë elektronike dhe drejtori i teknologjisë në një garë për automobila pa shofer që ish-CEO i GM-së, siç është e realizueshme por shtoi se për shkak të kësaj pa shofer.

MAKINAT QË FLUTUROJNË PO BËHEN REALITET

Tani trafiku i makinave do të dendësohet edhe në qiell! Pas pesë vitesh mendohet që të dalin në treg makinat fluturoese. Ja pra veçoritë e tyre...

Po kthehet në realitet ajo për të cilën njerëzimi ka menduar për 100 vjet me rradhë. Avion-automobili i cili është planifikuar të jetë vetëm për një person peshon më pak se 600 kg. dhe punon me benzinë që nuk përmban plumb. Firma me qendër në Hollandë ka zhvilluar Pal-V në madhësinë e një automobili fiat uno.



Pal-V-ja për tu ngritur në ajër i duhet të përshkojë një rrugë prej 50 metrash. Kurse për të zbritur asaj i mjaftojnë vetëm katër metra. Makina sapo të kalojë në gjendje fluturimi, i hapen krahët e saj të ndodhura sipër tavanit, dhe ngrihen në ajër si helikopter. Automobilët që ecin në tokë kanë një shpejtësi prej 200 km/h. Kurse ata fluturoes do të kenë një shpejtësi prej 190 km/h, si dhe do të mund të ngjiten në një lartësi prej 1200 metra.

Automobili i cili përbëhet prej tre gomash, mendohet që pas pesë vitesh të dalë në treg, ku do të ketë një çmim pak më të shtrejtë se automobilët e zyrtarve të lartë shtetërorë.

vetiu. Firma më e madhe dhe prestigjioze e makinave General Motor njofton se pas dhjetë vjetësh do të dalin në treg automobilët që parkohen vetvetiu dhe që ecin pa u drejtuar nga ndonjë shofer.

Larry Burns pohon se sëbashku me inxhinierët e universiteteve dhe prodhuesit e makinave, ai do të bëjë ndryshime, revolucion si në udhëtimet e shkurtëra ashtu edhe në ato të gjata.

Automobilët do të pajiset me kompjuter, çip dhe një antenë jo fort të shtrejtë, por ajo çka është më e rëndësishme është aftësimet e gjata që mund ti bëjë në autostradë, por nuk hiqet mundësia edhe brenda rrugëve qytetore. Kjo ka në plan ta testoj teknologjinë e automjeteve pa shofer. Kurse automobilët e parë që do të dalin në treg do të jenë në vitin 2018-të.

Automobilët do të menduar gjatë para se të hidhen në treg automobilët pa shofer. Këto makina duhet të pajisen me teknologji të avancuara si teknologji paralelmëruese, paisje sateliti për hartën dixhitale etj.

Automobilët do të zhvillohen në departamentin e inxhinierisë së re të kompanisë së informatike pranë universitetit Stanford i quajtur Sebastian Thrun vitin e kaluar mori pjesë në një konkurs të organizuar nga Pentagoni i SH.B.A-së ku ndër të tjera nënvizoi se synimet e GM-së janë të njëjta me të cilat kompania e disa ligjeve bazë, në disa shtete do të marrë kohë më shumë përhapja e automobilëve pa shofer.

HARRESA DO MBETET NË HISTORI

Të moshuarit pesëdhjetë vjeçarë do të mund të kujtojnë ngjarjet që kanë përjetuar në moshën njëzetë vjeçare.

Shkencëtarët të cilët punojnë në spitalin Toronto Western të Kanadasë shprehen se në mënyrë aksidentale ata kanë zbuluar të dhëna të reja, që ndoshta do të hapin një kapitull të ri në fushën e mjekësisë. Shkencëtarët në lidhje me historikun e zbulimit të ri shprehen se: Kemi bërë që të jepet sinjal me anë të elektrodave të vendosura në pjesën Hipotolamus tek personat pesëdhjetë vjeçarë të cilët nuk mund të shpëtojnë sëmundjes së mbingopjes. Në fund të eksperimentit i sëmuri arriti të kujtojë në mënyrë të detajuar ngjarjet që ka përjetuar para tridhjetë vitesh. Duke u kthyer edhe një herë në vitet e rinisë arriti që të kujtojë të gjitha bisedat, veshjet e disa shoqeve që në atë kohë ishin pjestarë të një partie sikur ti përjetonte para disa minutave. Kemi vazhduar eksperimentët për tre javë rresht. Kujtesa dhe aftësia për të mësuar ishte zhvilluar jashtë mase. Por me rritjen e forcës se elektrodave, kujtesa fotografike kthehet në hiç. Në botën e mjekësisë, ashtu sikurse ky zbulim në lidhje me këtë sëmundje në mënyrë aksidentale mundet që në të ardhme të zbulohen edhe informacione të tjera për sëmundje që sot e kërcënojnë njeriun.



KILET E TEPËRTA SHKAKTOJNË KANCER

Edhe njëherë argumentohet se kilet e tepërt shkaktojnë lloje të ndryshme të kancerit.

Sipas 141 kërkimeve shkencore të bëra nga Andrea Renehan dhe ekipi i tij pranë Universitetit Manchester të Anglisë thuhet se janë zbuluar njëzet lloje kanceri tek njeriu si shkak i marrjes së tepërt të kileve. Studiuesit nënvizojnë se rreth 52% e meshkujve që fitojnë 15 kg. më tepër se pesha normale janë të rrezikuar nga kanceri në gypin e ushqimit, 33% të rrezikuar nga kanceri tiroid, ndërsa 24% e tyre rrezikohen nga kanceri i veshkave.

Kurse tek gratë që marrin 13 kg. më tepër se pesha normale rreziku nga kanceri në bark dhe tëmth është 59%, ndërkohë që 51% e tyre janë të rrezikuar nga kanceri në gypin e ushqimit, kurse 34% e tyre janë të rrezikuar nga ai në veshka.

Sipas studimit të bërë nga Fondi i Studimeve të Kancerit në botë ku dhe është botuar në muajin Tetor në revistën angleze The Lancet thuhet se mënyra më e mirë për tu mbrojtur nga kanceri është ruajtja nga shtimi i kilove të tepërta gjatë gjithë jetës.

KUJDES NGA KREMËRAT E NJOLLAVE!

Një grua në qytetin e Londrës është sëmurë si pasojë e përdorimit të disa kremërave kundër njollave.

Këto kremëra që janë shitur në treg të zi të Anglisë janë të rrezikshme jashtë mase për shëndetin e njeriut.

Doktorët e spitalit Hammersmith të Londrës Taricia Tan dhe Tony Golgstone pohojnë se një grua njëzetë e tetë vjeçare e cila ishte shtruar në këtë spital kishte shtuar 13 kg. për tre vjet dhe se vuante vazhdimisht nga sëmundja e majasillit dhe kishte plagë të ndryshme në krahë, kurriz, bark dhe këmbë. Më tej ata vazhdojnë duke thënë shkak i kësaj sëmundjeje ishin kremërat që grujaja pohoi se i kishte blerë në treg të zi.

Më vonë u kuptua se kjo grua kishte përdorur për shtatë vjet rregullisht kremërat e tregut të zi ku brenda një jave konsumonte dy tubetë.

Doktorët theksojnë se ilaçet të cilat përdoren kundër kruarjes nuk lejohen të përdoren më shumë se dy javë dhe pa këshillën e mjekut, për arsye se përmbajnë kortizon në masë të madhe.



MINIATURA ISLAME-OSMANE

mi musliman mbi jetën reflektohet edhe në artin musliman dhe me anë të artit të miniaturës islame jepet mesazhi se kjo jetë është kalimtare dhe temporale dhe se asgjë nuk është e përjetshme përveç Allahut të madhëruar. Objektet e natyrës nuk vizatohen siç janë në realitet, por stilizohen shndërrohen në të tejdukshme dhe abstraksionohen duke u kthyer në monotone. Një tjetër karakteristikë e miniaturës është mungesa e parimeve të artit në lidhje me kohën, vendin dhe përmasat. Një njeri në miniaturë mund të pikturoidet në përmasa më të mëdha apo më të vogla nga çka qenë në të vërtetë.

Një tjetër karakteristikë që e dallon miniaturën osmane nga miniatura indiane dhe ajo perse është realizmi. Për shembull kur sulltan Sulejmani pat dalë për fushatën kundër Irakut morri me vete edhe miniaturistin e famshëm Nasuh Matrakçiu, i cili me këtë rast bëri miniaturat e vendeve nga kaloi, 128 prej të cilave i përmbloodhi në veprën e tij. Miniaturistët e tjerë Osmani dhe Levni përgatitën miniatura të rralla në lidhje me veshjet e njerëzve, jetesën e tyre dhe persona nga profesione të ndryshme siç qenë tregtarët, xhamxhinjtë, bukëpjekësit.

Një nga funksionet që mbulonte miniatura në shekujt e mëparshëm të botës muslimane është të qenurit e saj edhe arti i librave. Një ndër kënaqësitë e sulltanëve dhe njerëzve me autoritet të madh në shtetin musliman që të shpenzonin shumën të mëdha në mënyrë që në emër të tyre të përgatiteshin vepra të zbukuruar me miniatura. Në periudhën osmane nuk ka qenë asnjëherë zakon që miniaturat të vareshin nëpër mure. Ato përherë kanë mbetur brenda faqeve të librave. Nga këtu mund të arrijmë në konkluzionin se një ndër qëllimet kryesore me të cilën janë përgatitur miniaturat ka qenë edhe arkivimimi në mënyrë artistike të ngjarjeve dhe ndodhive historike. Meqënëse punimet janë realizuar mbi baza artistike ato edhe mbeten permanente dhe në këtë mënyrë mund tu përcillen brezave që vinë, edhe arti shndërrohet në një mjet për ti shërbyer idealeve më madhore në jetë.

Fjala miniaturë sipas studiuesve mendohej të rrjedhë nga një bojë e kuqe që përdorej në Europën Mesjetare dhe që emërtohej “minium”. Në literaturën islame me të mund të përngjasohet fjala naksh, kurse miniaturistit i thuhej nakash.

Në thelb miniatura është një lloj pikturë. Por karakteristika që e dallon atë nga llojet e tjera të pikturës është të qenurit e saj arti i vijave. Çdo gjë është kufizuar dhe përcaktuar në një hapësirë të pagjë dhe të pafigurë nëpërmjet vijave. Në miniaturë nuk përdoret perspektiva që nxjerr në pah objektet dhe njerëzit. Miniatura e realizon me ngjyra të gjalla dhe të pastra atmosferën duke mos futur në përdorim perspektivën e hijes dhe të lojërave të saj. Pra në miniaturë piktura realizohet duke u përpjekur që ti veshet një sipërfaqje artistike pikturës pa u zhytur thellë në të.

Në fushëpamjen e përgjithshme të miniaturës është dëshira për të dhënë mesazhin se kjo botë është kalimtare dhe se çdo gjë që i përket kësaj bote është sipërfaqësore. Koncepti i të pikturuarit në historinë e perëndimit ka arritur deri në atë pikë sa që ta konkretizojë edhe konceptin e Zotit duke e shndërruar në një objekt me pamje njeriu. Dëshira për të krijuar i ka shpënë ata deri në skulpturë. Por këndvështrimi në artin islam në përgjithësi dhe atë osman në veçanti është tërësisht i ndryshëm. Në fund të fundit, botëkupti-